

# PËR MËSUESIN/EN

**duk gjini**  
shtëpia botuese publishing house

**Njomza Lila-Babuni, Katarina Gojani,  
Florije Sermaxhaj, Blerta Shatri,  
Valdete Gjakova**

# **NJERIU DHE NATYRA**

**Për klasën e katërt të arsimit fillor**

# 4

## PËRMBAJTJA

Udhërrëfyes .....	5
Hyrje .....	7
Planifikimi vjetor .....	14
Plani dymujor: shtator—tetor .....	15
Plani dymujor: nëntor—dhjetor .....	18
Plani tremujor: janar—shkurt—mars.....	21
Plani tremujor: prill—maj—qershor .....	25
Mësimi 1: Materialet metalike dhe materiet minerale .....	30
Mësimi 2: Materialet metalike dhe materiet minerale - Fletore pune .....	32
Mësimi 3: Materialet organike dhe ato kompozite .....	34
Mësimi 4: Vetitë dhe përdorimi i materialeve .....	36
Mësimi 5: Vetitë dhe përdorimi i materialeve - Fletore pune .....	38
Mësimi 6: Lëndët e pastra, ato të përziera dhe tretësit.....	40
Mësimi 7: Ndarja e përzierjeve .....	42
Mësimi 8: Ndarja e përzierjeve - Fletore pune .....	44
Mësimi 9: Tretja e lëndëve të ndryshme në ujë dhe varësia nga temperatura .....	46
Mësimi 10: Tretja e lëndëve të ndryshme në ujë dhe varësia nga temperatura - Fletore pune .....	48
Mësimi 11: Përbërësit kryesorë të ajrit.....	50
Mësimi 12: Përbërësit kryesorë të ajrit - Fletore pune .....	52
Mësimi 13: Mbrojtja e ajrit nga ndotja .....	54
Mësimi 14: Riprodhimi te bimët .....	56
Mësimi 15: Riprodhimi te kafshët.....	58
Mësimi 16: Riprodhimi i bimëve dhe i kafshëve - Fletore pune .....	60
Mësimi 17: Riprodhimi te njerëzit .....	62
Mësimi 18: Riprodhimi te njerëzit - Fletore pune .....	64
Mësimi 19: Ndikimi i njeriut në biodiversitet .....	66
Mësimi 20: Mënyrat e ruajtjes së ushqimit .....	68
Mësimi 21: Rëndësia e të ushqyerit shëndetshëm .....	70
Mësimi 22: Rëndësia e të ushqyerit shëndetshëm - Fletore pune .....	72
Mësimi 23: Si të mbahet ushqimi pastër dhe si të ushqehemi shëndetshëm?.....	74
Mësimi 24: Lëndët helmuese për organizmin .....	76
Mësimi 25: Lëndët helmuese për organizmin - Fletore pune .....	78
Mësimi 26: Zhvillimi dhe ndryshimet në trupin e njeriut .....	80
Mësimi 27: Zhvillimi dhe ndryshimet në trupin e njeriut - Fletore pune .....	82
Mësimi 28: Mirëmbajtja e trupit .....	84
Mësimi 29: Mirëmbajtja e trupit - Fletore pune.....	86
Mësimi 30: Përkufizimi i masës, i vëllimit dhe i dendësisë .....	88
Mësimi 31: Përkufizimi i masës, i vëllimit dhe i dendësisë - Fletore pune .....	90
Mësimi 32: Vetitë e trupave .....	92
Mësimi 33: Lëvizjet e trupave.....	94
Mësimi 34: Vetitë dhe lëvizjet e trupave - Fletore pune .....	96
Mësimi 35: Valët dhe mënyra e krijimit të tyre.....	98
Mësimi 36: Valët dhe mënyra e krijimit të tyre - Fletore pune .....	100
Mësimi 37: Ndryshimet (shndërrimet) e kthyeshme dhe të pakthyeshme të lëndës.....	102

Mësimi 38: Ndryshimet (shndërrimet) e kthyeshme dhe të pakthyeshme të lëndës - Fletore pune .....	104
Mësimi 39: Demonstrimi i shembujve nga bashkëveprimet dhe lëvizjet e trupave.....	106
Mësimi 40: Shtypja atmosferike dhe pesha e ajrit.....	108
Mësimi 41: Ndikimi i temperaturës në qarkullimin e ajrit dhe në mot .....	110
Mësimi 42: Ndikimi i temperaturës në qarkullimin e ajrit dhe në mot - Fletore pune .....	112
Mësimi 43: Vlimi, avullimi dhe lëngëzimi i ujit.....	114
Mësimi 44: Burimet e energjisë së pastër dhe burimet që e ndotin mjedisin.....	116
Mësimi 45: Burimet e energjisë së pastër dhe burimet që e ndotin mjedisin - Fletore pune .....	118
Mësimi 46: Elektriciteti dhe magnetizmi .....	120
Mësimi 47: Elektriciteti atmosferik dhe mbrojtja prej tij .....	122
Mësimi 48: Elektriciteti atmosferik dhe mbrojtja prej tij - Fletore pune .....	124
Mësimi 49: Qarku i thjeshtë elektrik .....	126
Mësimi 50: Qarku i thjeshtë elektrik - Fletore pune .....	128
Mësimi 51: Pajisjet që punojnë me rrymë dhe rreziku nga rryma elektrike.....	130
Mësimi 52: Veprimi magnetik .....	132
Mësimi 53: Elektromagneti i thjeshtë.....	134
Mësimi 54: Veprimi magnetik - Fletore pune .....	136
Mësimi 55: Pozita e Tokës në Sistemin Diellor.....	138
Mësimi 56: Pozita e Tokës në Sistemin Diellor - Fletore pune .....	140
Mësimi 57: Orientimi në natyrë.....	142
Mësimi 58: Orientimi në natyrë - Fletore pune.....	144
Mësimi 59: Paraqitja e Tokës në hartë, në glob dhe në plan.....	146
Mësimi 60: Paraqitja e Tokës në hartë, në glob dhe në plan - Fletore pune.....	148
Mësimi 61: Ndikimet e Diellit në dukuritë natyrore të planetit Tokë.....	150
Mësimi 62: Ndikimet e Diellit në dukuritë natyrore të planetit Tokë - Fletore pune.....	152
Mësimi 63: Rëndësia e Diellit në zhvillimin e botës bimore dhe shtazore.....	154
Mësimi 64: Rëndësia e rrezeve të Diellit në zhvillimin e botës bimore dhe shtazore - Fletore pune .....	156
Mësimi 65: Ndërtimi i atmosferës dhe rëndësia e saj për jetë .....	158
Mësimi 66: Ndërtimi i brendshëm i Tokës .....	160
Mësimi 67: Ndërtimi i brendshëm i Tokës - Fletore pune .....	162
Mësimi 68: Sa ka ujë në planetin Tokë? .....	164
Mësimi 69: Sa ka ujë në planetin Tokë? - Fletore pune .....	166
Mësimi 70: Faktorët që ndikojnë në përhapjen e botës bimore dhe shtazore .....	168
Mësimi 71: Faktorët që ndikojnë në përhapjen e botës bimore dhe shtazore - Fletore pune .....	170
Mësimi 72: Ndotja e mjedisit.....	172
Mësimi 73: Ndotja e mjedisit - Fletore pune.....	174
Mësimi 74: Ruajtja e trashëgimisë natyrore.....	176

Të dashur mësues dhe mësuese,

Ky libër është hartuar me qëllimin për t'ju ardhur në ndihmë për zhvillimin e mësimit, mbështetur në metodologjitë më të përparuara bashkëkohore.

Sistemi arsimor në Kosovë ka kaluar nëpër vështirësi të ndryshme dhe në shkolla janë përdorur metoda tradicionale të mësimdhënies. Sot kemi mundësinë që arsimimi t'i pajisë nxënësit me kompetencat që u nevojiten, për ta formësuar jetën e tyre dhe për të kontribuar në shoqëri. Për ta realizuar këtë synim, shtëpia botuese "Dukagjini" aplikon metodologji bashkëkohore të mësimdhënies ndërvepruese në librat e mësuesve, që ka për qëllim t'ju ndihmojë të gjeni përgjigje për pyetjen themelore: *Çfarë metodologjie do të përdorni për të ndërtuar e krijuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që do t'u nevojiten nxënësve të Republikës së Kosovës për ta formësuar të ardhmen e tyre?*

Integrimi në hapësirën arsimore të shekullit të 21-të kërkon, midis të tjerash, modernizimin e metodave ekzistuese të mësimdhënies dhe të të nxënësve, futjen e veprimtarive bashkëkohore në mësim, që mundësojnë përgatitjen e një individi aktiv, të pavarur dhe të lirë, të pajisur me shprehje të menduarit kritik, krijues, komunikues dhe bashkëpunues, i aftë për t'i përmbushur kërkesat e shoqërisë së sotme.

Cilësia e re e të nxënësve dhe e mësimdhënies përbën përparësi absolute për arsimin. Ju nuk jeni vetëm burime informacioni, por nga ju kërkohet edhe të përdorni metoda dinamike të mësimdhënies, të quajtura edhe metoda mësimore ndërvepruese, të cilat përbëjnë elementet bazë të këtij modeli, për t'i motivuar nxënësit që të angazhohen maksimalisht në mësim.


Modeli i këtyre librave dhe mësimet janë hartuar me profesionalizëm, përkushtim dhe përgjegjësi maksimale.



# UDHËRRËFYES për konceptimin e mësimëve model


## Faqja në të majtë

- Këto janë të dhëna identifikuese, të cilat orientojnë për mësimin.
- Mësimi synon që, përmes rezultateve të të nxënës, të kontribuojnë në një ose disa prej kompetencave.
- Rezultatet specifike janë në koherencë me ato të fushës.
- Të gjitha mjetet dhe materialet, e çdo lloji, që shërbejnë për konkretizim në ndihmë të të nxënës.
- Parashikimi është faza e parë e orës mësimore që siguron përqendrimin dhe aktivizimin e nxënësve në mësim.



- Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësuesin/en gjatë përgatitjes.
- Rezultatet e të nxënës të temës janë në koherencë me ato të orës mësimore; tema është më e gjerë.
- Rezultatet specifike të të nxënës janë ato mbi të cilat ndërtohet mësimi.
- Janë zbrërtim i rezultateve të të nxënës sipas niveleve të arritjes. Përcaktohen me nxënësit në klasë.
- Zakonisht, mësimi ka lidhje me lëndë dhe fusha të tjera, të cilat evidentoohen.

- Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësuesin gjatë përgatitjes.
- Vlerësimi formues në raport me rezultatet e të nxënës.
- Vetëreflektim dhe vetëvlerësim për orën mësimore në raport me arritjen e rezultateve të nxënësve.



- Përpunimi i përmbajtjes është faza e dytë e orës mësimore, ku bëhet përzgjedhja e materialit mësimor dhe organizimin metodologjik të tij.
- Përforcimi është faza e tretë e orës mësimore, ku bëhet integrimi i dijeve dhe shprehive, si dhe zbatimi i tyre.

## Faqja në të djathtë

### Përshkrim i rubrikave kryesore të orës së mësimi

**Rezultatet e të nxënës të temës** janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme, të cilat janë pika referuese në përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore për lëndën dhe rezultateve të të nxënës për këtë temë. Në këtë rast, mund të merren nga tabela e krahasimit të planeve dhe programeve ekzistuese me Kurrikulën Bërthamë, por edhe mund të hartohen vetë, mund të jenë një, dy a më shumë rezultate. Një rezultat i të nxënës të lëndës mësimore mund të shërbejë për një apo më shumë njësi mësimore - kjo varet nga përshkrimi i rezultatit të të nxënës dhe nga elementet përbërëse të tij.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës.** Duke filluar nga klasa e tretë e më lart, nxënësit zotërojnë operacionet mendore, të menduarit e tyre është konkret me elemente të të menduarit abstrakt, prandaj mësimi me këta nxënës kalon në tri faza. Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht në rezultatet e tyre, bëhet përmes fushës kurrikulare e cila kontribuon në arritjen e rezultateve të kompetencave. Të gjitha kompetencat kryesore të kurrikulës zërthehen në rezultate të të nxënësve. Ato janë pjesë e Kurrikulës Bërthamë dhe parashihen të përvetësohen nga nxënësit, me rastin e përfundimit të shkallës së kurrikulës.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës.** Shprehin kërkesat thelbësore të arritjes në fushën kurrikulare, drejt zotërimit të kompetencave kryesore, në përfundim të shkallës. Ato përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë nxënësi në fund të shkallës a nivelit dhe shprehin një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat. Vendosen rezultatet e të nxënësve të fushës kurrikulare, vetëm ato që reflektohen në temën mësimore.

**Rezultatet e të nxënësve.** Rezultatet specifike të të nxënësve janë ato mbi të cilat ndërtohet ora e mësimi, të cilat përbëjnë detajimin e rezultateve të të nxënësve të temës e që janë në koherencë me ato të fushës së kurrikulës.

**Kriteret e vlerësimit/suksesit:** janë zërthim i rezultateve të të nxënësve sipas niveleve të arritjes dhe sigurojnë vlerësim të drejtë për shkallën e zotërimit. Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Metodologjia dhe veprimtaritë me nxënësit - hapat e zhvillimit të mësimi.** Mësimi zhvillohet përmes hapave, duke nxitur të menduarit logjik e kritik të nxënësit, duke pasur parasysh fazat e zhvillimit sipas Pi-azhesë.

Çfarë simbolizon modeli me tri pamje të ndryshme të ciklit të jetës së bimës së grurit në tri fazat e mësimi?

Mbillet një farë. Pasi është bërë puna themelore e fillimit, mësuesi/ja vazhdon dhe fara e grurit lëshon rrënjë, kështu që bima rritet. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Cikli i jetës së grurit, nga fara në tokë, në bimë, e prapë në farë, sugjeron, gjithashtu, ciklin e vazhdueshëm të shkollimit, përmes mbështetjes në njohuritë ekzistuese, për të vazhduar më tej.



#### **Parashikimi: Përgatitja për të nxënësit**

Në fazën e parashikimit mbillet një farë në një truall pjellor. Mësimi duhet të mbështetet edhe në njohuritë ekzistuese të nxënësve, ashtu si fara që merr ushqim nga trualli ku është mbjellë.

Kjo është faza e parë e strukturës për zhvillimin e të menduarit dhe të nxënësve, kryhen veprimtari të ndryshme njohëse, nxënësi është i përfshirë gjallërisht në rikujtimin e asaj ç'ka di rreth temës së mësimi, bën lidhjen e njohurive të reja me ato që dihen. Nxënësit ndërtojnë njohuritë, konceptet, kuptimin e ri mbi dukuritë e caktuara nga bazat e njohurive të mëparshme.



#### **Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes**

Mësimi vazhdon me fazën e ndërtimit të njohurive; fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kjo është faza e dytë e strukturës për zhvillimin e të menduarit të nivelit të lartë gjatë të nxënësve dhe nxënësi është i përfshirë në procesin e përfundimit të kuptimit të njohurive, gjithashtu ruan interesin dhe ritmin e vendosur gjatë fazës së parashikimit.



#### **Përforcimi: Konsolidimi i të nxënësve**

Mësimi përfundon me fazën e përforcimit. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Në këtë fazë, nxënësit konsolidojnë të nxënësit e ri dhe, në mënyrë të gjallë, ristrukturojnë skemën e tyre për të përshtatur konceptet e reja dhe për t'i zbatuar ato.

## HYRJE

### Konceptimi dhe ndërtimi i librit për mësuesin/en

#### NJERIU DHE NATYRA 4

Fokusi kryesor i të mësuarit në fushën *Shkenca e natyrës* përmban bazën e të kuptuarit të botës përmes koncepteve në lëndën mësimore njeriu dhe natyra. Nxënësit, që në moshë të hershme, njihen me dukuritë shkencore si tërësi dhe ndikimin e tyre në funksionimin e shoqërisë dhe natyrës.

Në klasën e pestë nxënësit mësojnë për aspektet thelbësore të njohurive, metodave, proceseve dhe përdorimit të shkencës. Ata inkurajohen të kuptojnë se si shkenca mund të përdoret për të shpjeguar se çka ndodh rreth tyre dhe t'i analizojnë shkaktarët.

#### Udhëzime metodologjike

Për zbatimin praktik të planifikimit mësimor për shkenca natyrore, brenda orës mësimore dhe jashtë saj, në realizimin e aktiviteteve kurrikulare dhe jashtëkurrikulare, nevojitet përdorim i përshtatshëm i metodologjive të mësimdhënies dhe të të nxënësve.

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat dhe për fushën *Shkenca e natyrës*, e përkatësisht rezultatet lëndore, paraqesin jo vetëm pika referuese për përzgjedhjen e përmbajtjeve, por edhe për përzgjedhjen e metodologjive, duke u harmonizuar njëra me tjetrën në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve, në kontekst të filozofisë dhe parimeve të Kornizës Kurrikulare.

Suksesi i nxënësve këtë lëndë varet nga puna dhe angazhimi i mësuesit/es dhe nxënësve. Kjo arrihet duke përdorur qasje krijuese, ndërvepruese, gjithëpërfshirëse, ekipore, si dhe metoda, teknika e forma të shumëllojta të punës. Për këtë qëllim zbatohet një kompleks i tërë procedurash, si: informacioni i ri, ushtrime, detyra, punë me projekte, punë praktike në laborator, klasë si dhe të nxënësve në natyrë.


Mësimdhënia për nxënësve e klasës së pestë realizohet përmes ilustrimeve, provave dhe lojërave, nën mbikëqyrjen e mësuesit/es, duke pasur parasysh kohën në dispozicion për nevojat dhe kërkesat e tyre, natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, bazën didaktike dhe stilet e të nxënësve.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënësve cilësore sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës.

#### Metodologjia ndërvepruese në mësimdhënie dhe të nxënësve

Ky libër është hartuar për t'ju pajisur me metodologjinë ndërvepruese në ndërtimin e dijeve dhe formimin e shkathësive. Ai trajton temat mësimore në përputhje “Kurrikulën Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillore të Kosovës” (2016) si edhe të gjitha dokumentet dhe udhëzimet administrative në fuqi ku është mbështetur metodologjia me të gjitha elementet përbërëse, duke filluar me kontributin në kompetencat kryesore dhe rezultatet e të nxënësve të fushës, rezultatet specifike të të nxënësve të njësisë mësimore, mjetet e punës, ecurinë metodologjike të orës së mësimi e deri te vlerësimi i nxënësve. Një nga risitë e këtij libri është se përmban edhe një rubrikë: *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore*. Qëllimi i kësaj rubrike është që t'ju ndihmojë të mbani shënime për punën tuaj në klasë, arrijtjet, por edhe mospësuksin, dhe më pas të reflektoni kur të bëni përsëritje, të kontrolloni dijet dhe të bëni vlerësimin e nxënësve, por edhe kur të zhvillonin mësimin një vit apo disa vjet më pas.

Në aspektin metodologjik të hartimit të modeleve orientuese për çdo orë mësimi, është bërë kujdes i veçantë në harmonizimin e të gjitha veprimtarive. Marrëdhëniet midis rezultateve të të nxënit - procedurave të mësimdhënies dhe të nxënit - vlerësimit, përbëjnë atë që në metodologjinë e sotme quhet 'trekëndëshi magjik'. Trekëndëshi paraqet marrëdhënien koherente midis rezultateve të të nxënit, veprimtaritë e mësimdhënies/të nxënit dhe vlerësimin. Këta tre komponentë janë në koherencë me njëri-tjetrin, me qëllim që nxënësit të inkurajohen për të mësuar, të jenë pjesëmarrës aktivë në ndërtimin e dijes dhe të shkathhtësive.



Burimi: Nga Metodologji e mësimdhënies, (faqe 102), B. Musai, 2014. Botuar në Tiranë: CDE

**Zgjeroni dhe thelloni ditjet** Për më shumë lexoni në: Musai, B. (2014) Metodologji e mësimdhënies. Tiranë: CDE, faqe 101-128.


Metodologjia e çdo teme zhvillohet në mënyrë pamore rreth mësimin të librit të nxënësit, e cila ju ndihmon ta shikoni atë pa pasur nevojën që ta keni pranë. Përdorimi i kësaj mënyre të paraqitjes metodologjike të mësimin ka dhënë rezultate mjaft të mira.

Metodologjia ndërvepruese ka si qëllim përfshirjen aktive të nxënësve në ndërtimin e dijes dhe formimin e shprehive. Zhvillimi i nxënësve që mendojnë në mënyrë kritike e që janë krijues, është në qendër të metodave të mësimdhënies, të mënyrave të të nxënit e të çdo veprimtarie tjetër, me synim zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të lartë. Por, nga ana tjetër, jemi mbështetur edhe në parimet e psikologjisë së edukimit, kryesisht të zhvillimit njohës sipas moshave, me konsideratë të veçantë Zonën e

**Zgjeroni dhe thelloni ditjet** Për më shumë lexoni në: Woolfolk, A. (2011) Psikologji edukimi. Tiranë: CDE, faqe 47-51.

Zhvillimit Proksimal të Vigotskit, e cila është zona midis nivelit aktual të zhvillimit të fëmijës sipas përcaktimit të aftësive për zgjidhjen e pavarur të problemeve dhe nivelit të zhvillimit që fëmija është në gjendje të arrijë, përmes orientimit të të rriturve, apo në bashkëpunim me bashkëmoshtarët e tij më të aftë. Kjo është një hapësirë dinamike ku mësimdhënësia mund të japë rezultate e ndodhet diku midis asaj që nxënësi di dhe asaj

që nxënësi nuk është gati të mësojë. Zona e Zhvillimit Proksimal është hapësira e mësimin midis së mërzitshmes dhe të së pamundurës. Në këtë hapësirë, mbështetja nga mësuesi/ja apo nga një bashkëmoshtar mund të bëjë që mësimi të japë rezultat.



Burimi: *Psikologji edukimi*, (faqe 47), A. Woolfolk, 2011. Botuar në Tiranë: CDE



**Zgjeroni dhe thelloni dijet** Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011) *Psikologji edukimi*. Tiranë: CDE, faqe 32-36.

## Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 2

I Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv	
1.	Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë.
2.	Shkruan një tekst deri në një faqe (500 fjalë) e më shumë për një temë të caktuar.
3.	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.
4.	Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërën nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.
5.	Merr pjesë në organizimin e një shfaqjeje artistike në harmoni me moshën e vet, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.
6.	Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo ndonjë ngjarjeje nga jeta, bën dallimin e tyre duke bërë një listë me vetitë që i pëlqejnë dhe që nuk i pëlqejnë tek ata, diskuton rreth tyre, performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarë.
7.	Shpreh, në formë verbale dhe të shkruar, fjali të thjeshta në gjuhë të huaj dhe përkthen në gjuhë amtare fjali të tjera të thjeshta që i dëgjon nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësuesi/ja në gjuhë të huaj të dhëna si detyrë.
8.	Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta, duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët, si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera.

II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ	
1.	Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njëres nga format shprehëse.
2.	Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera).
3.	Paraqet për diskutim argumentet për pajtueshmërinë ose kundërshtimin për një mendim e qëndrim të shprehur apo sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
4.	Zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkenca e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull e më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situata të ngjashme.
5.	Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës, duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.
6.	Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, shoqërore-historike) në njërën nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie.
7.	Paraqet dhe arsyeton me argumente mënyrën e zgjidhjes së një problemi/detyrë të caktuar të fushave të ndryshme (matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore etj.) në kohëzgjatje prej 6-10 minutash.
8.	Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërrimeve apo pozitive në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimet të tyre).



III. Kompetenca e të nxënës – Nxënës i suksesshëm	
1.	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes.
2.	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.
3.	Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuara, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shenjuar me shenja të ndryshme).
4.	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.
5.	Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar.
6.	Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara dhe bën një plan për mënyrën e korrigjimeve të nevojshme.
7.	Identifikon cilësitë e veta që i posedon dhe cilësitë e nevojshme që duhet t'i zhvillojë për të nxënë një detyrë apo aktivitetet të caktuara dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.
8.	Menaxhon sjelljet e veta, materialet/mjetet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti individual apo të përbashkët në klasë/shkollë apo jashtë saj.
9.	Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinën për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribuues produktiv	
1.	Përgatit një autobiografi në të cilën prezanton veten me të dhënat personale dhe me prirjet për fusha të caktuara, duke i gjetur të përbashkëtat me profesionet e dëshiruara.
2.	Përgatit një plan pune për një javë dhe specifikon aktivitetet më me prioritet, duke arsyetuar përzgjedhjen e tyre.
3.	Përgatit një projekt të vogël, duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupon atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.
4.	Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes.
5.	Debaton me moshatarë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë/laborator, në shkollë dhe në mjedise të tjera apo për një grup të caktuar njerëzish për një situatë të caktuar, duke mbrojtur idetë e veta me shembuj konkretë.
6.	Identifikon ushqimet më të shpeshta, materialet e tjera shpenzuese të familjes apo harxhimet vetjake dhe llogarit shpenzimet për një javë, të dhënat e gjetura i paraqet në formë tabelare/grafike apo në një formë tjetër.
7.	Lexon etiketën, udhëzuesin e produkteve të ndryshme (rrobave, ushqimit, barnave apo të teknikës) dhe jep sqarim për prejardhjen, përmbajtjen, përdorimin, mënyrën e mirëmbajtjes apo për rreziqet në rast mospërdorimi të drejtë - adekuat.
8.	Paraqet në formë tabelare, grafike, të vizatimit apo në një formë tjetër, aktivitetet e kujdesit që i bën ndonjë qenieje të gjallë, të cilat i mundësojnë zhvillimin, rritjen apo ruajtjen e shëndetit të tij/saj.

## V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

1.	Prezanton para të tjerëve mënyrën e zbatimit të rregullave themelore të higjienës personale (fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit, ku jeton dhe vepron, përmes formave të ndryshme të shprehjes.
2.	Merr pjesë në aktivitete fizike - lojëra lëvizore dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer, menaxhon emocionet e veta dhe prezanton para të tjerëve gjendjen fizike dhe shpirtërore pas realizimit të një aktiviteti fizik apo loje sportive.
3.	Përgatit një listë (me njëri nga format e shprehjes, shkrim, vizatim etj.) me ushqimet që i konsumon familja, duke i renditur ato sipas kalorisë dhe më pas i klasifikon në ushqime të shëndetshme dhe më pak të shëndetshme.
4.	Lexon të dhënat në paketim të ushqimit dhe diskuton në grup për këto të dhëna (vlerat ushqyese, afatet e prodhimit etj.).
5.	Identifikon përparësitë dhe mangësitë e personalitetit të vet dhe jep mendime për mënyrën e përmirësimit, në forma të ndryshme shprehëse.
6.	Propozon alternativa për zgjidhjen konstruktive të një konflikti ndërpersonal, duke i analizuar paraprakisht me kujdes rrethanat që kanë shkaktuar konfliktin, ndan përvojat, mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit.
7.	Dallon dhe përshkruan rolet e personave dhe shërbimeve të nevojshme për kërkimin e ndihmës në situata të caktuara të rrezikut të shëndetit të vet, fizik dhe mendor.
8.	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).
9.	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve të tjerë kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

## VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

1.	Paraqet në forma të ndryshme të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të familjes së vet dhe i diskuton ato me të tjerët, më pas i krahason me të drejtat dhe përgjegjësitë e nxënësve, mësuesve dhe stafit menaxhues në shkollë apo me pjesëtarët e ndonjë institucioni.
2.	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendosin për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.
3.	Propozon vlera shoqërore, që janë të rëndësishme të kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh., besimi i ndërsjellë, toleranca, solidariteti, respekti, mirësjellja etj.) dhe me shembull konkret përshkruan ndonjë situatë ku gjen shprehje ndonjëra nga to.
4.	Manifeston veprime që shprehin mirësjellje në situata të ndryshme dhe me shembull konkret tregon përdorimin e tyre në klasë/shkollë, në familje e në komunitet.
5.	Propozon dhe ndan mendimin me shokët/shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve të aktiviteteve të ndryshme me karakter mësimor, të këshillave në klasë apo në shkollë, përbërjen dhe rolin e tyre.
6.	Merr pjesë në hartimin e rregullave të lojës, në klasë, në shkollë (p.sh., si propozues rregullash, menaxhues i propozimeve nga të tjerët etj.) dhe argumenton rëndësinë e respektimit të ndonjërisë rregull të propozuar në forma të ndryshme të shprehjes, duke parashikuar pasojat e moszbatimit të saj.
7.	Identifikon dy e më shumë organizime shoqërore dhe përshkruan (në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjetër) mënyrat/mundësitë se si njerëzit e ndryshëm me përvoja të ndryshme mund të organizojnë diçka të përbashkët.
8.	Prezanton në mënyrë kronologjike ndryshimet e familjes dhe të rrethit në aspekte të ndryshme (si: objektet e banimit, festat, veshjet, ushqimet - mënyra e të ushqyerit, menaxhimi i ekonomisë familjare, të drejtat, përgjegjësitë dhe vendimmarrja në familje etj.) ose disa nga personalitetet dhe ngjarjet kryesore të popullit të vet, duke e dalluar të tashmen nga e kaluara.
9.	Paraqet me shembuj konkretë sjelljet që duhen manifestuar në rast rreziku nga fatkeqësitë natyrore apo të krijuara nga njeriu, si: zjarri, vërshimi, tërmeti, komunikimi me njerëz të panjohur etj.



## Rezultatet e të nxënit të fushës së shkencave natyrore - Shkalla 2

I. NJOHURITË, TË KUPTUARIT DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen	
Strukturimi i mendimit shkencor për konceptet, modelet, teoritë dhe ligjet për ndërtimin e lëndës, proceseve dhe dukurive në natyrë (proceset dhe dukuritë fizike, kimike, biologjike, gjeografike në Tokë dhe Gjithësi).	
<b>Nxënësi/ja:</b>	
1.	Identifikon dhe hulumton materialet natyrore dhe artificiale që përdoren në jetën e përditshme sipas vetive dhe shndërrimeve të tyre.
2.	Përshkruan dhe hulumton tiparet themelore të ndërtimit dhe funksionit të organizmit të njeriut dhe qenieve të tjera të gjalla, ciklin jetësor të qenieve të gjalla, proceset riprodhuese të bimëve dhe shtazëve, zinxhirët e ushqimit dhe rolin e mikroorganizmave në mjedis.
3.	Shpjegon mënyra të ruajtjes së ushqimeve, konsumimin e sigurt të tyre dhe efektet e substancave të dëmshme për organizmin (duhani, alkooli, pijet energjike).
4.	Mat me instrumente përkatëse dhe sqaron ndërrimin e temperaturës gjatë ditës, natës, stinëve të vitit dhe gjendjen agregate të lëndëve.
5.	Përshkruan bashkëveprimin e trupave, të lëndëve dhe të qenieve të gjalla.
6.	Përshkruan pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, lëvizjet e Tokës, Diellit, Hënës dhe trupave tjerë të këtij sistemi, elementet e hartës, përmbajtjen e hartës, legjendën e hartës, shenjat hartografike, skicën, planin, globin, veçoritë e elementeve natyrore të mjedisit natyror (relivin, klimën, ujërat, botën bimore dhe shtazore), bashkëveprimin njeri-natyrë, rreziqet natyrore, resurset natyrore e objektet e trashëgimisë natyrore, në veçanti ato të Republikës së Kosovës.

II. Zhvillimi i shkathtësive të kërkimit shkencor për ndërtimin e lëndës, proceseve dhe dukurive në natyrë	
<b>Nxënësi/ja:</b>	
1.	Formulon pyetje për objektet, gjallesat dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij dhe ndërlidhjen mes tyre.
2.	Ofron sugjerime (hipoteza) të bazuara në vëzhgim për rezultatet e mundshme të hulumtimit.
3.	Kryen vëzhgime sistematike dhe mban shënime gjatë matjeve me njësi standarde përmes pajisjeve (veglave) të ofruara nga mësuesi/ja.
4.	Përdor rezultatet e hulumtimit për të arritur përfundime (konkluzione).
5.	Prezanton të dhënat (të gjeturat) dhe konkluzionet, duke përdorur shpjegimet me gojë dhe me shkrim, diagramet dhe grafikët apo TIK-un.
6.	Identifikon ngjashmëritë dhe dallimet që ndërlidhen me idetë dhe proceset shkencore.

III. QËNDRIMET DHE VLERAT që zhvillohen	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kureshtja për hulumtimin e botës së gjallë dhe jo të gjallë në natyrë.</li> <li>• Qëndrimi ndaj pyetjeve dhe përpjekje për të gjetur përgjigje.</li> <li>• Interesimi për të njohur karakteristikat dhe nevojat jetësore të qenieve të gjalla.</li> <li>• Kujdesi për jetën personale, shëndetin e tij dhe të tjerëve.</li> <li>• Kujdesi gjatë përdorimit të veglave dhe mjeteve, si dhe respektimi i rregullave të sigurisë gjatë punës.</li> </ul>	

IV. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen	
Identifikim; përshkrim; zbatim; njehsime; matje; skicime; demonstrim; hulumtim modelim; krahasim; vlerësim.	

## Planifikimi vjetor i temave mësimore për fushën e kurrikulës: Shkencat e natyrës

### Klasa IV

Lëndët e fushës kurrikulare	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 1 (klasa IV)
	GJYSMËVJETORI I		GJYSMËVJETORI II		
	shtator—tetor	nëntor—dhjetor	janar—shkurt—mars	prill—maj—qershor	
Njeriu dhe natyra	<p>Prejardhja, përbërja dhe vetitë e materialeve</p> <p>Lëndët e pastra, lëndët e përziera dhe tretësirat</p> <p>Ajri dhe përbërësit e tij</p> <p>Riprodhimi i qenieve të gjalla</p>	<p>Riprodhimi i qenieve të gjalla</p> <p>Ruajtja e ushqimit dhe lëndët helmuese</p> <p>Jetojmë dhe rritemi</p> <p>Puberteti dhe përshtatja</p> <p>Bashkëveprimet dhe lëvizjet</p>	<p>Bashkëveprimet dhe lëvizjet</p> <p>Bashkëveprimi elektrik dhe magnetik</p> <p>Vendi dhe hapësira</p>	<p>Vendi dhe hapësira</p> <p>Sistemet fizike</p> <p>Bashkëveprimi njeri-natyre</p>	<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv I.1, 2, 3, 8</p> <p>Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ II.1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8</p> <p>Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm III.1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9</p> <p>Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv IV.3, 4, 5</p> <p>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë V.4, 5, 8, 9</p> <p>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm VI.2, 5, 9</p>
	orë	orë	orë	orë	

# PLANI DYMUJOR: SHTATOR—TETOR

## Lënda mësimore: Njeriu dhe natyra

**Fusha e kurrikulës:** Shkencat e natyrës

**Klasa:** IV

**Tema mësimore:** Prejardhja, përbërja dhe vetitë e materialeve  
Lëndët e pastra, lëndët e përziera dhe tretësirat  
Ajri dhe përbërësit e tij  
Riprodhimi i qenieve të gjalla

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv</i>	
I.1	Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë;
I.2	Shkruan një tekst deri në një faqe (500 fjalë) e më shumë për një temë të caktuar;
I.3	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ	
II.1	Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njërës nga format shprehëse;
II.2	Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera);
II.5	Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës, duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna;
II.6	Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, shoqërore - historike) në njërin nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie;
II.8	Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërrimeve apo pozitive në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimit) të tyre.

Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm	
III.1	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën a problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes;
III.3	Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shenjuar me shenja të ndryshme);
III.4	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij a saj;
III.5	Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar;
III.6	Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara dhe bën një plan për mënyrën e korrigjimeve të nevojshme;
III.8	Menaxhon sjelljet e veta, materialet a mjetet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre a veprimtarie individuale apo të përbashkët në klasë a shkollë apo jashtë saj.

### Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv

IV.4	Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes.
------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

### Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.8	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti a aktiviteti në bazë klase a shkolle apo jashtë saj);
V.9	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve të tjerë kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtja e rregullt e sendeve që e rrethojnë etj.).

### Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.2	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një veprimtarie të përbashkët.
------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

### RNF- Rezultatet e të nxënimit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit

1.1	Identifikon dhe hulumton materialet natyrore dhe artificiale që përdoren në jetën e përditshme sipas vetive dhe shndërrimeve të tyre;
1.2	Përshkruan dhe hulumton tiparet themelore të ndërtimit dhe funksionit të organizmit të njeriut dhe qenieve të tjera të gjalla, ciklin jetësor të qenieve të gjalla, proceset riprodhuese të bimëve dhe shtazëve, zinxhirët e ushqimit dhe rolin e mikroorganizmave në mjedis;
1.5	Përshkruan bashkëveprimin e trupave, të lëndëve dhe të qenieve të gjalla;
2.1	Formulon pyetje për objektet, gjallesat dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij dhe ndërlihdjen mes tyre;
2.2	Ofron sugjerime (hipoteza) të bazuara në vëzhgim për rezultatet e mundshme të hulumtimit;
2.3	Kryen vëzhgime sistematike dhe mban shënime gjatë matjeve me njësi standarde përmes pajisjeve (veglave) të ofruara nga mësuesi/ja;
2.5	Prezanton të dhënat (të gjeturat) dhe konkluzionet, duke përdorur shpjegimet me gojë dhe me shkrim, diagramet dhe grafikët apo TIK-un.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxëniet për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e Vlerësimit	Metodologjia e Vlerësimit	Njësitë mësimore	Njësitë mësimore
<b>Materialet, prejardhja dhe përbërja e vetitë e tyre</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Dallon materialet në bazë të prejardhjes natyrë e gjallë dhe ajo jo e gjallë (materialet metalike, minerale, organike dhe kompozite);</li> <li>- Krahason materialet e ndryshme sipas dendësisë, përcjellshmërisë termike e elektrike, sipas fortësisë dhe i ndërlidh ato me përdorimin e tyre;</li> <li>- Klasifikon materialet në bazë të përbërjes në: lëndë të pastra dhe lëndë të përziera;</li> <li>- Dallon përzierjet dhe tretësirat;</li> <li>- Demonstron ndarjen e përzierjeve me metodën e filtrimit dhe dekantimit;</li> <li>- Krahason tretjen e substancave të ndryshme në ujë dhe varësinë e tretshmërisë nga temperatura;</li> <li>- Shpjegon se gjendja agregate e materialit varet nga kushtet e jashtme sidomos nga temperatura;</li> <li>- Dallon përbërësit kryesorë të ajrit (azoti, oksigjeni, dyoksidi i karbonit), si dhe demonstroi me anë të eksperimentit ndonjërin nga to;</li> <li>- Interpreton rëndësinë e oksigjenit për frymëmarrjen, si dhe rëndësinë e mbrojtjes së ajrit prej pa-pastërtive;</li> <li>- Identifikon mënyrat e riprodhimit të qenieve të gjalla, si një ndër proceset jetësore;</li> <li>- Shpjegon procesin e riprodhimit të qenieve të gjalla;</li> <li>- Krahason të veçantat dhe të përbashkëtat e riprodhimit tek organizmat e grupeve të ndryshme.</li> </ul>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Materialet metalike dhe materiet minerale</li> <li>2. Materialet metalike dhe materiet minerale - Fletore pune</li> <li>3. Materialet organike dhe ato kompozite</li> <li>4. Vetitë dhe përdorimi i materialeve</li> <li>5. Vetitë dhe përdorimi i materialeve - Fletore pune</li> <li>6. Lëndët e pastra, ato të përziera dhe tretësirat</li> <li>7. Ndarja e përzierjeve</li> <li>8. Ndarja e përzierjeve - Fletore pune</li> <li>9. Tretja e lëndëve të ndryshme në ujë dhe varësia nga temperatura</li> <li>10. Tretja e lëndëve të ndryshme në ujë dhe varësia nga temperatura - Fletore pune</li> <li>11. Përbërësit kryesorë të ajrit</li> <li>12. Përbërësit kryesorë të ajrit - Fletore pune</li> <li>13. Mbrojtja e ajrit nga ndotja</li> <li>14. Riprodhimi te bimët</li> <li>15. Riprodhimi te kafshët</li> <li>16. Riprodhimi i bimëve dhe i kafshëve - Fletore pune</li> <li>17. Riprodhimi te njerëzit</li> <li>18. Riprodhimi te njerëzit - Fletore pune</li> </ol>	18	<p>Mësimdhënia dhe të nxënë të nxënë me fëmijët në qendër dhe gjithëpërfshirja</p> <p>Mësimdhënia dhe të nxënë të bazuar në rritjen e kompetencave</p> <p>Mësimdhënia dhe të nxënë të integruar</p> <p>Mësimdhënia dhe të nxënë të diferencuar</p>	<p>Vlerësim somativ</p> <p>Vlerësim formativ</p> <p>Vlerësim i vazhdueshëm</p> <p>Vlerësim përmbledhës</p> <p>(Vendos instrumentet)</p>	<p>Gjuhë shqipe</p> <p>Shoqëria dhe mjedisi</p> <p>Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti</p> <p>Shkathtësi për jetë</p> <p>Edukatë figurative</p> <p>Çështje ndërkurrikulare</p> <p>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</p> <p>Edukim për paqe</p> <p>Globalizimi dhe ndërmarrësia</p>	<p>“Njeriu dhe natyra 4”</p> <p>“Njeriu dhe natyra 4 - fletore pune”</p> <p>www.dukagjini-botime.com</p>

# PLANI DYMUJOR: NËNTOR—DHJETOR

## Lënda mësimore: Njeriu dhe natyra

**Fusha e kurrikulës:** Shkencat e natyrës

**Klasa:** IV

**Tema mësimore:** Riprodhimi i qenieve të gjalla  
Ruajtja e ushqimit dhe lëndët helmuese  
Jetojmë dhe rritemi  
Puberteti dhe përshtatja  
Bashkëveprimet dhe lëvizjet

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:** *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv*

I.1	Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë;
I.3	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.

### Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.1	Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njëres nga format shprehëse;
II.2	Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera);
II.3	Paraqet për diskutim argumentet për pajtueshmërinë ose kundërshtimin për një mendim e qëndrim të shprehur apo sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj);
II.5	Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës, duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna;
II.6	Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, shoqërore - historike) në njërin nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie;
II.8	Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërrimeve apo pozitive në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimet) të tyre.

### Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm

III.1	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njëres nga format e shprehjes;
III.2	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar;
III.3	Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shenjuar me shenja të ndryshme);
III.4	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj;
III.5	Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar;
III.6	Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara dhe bën një plan për mënyrën e korrigjimeve të nevojshme;
III.8	Menaxhon sjelljet e veta, materialet/mjetet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti individual apo të përbashkët në klasë/shkollë apo jashtë saj;

### Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv

IV.4	Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes.
------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

### Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.1	Prezanton para të tjerëve mënyrën e zbatimit të rregullave themelore të higjienës personale (fizike, të veshmbathjes, të gjësëndeve personale) dhe të higjienës së mjedisit, ku jeton dhe vepron, përmes formave të ndryshme të shprehjes;
V.3	Përgatit një listë (me njëërën nga format e shprehjes, shkrim, vizatim etj.) me ushqime, të cilat i konsumon familja, duke i renditur ato sipas kalorisë dhe më pas i klasifikon në ushqime të shëndetshme dhe më pak të shëndetshme;
V.4	Lexon të dhënat në paketim të ushqimit dhe diskuton në grup për këto të dhëna (vlerat ushqyese, afatet e prodhimit etj.).
V.5	Identifikon: përparësitë dhe mangësitë e personalitetit të vet dhe jep mendime për mënyrën e përmirësimit, në forma të ndryshme shprehëse;
V.8	V.8 Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj);
V.9	V.9 Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve të tjerë kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtja e rregullt e sendeve që e rrethojnë etj.).

### Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.2	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një veprimtarie të përbashkët.
------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

### RNF - Rezultatet e të nxënimit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit

1.2	Përshkruan dhe hulumton tiparet themelore të ndërtimit dhe funksionit të organizmit të njeriut dhe qenieve të tjera të gjalla, ciklin jetësor të qenieve të gjalla, proceset riprodhuese të bimëve dhe shtazëve, zinxhirët e ushqimit dhe rolin e mikroorganizmave në mjedis;
1.3	Shpjegon mënyra të ruajtjes së ushqimeve, konsumimin e sigurt të tyre dhe efektet e substancave të dëmshme për organizmin (duhani, alkooli, pijet energjike);
1.4	Mat me instrumente përkatëse dhe sqaron ndërrimin e temperaturës gjatë ditës, natës, stinëve të vitit dhe gjendjen agregate të lëndëve;
1.5	Përshkruan bashkëveprimin e trupave, të lëndëve dhe të qenieve të gjalla.
2.1	Formulon pyetje për objektet, gjallesat dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij dhe ndërlidhjen mes tyre;
2.2	Ofron sugjerime (hipoteza) të bazuara në vëzhgim për rezultatet e mundshme të hulumtimit;
2.3	Kryen vëzhgime sistematike dhe mban shënime gjatë matjeve me njësi standarde përmes pajisjeve (veglave) të ofruara nga mësuesi/ja;
2.5	Prezanton të dhënat (të gjeturat) dhe konkluzionet, duke përdorur shpjegimet me gojë dhe me shkrim, diagramet dhe grafikët apo TIK-un.

Për mësuesin/en		Koha mësimore (orë mësimore)					Metodologjia e Vlerësimit		Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore		Burimet	
Temat mësimore	Rezultatet e të nxëniet për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e Vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet					
<b>Riprodhimi të qeniet e gjalla</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikon mënyrat e riprodhimit të qenieve të gjalla, si një ndër proceset jetësore; Shpjegon procesin e riprodhimit të qenieve të gjalla;</li> <li>- Identifikon mënyra të ruajtjes së ushqimit nga faktorët mjedisorë.</li> <li>- Analizon rëndësinë e të ushqyerit shëndetshëm.</li> <li>- Vlerëson rolin biologjik të të ushqyerit dietal.</li> <li>- Emërton substanca helmuese – duhani, alkooli, kafa etj.</li> <li>- Propozon masa parandaluese për ushqyeshmëri jo të shëndetshme.</li> <li>- Gjykon për efekte anësore të përdorimit të substancave helmuese.</li> <li>- Përshkruan zhvillimin dhe ndryshimet e trupit, gjatë moshës së pubertetit.</li> <li>- Diskuton lidhur me adoptimin e trupit gjatë pubertetit, marrëdhëniet me të tjerët.</li> <li>- Përshkruan ndryshimet fizike, emocionale dhe mendore që ndodhin në trup në fazën e pubertetit.</li> <li>- Përshkruan veprimet që duhet t'i bëjë për të mirëmbajtur dhe menaxhuar trupin e tij/saj në këtë fazë.</li> <li>- Përkufizon masën, vëllimin dhe dendësinë dhe dallon trupat e ngurtë, lëndët e lëngëta dhe lëndët e gazta sipas vetive të tyre.</li> <li>- Dallon lloje të ndryshme të rrugëve dhe të lëvizjeve të trupave.</li> <li>- Përshkruan mënyrat e krijimit të valëve dhe shembuj të paraqitjes së tyre në natyrë.</li> </ul>	<p>19. Ndikimi i njeriut në biodiversitet</p> <p>20. Mënyrat e ruajtjes së ushqimit</p> <p>21. Rëndësia e të ushqyerit shëndetshëm</p> <p>22. Rëndësia e të ushqyerit shëndetshëm - Fletore pune</p> <p>23. Si të mbahet ushqimi pastër dhe si të ushqehemi shëndetshëm?</p> <p>24. Lëndët helmuese për organizmin</p> <p>25. Lëndët helmuese për organizmin - Fletore pune</p> <p>26. Zhvillimi dhe ndryshimet në trupin e njeriut</p> <p>27. Zhvillimi dhe ndryshimet në trupin e njeriut - Fletore pune</p> <p>28. Mirëmbajtja e trupit</p> <p>29. Mirëmbajtja e trupit - Fletore pune</p> <p>30. Përkufizimi i masës, i vëllimit dhe i dendësisë</p> <p>31. Përkufizimi i masës, i vëllimit dhe i dendësisë - Fletore pune</p> <p>32. Vetitë e trupave</p> <p>33. Lëvizjet e trupave</p> <p>34. Vetitë dhe lëvizja e trupave - Fletore pune</p> <p>35. Valët dhe mënyra e krijimit të tyre</p>	17	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mësimdhënia dhe të nxënëti me fëmijët në qendër dhe gjithëpërfshirja</li> <li>- Mësimdhënia dhe të nxënëti e bazuar në rritjen e kompetencave</li> <li>- Mësimdhënia dhe të nxënëti e integruar</li> <li>- Mësimdhënia dhe të nxënëti e diferencuar</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vlerësim somativ</li> <li>Vlerësim formativ</li> <li>Vlerësim i vazhdueshëm</li> <li>Vlerësim përmbledhës (Vendos instrumentet)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Gjuhë shqipe</li> <li>Shoqëria dhe mjedisi</li> <li>Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti</li> <li>Shkathësi për jetë</li> <li>Edukatë figurative</li> <li>Çështje ndërkurrikulare</li> <li>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</li> <li>Edukim për paqe</li> <li>Globalizimi dhe ndërmarrësia</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>“Njeriu dhe natyra 4”</li> <li>“Njeriu dhe natyra 4 - fletore pune”</li> <li>www.duka-gjinibotime.com</li> </ul>					
<b>Bashkëveprimet dhe lëvizjet</b>												



# PLANI TREMUJOR: JANAR—SHKURT—MARS

## Lënda mësimore: Njeriu dhe natyra

**Fusha e kurrikulës:** Shkencat e natyrës

**Klasa:** IV

**Tema mësimore:** Bashkëveprimet dhe lëvizjet  
Bashkëveprimi elektrik dhe magnetik  
Vendi dhe hapësira

### Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellitimit të temës/temave: *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv*

I.1	Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë;
I.3	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.

### Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.4	Zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkencat e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull e më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situata të ngjashme;
II.5	Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës, duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.
II.7	Paraqet dhe arsyeton me argumente mënyrën e zgjidhjes së një problemi/detyrë të caktuar të fushave të ndryshme (matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore... etj.) në kohëzgjatje prej 6-10 minutash.
II.8	Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërrimeve apo pozitive në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimet) të tyre.

### Kompetenca e të nxënësve - Nxënës i suksesshëm

III.1	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën a problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes;
III.2	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar;
III.3	Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuara, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shenjuar me shenja të ndryshme);
III.4	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij a saj;
III.5	Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyrë apo një aktiviteti të caktuar;
III.6	Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara dhe bën një plan për mënyrën e korrigjimeve të nevojshme;
III.7	Identifikon cilësitë e veta që i posedon dhe cilësitë e nevojshme që duhet t'i zhvillojë për të nxënë një detyrë apo aktivitetet të caktuara dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.
III.8	Menaxhon sjelljet e veta, materialet a mjetet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyrë a veprimtarie individuale apo të përbashkët në klasë a shkollë apo jashtë saj.

### Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv

IV.5	Debaton me moshatarë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë - laborator, në shkollë dhe në mjedis të tjera apo për një grup të caktuar njerëzish për një situatë të caktuar, duke mbrojtur idetë e veta me shembuj konkretë.
------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

### Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.8	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti a aktiviteti në bazë klase a shkolle apo jashtë saj);
V.9	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve të tjerë kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtja e rregullt e sendeve që e rrethojnë etj.).

### Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.2	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një veprimtarie të përbashkët;
VI.5	Propozon dhe ndan mendimin me shokët a shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve të aktiviteteve të ndryshme me karakter mësimor, të këshillave në klasë apo në shkollë, përbërjen dhe rolin e tyre;
VI.9	Paraqet me shembuj konkretë sjelljet që duhen manifestuar në rast rreziku nga fatkeqësitë natyrore apo të krijuara nga njeriu, si: zjarri, vërshimi, tërmeti, komunikimi me njerëz të panjohur etj.

### RNF - Rezultatet e të nxënimit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit

1.4	Mat me instrumente përkatëse dhe sqaron ndërrimin e temperaturës gjatë ditës, natës, stinëve të vitit dhe gjendjen agregate të lëndëve;
1.5	Përshkruan bashkëveprimin e trupave, të lëndëve dhe të qenieve të gjalla;
1.6	Përshkruan pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, lëvizjet e Tokës, të Diellit, Hënës dhe të trupave të tjerë të këtij sistemi, elementet e hartës, përmbajtjen e hartës, legjendën e hartës, shenjat hartografike, skicën, planin, globin, veçoritë e elementeve natyrore të mjedisit natyror (relievin, klimën, ujërat, botën bimore dhe shtazore), bashkëveprimin njeri/natyrë rreziqet natyrore, resurset natyrore e objektet e trashëgimisë natyrore në veçanti ato të Republikës së Kosovës.
2.1	Formulon pyetje për objektet, gjallesat dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij dhe ndërlidhjen mes tyre;
2.2	Ofron sugjerime (hipoteza) të bazuara në vëzhgim për rezultatet e mundshme të hulumtimit;
2.3	Kryen vëzhgime sistematike dhe mban shënime gjatë matjeve me njësi standarde përmes pajisjeve (veglave) të ofruara nga mësuesi/ja;
2.4	Përdor rezultatet e hulumtimit për të arritur përfundime (konkluzione);
2.5	Prezanton të dhënat (të gjeturat) dhe konkluzionet, duke përdorur shpjegimet me gojë dhe me shkrim, diagramet dhe grafikët apo TIK-un;
2.6	Identifikon ngjashmëritë dhe dallimet që ndërlidhen me idetë dhe proceset shkencore.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxëniet për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<b>Bashkëveprimet dhe lëvizjet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkufizon masën, vëllimin dhe dendësinë dhe dallon trupat e ngurtë, lëndët e lëngëta dhe lëndët e gazta sipas vetive të tyre.</li> <li>- Dallon lloje të ndryshme të rrugëve dhe të lëvizjeve të trupave.</li> </ul>	<p>36. Valët dhe mënyra e krijimit të tyre - Fletore pune</p> <p>37. Ndryshimet (shndërrimet) e kthyeshme dhe të pakthyeshme të lëndës</p>	21	Mësimdhënia dhe të nxënëtit me fëmijët në qendër dhe gjithëpërfshirja	Vlerësim somativ	Gjuhë shqipe	“Njeriu dhe natyra 4”
<b>Bashkëveprimi elektrik dhe magnetik</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkufizon masën, vëllimin dhe dendësinë dhe dallon trupat e ngurtë, lëndët e lëngëta dhe lëndët e gazta sipas vetive të tyre.</li> <li>- Dallon lloje të ndryshme të rrugëve dhe të lëvizjeve të trupave.</li> <li>- Përkufizon mënyrat e krijimit të valëve dhe shembuj të paraqitjes së tyre në natyrë.</li> <li>- Shpjegon shndërrimet e kthyeshme dhe të pakthyeshme të lëndës.</li> </ul>	<p>37. Ndryshimet (shndërrimet) e kthyeshme dhe të pakthyeshme të lëndës</p> <p>38. Ndryshimet (shndërrimet) e kthyeshme dhe të pakthyeshme të lëndës - Fletore pune</p> <p>39. Demonstrimi i shembujve nga bashkëveprimet dhe lëvizjet e trupave</p> <p>40. Shtypja atmosferike dhe pesha e ajrit</p> <p>41. Ndikimi i temperaturës në qarkullimin e ajrit dhe në mot</p> <p>42. Ndikimi i temperaturës në qarkullimin e ajrit dhe në mot</p> <p>43. Fletore pune</p> <p>44. Vllimi, avullimi dhe lëngëzimi i ujit</p> <p>Burimet e energjisë së pastër dhe burimet që e ndotin mjedisin</p>	21	Mësimdhënia dhe të nxënëtit e bazuar në rritjen e kompetencave	Vlerësim formativ	Shoqëria dhe mjedisi	“Njeriu dhe natyra 4 - fletore pune”
<b>Vendi dhe hapësira</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Demonstron shembuj të përzierjes vetvetiu të lëndëve të lëngëta dhe të gazta në jetën e përditshme.</li> <li>- Demonstron pluskimin, zhytjen dhe fundosjen e trupave në ujë, duke u bazuar në dendësinë dhe sipërfaqe të tyre.</li> <li>- Demonstron paraqitjen e forcës shtytëse në trupin e zhytur në lëng.</li> <li>- Demonstron shembuj të paraqitjes së shtypjes atmosferike dhe pesës së ajrit.</li> <li>- Paraqet shembuj të zgjerimit të ajrit, me zmadhimin e temperaturës dhe shpjegon qarkullimin e tij, si dhe motin e klimën.</li> <li>- Dallon burimet e energjisë së pastër nga burimet që e ndotin mjedisin.</li> <li>- Shqyrton shembuj të avullimit, valimit dhe lëngëzimit të ujit në varësi të temperaturës.</li> <li>- Ndërton elektroskopin e thjeshtë dhe me të dallon trupat që ngarkohen dhe nuk ngarkohen me elektricitet.</li> <li>- Shpjegon elektricitetin atmosferik dhe mbrojtjen prej tij.</li> <li>- Demonstron me dy elektroskopa përçuesit dhe veçuesit e rrymës elektrike.</li> </ul>	<p>38. Ndryshimet (shndërrimet) e kthyeshme dhe të pakthyeshme të lëndës - Fletore pune</p> <p>39. Demonstrimi i shembujve nga bashkëveprimet dhe lëvizjet e trupave</p> <p>40. Shtypja atmosferike dhe pesha e ajrit</p> <p>41. Ndikimi i temperaturës në qarkullimin e ajrit dhe në mot</p> <p>42. Ndikimi i temperaturës në qarkullimin e ajrit dhe në mot</p> <p>43. Fletore pune</p> <p>44. Vllimi, avullimi dhe lëngëzimi i ujit</p> <p>Burimet e energjisë së pastër dhe burimet që e ndotin mjedisin</p>	21	Mësimdhënia dhe të nxënëtit e integruar	Vlerësim përmbledhës (Vendos instrumentet)	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	www.dukagjinibotime.com

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndërton qarkun e thjeshtë elektrik, ilustron skemën e tij dhe përshkruan rolin e çdo pjese përbërëse.</li> <li>- Dallon përcjellësit dhe veçuesit elektrikë me ndihmën e qarkut elektrik.</li> <li>- Demonstron mbylljen e qarkut elektrik me tretësirë ujore të kripës.</li> <li>- Identifikon pajisjet e përditshme në shtëpi që punojnë me rrymë, qarkun e shkurtër dhe rrezikun nga rryma elektrike.</li> <li>- Shpjegon me demonstrim veprimin magnetik të magnetit në mjedisë dhe dallon lëndët që magnetizohen nga ato që nuk magnetizohen.</li> <li>- Ndërton elektromagnetin e thjeshtë dhe demonstroi vetitë magnetike të tij.</li> <li>- Shpjegon pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, lëvizjet e Tokës, të Diellit, Hënës, të trupave të tjerë të këtij sistemi dhe përshkruan mënyrat kryesore të orientimit në natyrë (përmes Diellit, busullës, Yllit Polar, Hënës, orës së dorës, hijes së mesditës, objekteve, drurëve etj.).</li> <li>- Identifikon dhe shpjegon mënyrat e ndryshme të paraqitjes së Tokës në hartë, glob dhe plan, duke treguar dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis tyre.</li> </ul>	<p>45. Burimet e energjisë së pastër dhe burimet që e ndotin mjedisin - Fletore pune</p> <p>46. Elektriciteti dhe magnetizmi</p> <p>47. Elektriciteti atmosferik dhe mbrojtja prej tij</p> <p>48. Elektriciteti atmosferik dhe mbrojtja prej tij - Fletore pune</p> <p>49. Qarku i thjeshtë elektrik</p> <p>50. Qarku i thjeshtë elektrik - Fletore pune</p> <p>51. Pajisjet që punojnë me rrymë dhe rreziku nga rrymat elektrike</p> <p>52. Veprimi magnetik</p> <p>53. Elektromagnetit i thjeshtë</p> <p>54. Veprimi magnetik - Fletore pune</p> <p>55. Pozita e Tokës në Sistemin Diellor</p> <p>56. Pozita e Tokës në Sistemin Diellor - Fletore pune</p>			
--	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	--	--

# PLANI TREMUJOR: PRILL—MAJ—QERSHOR

## Lënda mësimore: Njeriu dhe natyra

**Fusha e kurrikulës:** Shkencat e natyrës

**Klasa:** IV

**Tema mësimore:** Vendi dhe hapësira  
Sistemet fizike  
Bashkëveprimi njeri-natyre

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv*

I.1	Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë;
I.3	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë;
I.8	Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta, duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët, si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera.

### Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.5	Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjetra në bazë të imagjinatës, duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna;
II.6	Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, shoqërore - historike) në njërin nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie;
II.8	Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë, sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërrimeve apo pozitive në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimit) të tyre.

### Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm

III.1	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën a problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes;
III.2	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar;
III.3	Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shenjuar me shenja të ndryshme);
III.4	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij a saj;
III.5	Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar;
III.6	Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara dhe bën një plan për mënyrën e korrigjimeve të nevojshme;
III.9	Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinë për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

### Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv

IV.3	Përgatit një projekt të vogël, duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupojnë atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.
------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

### Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.8	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti a aktiviteti në bazë klase a shkolle apo jashtë saj);
V.9	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve të tjerë kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtja e rregullt e sendeve që e rrethojnë etj.).

### Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

VI.2	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një veprimtarie të përbashkët;
VI.5	Propozon dhe ndan mendimin me shokët a shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve të aktiviteteve të ndryshme me karakter mësimor, të këshillave në klasë apo në shkollë, përbërjen dhe rolin e tyre.

### RNF - Rezultatet e të nxënimit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit

1.6	Përshkruan pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, lëvizjet e Tokës, të Diellit, Hënës dhe të trupave të tjerë të këtij sistemi, elementet e hartës, përmbajtjen e hartës, legjendën e hartës, shenjat hartografike, skicën, planin, globin, veçoritë e elementeve natyrore të mjedisit natyror (relievin, klimën, ujërat, botën bimore dhe shtazore), bashkëveprimin njeri-natyrë, rreziqet natyrore, resurset natyrore e objektet e trashëgimisë natyrore në veçanti ato të Republikës së Kosovës.
2.1	Formulon pyetje për objektet, gjallesat dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij dhe ndërlihdhen mes tyre;
2.2	Ofron sugjerime (hipoteza) të bazuara në vëzhgim për rezultatet e mundshme të hulumtimit;
2.3	Kryen vëzhgime sistematike dhe mban shënime gjatë matjeve me njësi standarde përmes pajisjeve (veglave) të ofruara nga mësuesi/ja;
2.4	Përdor rezultatet e hulumtimit për të arritur përfundime (konkluzione);
2.5	Prezanton të dhënat (të gjeturat) dhe konkluzionet, duke përdorur shpjegimet me gojë dhe me shkrim, diagramet dhe grafikët apo TIK-un;
2.6	Identifikon ngjashmëritë dhe dallimet që ndërlihdhen me idetë dhe proceset shkencore.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e vlerësimit	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<b>Vendi dhe hapësira</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shpjegon pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, lëvizjet e Tokës, Diellit, Hënës dhe të trupave të tjerë të këtij sistemi dhe përshkruan mënyrat kryesore të orientimit në natyrë (përmes Diellit, busullës, Yllit Polar, Hënës, orës së dorës, hijes së mesditës, objekteve, drurëve etj.).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>57. Orientimi në natyrë</li> <li>58. Orientimi në natyrë - Fletore pune</li> <li>59. Paraqitja e Tokës në hartë, glob dhe në plan</li> </ul>	18	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vlerësim somativ</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Gjuhë shqipe</li> <li>Shoqëria dhe mjedisi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>“Njeriu dhe natyra 4”</li> <li>“Njeriu dhe natyra 4 - fletore pune”</li> <li>www.dukagjimbotime.com</li> </ul>	
<b>Sistemet fizike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Yllit Polar, Hënës, orës së dorës, hijes së mesditës, objekteve, drurëve etj.).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>60. Paraqitja e Tokës në hartë, glob dhe në plan - Fletore pune</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>Vlerësim formativ</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Edukatë figurative</li> <li>Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti</li> </ul>		
<b>Bashkëpunimi ndërjetësor</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e botës bimore dhe shtazore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>61. Ndikimet e Diellit në dukuritë natyrore të planetit Tokë</li> <li>62. Ndikimet e Diellit në dukuritë natyrore të planetit Tokë - Fletore pune</li> <li>63. Rëndësia e Diellit në zhvillimin e botës bimore dhe shtazore</li> <li>64. Rëndësia e rrezeve të Diellit në zhvillimin e botës bimore dhe shtazore - Fletore pune</li> <li>65. Ndërtimi i atmosferës dhe rëndësia e saj për jetë</li> <li>66. Ndërtimi i brendshëm i Tokës</li> <li>67. Ndërtimi i brendshëm i Tokës - Fletore pune</li> <li>68. Sa ka ujë në planetin Tokë?</li> <li>69. Sa ka ujë në planetin Tokë? - Fletore pune</li> <li>70. Faktorët që ndikojnë në përhapjen e botës bimore dhe shtazore</li> <li>71. Faktorët që ndikojnë në përhapjen e botës bimore dhe shtazore - Fletore pune</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>Vlerësim përmbledhës (Vendos instrumentet)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Edukimi për paqe</li> <li>Edukimi për paqe</li> <li>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</li> <li>Edukimi për paqe</li> <li>Globalizmi dhe ndërmarrësia</li> </ul>		

	<p>- Dallon disa nga llojet e ndotjes së mjedisit dhe identifikon disa nga faktorët që ndikojnë në ndotjen e tokës apo keqmenaxhimin e saj: p.sh., shfrytëzimi i tokave -ndërtimet në tokat bujqësore, përdorimi i pesticideve, shpyllëzimet, erozioni etj.).</p>	<p>72. Ndotja e mjedisit 73. Ndotja e mjedisit - Fletore pune 74. Ruajtja e trashëgimisë natyrore</p>				
--	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	--	--	--





# Mësimi 1

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Prejardhja, përbërja dhe vetitë e materialeve

### Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon materialet në bazë të prejardhjes natyrë e gjallë dhe ajo jo e gjallë (materialet metalike, minerale, organike dhe kompozite).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** I.3; II.1; III.4; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.5.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Materialet metalike dhe materiet minerale

### Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përkufizon kuptimin e fjalëve të dhëna;
- Përshkruan metalet dhe mineralet përmes faqeve të kubimit;
- Shkruan të veçantat dhe të përbashkëtat e tyre.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fletë A4.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënësit**

*Parashikimi me terma paraprakë*

Paraqiten para nxënësve termat: *ari, bakri, argjendi, hekuri, bronzi, shkëmbi, guri dhe gjipsi.*

Kërkohet nga nxënësit të mendojnë 2 minuta se çfarë kuptojnë me fjalët e dhëna dhe çfarë u kujtojnë ato.

Diskutohen mendimet e nxënësve.


## 1 PREJARDHJA, PËRBËRJA DHE VETITË E MATERIALEVE Materialet metalike dhe materiet minerale

Materie (materiali, lënda) është gjithçka që ka masë dhe zë hapësirë. Shumica e gjërave në mjedisin rrethues janë të ndërtuara nga materialet. P.sh., ajri që merret gjatë frymëmarrjes, ose dheu në të cilin rriten bimët, janë të ndërtuar nga materia. Materialet (lëndët) kanë prejardhje nga natyra jo e gjallë dhe ajo e gjallë. Lëndë nga natyra e gjallë janë ato lëndë që kanë prejardhje nga organizmat e gjallë (bimët, shtazët, kërpudhat dhe bakteret), ndërsa lëndë nga natyra jo e gjallë janë ato të cilat kanë prejardhje nga pjesa jo e gjallë e natyrës (p.sh., toka, ajri, uji etj.).

### Materialet metalike

Materialet metalike kanë prejardhje nga natyra jo e gjallë dhe janë krijuar përmes proceseve natyrore. Metalet zakonisht janë të ngurta, por ka edhe metale të lëngshme, p.sh. mercuri. Ato janë përcuese të mira të elektricitetit dhe të nxehsisë, shkëlqojnë kur janë të pastra, janë të forta dhe të qëndrueshme. Metalet mund të lakohen dhe prej tyre mund të krijohen forma të ndryshme. Metale janë: alumini, bakri, hekuri, plumbi, kallaji, ari, argjendi, titani, uranumi, zinku etj. Një karakteristikë tjetër e metaleve është që mund të përzihen mes vete, ose me substanca të tjera, dhe të japin **legura**, siç janë p.sh. **bronzi** (përzierje e bakrit dhe kallajit), **çeliku** (përzierje e hekurit dhe një sasive të vogël të karbonit) etj. Zakonisht legurat janë më të forta se metali i pastër.

### Metalet dhe përdorimi i tyre:



### Materiet minerale

Mineralet gjithashtu kanë prejardhje nga pjesa jo e gjallë e natyrës dhe janë krijuar përmes proceseve natyrore që kanë ndodhur në Tokë. Janë lëndë të ngurta, zakonisht me strukturë kristalore (kristale). Toka është e përbërë nga minerale të ndryshme. Minerali ndryshon nga shkëmbi.

8



## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes Kubimi

### Mineralet të ndryshme:



Mineralet kanë përbërje të caktuar kimike, e cila ka shpërndarje të njëtrajtshme në tërë mineralin. Disa prej llojeve më të njohura të mineraleve janë: kuarci, gjipsi, piriti, kupriti etj. Disa metale, si: ari, platini, bakri etj., në natyrë gjenden edhe si të pastra (të papërziera me elemente të tjera), prandaj konsiderohen edhe si minerale.



Shkëmbinjtë nuk kanë ndërtim të njëjtë.

Shkëmbi është përzierje e disa llojeve të mineraleve. Në ndërtimin e shkëmbit, mineralet nuk marrin pjesë në mënyrë të barabartë dhe nuk kanë shpërndarje të njëtrajtshme. Në Tokë ka lloje të ndryshme të shkëmbinjve. Ata dallohen në mes vete sipas llojit të mineralit që ndërtojnë, si dhe në bazë të përbërjes kimike. Llojet më të shpeshta të shkëmbinjve janë: **mermeri, graniti, guri gëlqeror** etj.

Mineralet gjenden në shkëmbinj, në dhe, në rërë etj. Ato gjenden në sipërfaqe të tokës dhe në thellësi të saj. Mineralet kanë formë, madhësi dhe ngjyra të ndryshme.

Provojeni me shokët dhe shoqet e klasës t'i identifikoni tri nga metallet që lidhen me sportin!

1. Çfarë prejardhje kanë materialet (lëndët)?
2. Sqaro prejardhjen e metaleve dhe trego gjendjet agregate të tyre. Sqaro përmes shembujve.
3. Jep shembuj të metaleve dhe sqaro veçoritë e bronzit dhe të çelikut.
4. Çfarë janë mineralet dhe nga çfarë përbëhen ato?
5. Sqaro ndryshimin midis një minerali dhe një shkëmbi.

9

Nxënësit ndahen në 4-5 grupe, varësisht nga numri i nxënësve në klasë. Në grup lexohet në mënyrë individuale njësia mësimore, më pas punohet në grup. Secili grup zgjedh një metal apo një mineral, si temë për të punuar rreth tij. Puna bazohet në faqet e kubimit, si më poshtë. Sqarim: grupet orientohen të zgjedhin arin, bakrin, shkëmbin, gurin gëlqeror, mermerin, merkurin.

1. PËRSHKRUAJE - dukjen, formën, ngjyrën, madhësinë e objektit që e kemi temë.
2. KRAHASOJE - me diçka tjetër, që është e ngjashme ose e ndryshme.
3. SHOQËROJE - trego çfarë të kujton, duke e lidhur ndonjë ngjarje nga jeta me të.
4. ANALIZOJE - si është ndërtuar, prej cilave pjesë apo fazave përbëhet ajo.
5. ZBATOJE - përse na duhet, ku e përdorim?
6. ARSYETOJE - është e mirë apo e keqe, përse?


Puna bëhet në fletë A4. Puna e përfunduar diskutohet dhe krahasohet me grupet e klasës.



## Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit Diagrami i Venit

Udhëzohen nxënësit që në grupe ta plotësojnë Diagramin e Venit, duke shënuar të veçantat dhe të përbashkëtat e metaleve dhe mineraleve.

Metalet



Mineralet

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përkufizimit të fjalëve të dhëna, përshkrimin e metaleve dhe mineraleve, si dhe krahasimin dhe shkrimin e të veçantave dhe të përbashkëtave të tyre.

## Detyrë:

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

## Mësimi 2

### ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Prejardhja, përbërja dhe vetitë e materialeve

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Dallon materialet në bazë të prejardhjes natyrë e gjallë dhe ajo jo e gjallë (materialet metalike, minerale, organike dhe kompozite).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1; III.4; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.5.

### ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Materialet metalike dhe materiet minerale - Fletore pune

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përshkruan vetitë e metaleve dhe mineraleve;
- Argumenton qëndrimin rreth pyetjes së shtruar.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

### METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënësit**

*Stuhi mendimesh*

Nxiten nxënësit të japin mendime lidhur me pyetjen e shtruar më poshtë:

- Cilat janë tri metalet që lidhen me sport?

Diskutohen mendimet e nxënësve dhe vihet në përfundim që:

1. Medalja e arit - ndahet për sportistët e vendit të parë në ndeshje të rëndësishme.
2. Medalja e argjendtë - ndahet për sportistët e vendit të dytë në ndeshje të rëndësishme.
3. Medalja e bronzë - ndahet për sportistët e vendit të tretë në ndeshje të rëndësishme.

## PREJARDHJA, PËRBËRJA DHE VETITË E MATERIALEVE

MATERIALET METALIKE DHE MATERIT MINERALE

1

### 1. Materialet metalike

a) Në vendet boshe nën figura, shkruaj emrat e metaleve nga të cilat janë prodhuar këto produkte.



7

b) Duke u bazuar në figurat nën a/, shkruaj lëndët metalike të ngurta dhe ato të lëngëta.

Të ngurta	Të lëngëta

c) Nën çdo medalje, shkruaj për cilin vend të arritur në garat sportive jepet secila sosh.



8



**Ndërtimi i njohurive:**  
**Përpunimi i përmbajtjes**  
*Turi i galerisë*

Udhëzohen nxënësit të punojnë në grupe. Formohen 4-5 grupe, varësisht nga numri i nxënësve në klasë.

Plotësohet në fletoren e punës, faqe 7 dhe 8.

Pas përfundimit, grupet lëvizin në grupet e tjera, shikohet puna, diskutohet, krahasohet dhe mund të shënohet ndonjë koment te secili grup.

Në fund, shikohen komentet dhe mund të përmirësohet ushtrimi nëse ka nevojë.



**Përforcimi:**  
**Konsolidimi i të nxënit**  
*Rrjeti i diskutimit*

Shënohet pyetja për diskutim: *A duhet një vend të zhvillojë industrinë e minierave dhe metaleve?.*

Nxënësit lëvizin në klasë për të formuar grupet për po, jo dhe ata që janë të pavendosur. Grupet shënojnë argumentet e tyre, më pas i paraqesin

para të tjerëve, duke i bindur për qëndrimet e tyre. Nëse ka nxënës që ndryshon bindjet e veta, kalon në grupin tjetër. Në fund, secili përfaqësues i grupit përmbledh qëndrimet që ka grupi.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari, saktësinë e përshkrimit të metaleve dhe minierave, si dhe argumentimin e qëndrimit të tyre rreth pyetjes së shtruar.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Prejardhja, përbërja dhe vetitë e materialeve

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Dallon materialet në bazë të prejardhjes natyrë e gjallë dhe ajo jo e gjallë (materialet metalike, minerale, organike dhe kompozite).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** I.3; II.1; III.4; V.8; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Materialet organike dhe ato kompozite

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Dallon materialet organike dhe ato kompozite;
- Krahason njohuritë me shokun a shoqen;
- Zbulon pohimet e sakta lidhur me njësinë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënësit**  
 Karrigia e autorit

Puna bëhet në dyshe. Në tabelë shënohen fjalët *dheu* dhe *betoni*.

Kërkohet nga dyshet të diskutohet për përbërjen e tyre. Më pas, nga një përfaqësues ulet në karrige para nxënësve dhe tregon përfundimet e nxjerra në dyshe lidhur me temën.

2 Materialet organike dhe ato kompozite

Materialet organike

Materiale organike (lënda organike) është lëndë me prejardhje nga organizmat e gjallë (bimët, shtazët, kërpudhat dhe bakteret). Ai përbëhet nga përbërës organikë. Është material që shpërbëhet/kalbet (kthehet në material joorganik) me ndihmën e kërpudhave dhe të baktereve.

Për shembull, gjethet dhe frutat janë materiale organike, sepse vijnë nga bimët që janë organizma të gjallë.

Edhe mishi është lëndë organike, sepse vjen nga organizmat e gjallë.

**Dheu (toka)** përbëhet nga lëndët organike dhe organizmat e gjallë, por ka edhe minerale të tretura në të. Në një pyll, gjethet dhe degëzat e drurëve bien në sipërfaqen e pyllit. Kur ato mbetje kalben, formojnë lëndën organike (**humusin**). Lënda organike në tokë vjen nga bimët dhe kafshët.



Gjethet dhe degët e rëna në sipërfaqe të pyllit



Humusi



Lënda organike në tokë

Dheu përbën shtresën e sipërme të shkërfët të sipërfaqes së tokës ku rriten bimët dhe jetojnë baktere, kërpudha dhe organizma të ndryshëm shtazorë.



Bima, përmes rrënjëve, përfarcohet në tokë dhe siguron ujin e lëndët minerale të nevojshme.



Krimbi i tokës

Për tokën është veçanërisht i dobishëm krimbi i tokës. Ai ushqehet me gjethe, krijon kanale ajrosjeje dhe kështu e bën më të pëlshme tokën.

### Materialet kompozite

Materialet kompozite janë materiale që krijohen nga përzierja e dy e më shumë materialeve përbërëse. Njeriu, për nevoja të tij, qysh herët ka kombinuar materiale të ndryshme. Ai ka përzier kashën dhe baltën për të formuar **tulla**, të cilat i ka përdorur për ndërtimin e objekteve të banimit etj.




Tullat nga kasha dhe balta



Urë betoni

**Xhami i papërshkueshëm nga plumbat** është i përbërë nga materiali artificial (qelqi dhe plastika). Ky xham i kombinuar është shumë më rezistent ndaj ndikimit të shtypjes sesa vetëm xhami ose plastika, prandaj është shumë vëzhirë të shpohet. Përdoret në dritaret e ndërtesave dhe të automjeteve që kërkojnë siguri të lartë.



Xhami i papërshkueshëm nga plumbat

11



## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes INSERT

Lexohet teksti nga nxënësit. Gjatë leximit, përdorin shenjat në fund të çdo fjalie, duke analizuar pjesën e lexuar.

- √ - informacioni është i njohur për ju.
- - informacioni është ndryshe nga ajo që dini.
- + - informacioni është i ri.
- ? - informacioni është i paqartë.

Pas leximit, në dyshe diskutohet çfarë lexuan, informacionet e reja, krahasohen shenjat.



## Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit Dy gënjeshtra, një e vërtetë

Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup shënon 3 fjali, dy të pavërteta dhe një të vërtetë lidhur me njësinë mësimore. Lexohen nga përfaqësuesit e grupeve, ndërsa grupet e tjera përgjigjen për të gjetur fjalinë e saktë.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e dallimit të materialeve organike dhe atyre kompozite, krahasimin e njohurive me shokun a shoqen përmes shenjave, si dhe zbulimin e pohimeve të sakta.

### Detyrë:

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.*



ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Prejardhja, përbërja dhe vetitë e materialeve

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Krahason materialet e ndryshme sipas dendësisë, përcjellshmërisë termike e elektrike, sipas fortësisë dhe i ndërlihd ato me përdorimin e tyre.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1; III.4; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vetitë dhe përdorimi i materialeve

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Tregon prejardhjen e materialeve dhe llojet e tyre;
  - Krahason materialet sipas dendësisë, fortësisë, përcjellshmërisë;
  - Përmbledh informacionet, duke iu përgjigjur pyetjeve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fletë A4.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimitim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**  
 Diskutim rreth njohurive paraprake

Nxiten nxënësit të diskutojnë përmes pyetjeve të shtruara.

- Çfarë prejardhjeje kanë materialet (lëndët)?
- Çfarë janë mineralet dhe nga çfarë janë të përbëra ato?
- Lënda organike prejardhjen e ka nga...?
- Për çfarë përdoret druri?

Përgjigje të mundshme: *Materialet kanë prejardhje nga natyra jo e gjallë dhe e gjallë; mineralet janë krijuar përmes proceseve natyrore që kanë ndodhur në Tokë; lënda organike prejardhjen e ka nga organizmat e gjallë; druri përdoret për djegie, si material ndërtimor, në mobilieri etj.*


3 Vetitë dhe përdorimi i materialeve

Secili material ka vetitë e tij karakteristike, përmes të cilave dallohet nga materialet e tjera. Vetitë e tilla të materialeve janë: dendësia, fortësia, përcjellshmëria e elektricitetit, ngjyra, forma, madhësia etj.

Dendësia e materies

Dendësia tregon sasinë e materies në një hapësirë të caktuar, d.m.th. tregon se sa i ngjeshur është materiali në një hapësirë të dhënë. Sa më shumë të vendosim material në një hapësirë të vetme, aq më e madhe është dendësia dhe anasjellas. P.sh., nëse e merrni një thes dhe e mbushni me pambuk, ai do të ketë një dendësi të caktuar, por në të njëjtin thes (hapësirë) mund të vendosni edhe më shumë pambuk nëse në të ushtroni presion. Në këtë rast, pambuku do të ketë një dendësi më të madhe se më parë, edhe pse thesi është i njëjtë. Sa më e madhe të jetë dendësia e një trupi, aq më e madhe është pesha e tij dhe anasjellas.

Trupat e ndryshëm kanë dendësi të ndryshme, p.sh. nëse një balonë e mbushim me ajër dhe e hedhim në ujë, ajo nuk do të fundoset (sepse ajri ka dendësi më të ulët se uji). Ndërsa, nëse të njëjtin balonë e mbushim me rërë dhe e lëshojmë në ujë, ajo do të fundoset sepse rëra ka dendësi më të lartë se uji, prandaj edhe nuk mund të notojë.



Balona e mbushur me ajër

Balona e mbushur me rërë

Fortësia e materialeve

Me *fortësi* nënkuptojmë se sa i rezistojnë materialet shtypjes. Disa materiale i rezistojnë më shumë shtypjes, të tjerat më pak. Disa prej materialeve më të forta janë: **diamanti, kuarci, çeliku, graniti, betoni** etj. Sa më të forta të jenë materialet, më vështirë përpuhen, priten dhe formësohen, por janë më të qëndrueshme. Materialet



e forta janë të rëndësishme në industri. Ato përdoren për vegla prerëse, makineri dhe materiale ndërtimi. Për dallim nga materialet e forta, materialet e buta janë më elastike, lakohen më lehtë, ndërsa thyhen më vështirë.



Vegla prerëse nga diamanti



Materiale ndërtimi nga graniti



Rëra e kuarcit përdoret në prodhimin e qeramiks, qelqit etj.



Urë çeliku

14




## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

*Mbajtja e strukturuar e shënimeve*

Udhëzohen nxënësit të lexohet njësia mësimore. Pas leximit, në fletë A4 shënohen informacionet e marra në skicën e grafikut të dhënë.

Sqarim: nxënësit mund të përdorin grafikë të ndryshëm, sipas dëshirës për paraqitjen e informacioneve të marra.



Me anë të grafikut, krahasohet dendësia, fortësia dhe përcjellshmëria e materialeve të ndryshme.



## Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

*Marrëdhëniet pyetje-përgjigje*

Kërkohet nga nxënësit t'u përgjigjen në fletore pyetjeve të dhëna.

1. Trego kur një objekt ka densitet të ulët e kur të lartë?

2. Pse përdoren më shumë në industri materialet e forta?
3. Shëno dy përçues dhe jopërçues të nxehtësisë.

Puna kontrollohet dhe vlerësohet.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në tregimin e prejardhjes së materialeve, krahason materialet sipas dendësisë, fortësisë dhe përcjellshmërisë së materialeve, si dhe përmbledhjen e informacioneve, duke iu përgjigjur pyetjeve të shtruara.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 5

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Prejardhja, përbërja dhe vetitë e materialeve

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
Krahason materialet e ndryshme sipas dendësisë, përcjellshmërisë termike e elektrike, sipas fortësisë dhe i ndërlihd ato me përdorimin e tyre.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1; III.4; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.5.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vetitë dhe përdorimi i materialeve - Fletore pune

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Interpreton kuptimin e fjalëve të dhëna;
  - Analizon materialet për nga dendësia, fortësia dhe përçueshmëria;
  - Shpjegon vetitë e materialeve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**  
Gjuhë amtare, Edukatë fizike, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënësit**  
*Dil rrotull, fol rrotull*

Në tabelë shënohen fjalët: *material (lëndë), prejardhje, veti, përdorim.*  
Nxënësit fillojnë e lëvizin nëpër klasë, duke menduar për pak minuta lidhur me emërtimet. Kur duart përplasen, nxënësit ndalen dhe ia shpjegojnë njëri-tjetrit njohuritë lidhur me emërtimet e dhëna. Kur përfundon diskutimi, fillojnë prapë të lëvizin dhe kështu vazhdohet me radhë për disa herë.

## VETITË DHE PËRDORIMI I MATERIALEVE

# 3

### 1. Materialet e ndryshme sipas dendësisë

a) Objektet me densitet të lartë janë kompakte dhe më të rënda, kurse objektet me densitet të ulët janë më të lehta dhe zënë më shumë hapësirë. Duke u bazuar në figurën poshtë, trego cili nga objektet në peshore do të peshojë më shumë. Sqaro pse.

Diskutoni në klasë.



2. Bëjeni një listë të objekteve me densitet të lartë dhe të atyre me densitet të ulët.

Objektet me densitet të lartë	Objektet me densitet të ulët

3. Shkruaj në tabelë emrat e disa përçuesve dhe jopërçuesve të nxehtësisë dhe të rrymës elektrike.

Përçuesit	Jopërçuesit

4. Materialet e forta i rezistojnë shtypjes, prandaj janë të rëndësishme për industrinë. Në tabelën poshtë, shkruaj për secilin material se për çfarë mund të përdoret.

Materialet	Përdorimi
	
	
	
	

12



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes Ditarët e të nxënët

Udhëzohen nxënësit t'i hapin fletoret e punës. Punohet në mënyrë individuale, duke plotësuar ushtrimet e dhëna.

1. Listo objektet sipas kërkesës.

Objektet me densitet të lartë	
Objektet me densitet të ulët	

2. Shëno emrat e materialeve sipas kriterit.

Materiale përçuese	
Materiale jopërçuese	

3.

Materialet	Përdorimi
diamanti	
graniti	
kruci	
hekuri	



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët

*Mendo/puno në dyshe/shkëmbe mendime*

Diskutohet në dyshe puna e përfunduar. Shkëmbehen mendime dhe jepen sugjerime nga njëri që ka rolin e ekspertit për përmbledhjen e përmbajtjes, duke përforcuar kështu informacionet rreth vetive të materialeve dhe përdorimit të tyre te nxënësi tjetër që ka paqartësi. Pastaj ndërrohen rolet në dyshe.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në interpretimin e kuptimit të fjalëve, analizimin e materialeve sipas vetive të tyre, si dhe shpjegimin e vetive të materialeve.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Prejardhja, përbërja dhe vetitë e materialeve

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 - Klasifikon materialet në bazë të përbërjes në: lëndë të pastra dhe lëndë të përziera;  
 - Dallon përzierjet dhe tretësirat.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1; I.3; II.8; III.4; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Lëndët e pastra, ato të përziera dhe tretësirat

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Identifikon lëndët e pastra dhe të përziera;
- Shpjegon përbërjen e tyre;
- Krahason lëndët heterogjene dhe homogjene.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimitim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**  
*Të nxënë me këmbime (grupet e ekspertëve)*

Në klasë formohen katër grupe: A, B, C dhe D. Ndahen nxënësit e klasës, duke numëruar nga 1 deri në 4. Nxënësit me numrin 1 kalojnë te grupi A, nxënësit me numër 2 kalojnë te grupi B, nxënësit me numër 3 kalojnë te grupi C dhe nxënësit me numër 4 kalojnë te grupi D. Grupeve u jepet nga një fletë me kërkesën e punës së tyre.



Në përzierjet homogjene, përbërësit (lëndët) shpërndahen në mënyrë të barabartë dhe të njëtrajtshme në të gjithë përzierjen, p.sh. tek: uji me sheqer, uji me kripë, ajri etj. Përzierjet homogjene quhen ndryshe **tretësira**. Në një përzierje homogjene (tretësirë), njëra lëndë është tretësi e tjetra është lëndë që tretet.



Përzierja homogjene e ujit dhe e sheqerit paraqet një tretësirë ku tretësi është uji, ndërsa lëndë e tretur është sheqeri.

**Dallimet kryesore midis një përzierjeje heterogjene dhe homogjene - tretësire**

Përzierja heterogjene	Përzierja homogjene
Lëndët janë thjesht të përziera, nuk treten dhe mund të ndahen lehtësisht.	Lëndët shpërndahen plotësisht dhe në mënyrë të njëtrajtshme; ndahen me vështirësi.
Përbëhet nga dy e më shumë përbërës, të cilët janë të dukshëm në përzierje.	Përbëhet nga dy e më shumë lëndë që janë të tretshme dhe të padukshme në përzierje.
Secila nga lëndët i ruan vetitë e veta origjinale.	Vetitë e lëndëve zakonisht ndryshojnë.
Përqindja e lëndëve dhe shpërndarja e tyre në tretësirë është e ndryshueshme.	Në një tretësirë, sasia e lëndëve zakonisht është e pandryshueshme dhe e shpërndarë në formë të njëtrajtshme.

1. Trego si është e përbërë një lëndë e pastër e si një e përzier.
2. Sqaro kur është një përzierje heterogjene e kur homogjene. Trego shembuj të këtyre përzierjeve.
3. Si quhet ndryshe përzierja homogjene? Sqaro çka paraqesin lëndët që e përbëjnë atë.
4. Cilat janë dallimet kryesore midis një përzierjeje heterogjene dhe asaj homogjene?



17



## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

*Të nxënësit me këmbime  
(grupet e ekspertëve)*

**Grupi A** tregon (vizaton) lëndët e pastra dhe përbërjen e tyre.

**Grupi B** tregon (vizaton) lëndët e përziera dhe përbërjen e tyre.

**Grupi C.** Kur një përzierje është heterogjene dhe kur homogjene? Trego nga dy shembuj.

**Grupi D.** Cilat janë dallimet kryesore midis një përzierjeje heterogjene dhe asaj homogjene?

Lexohet teksti në mënyrë individuale. Në grupe, shqyrtohet pjesa e lexuar dhe u përgjigjen kërkesave të shtruara.



## Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

*Të nxënësit me këmbime  
(grupet e ekspertëve)*

Pas përfundimit, nxënësit kthehen në grupet fillestare për ta shpjeguar pjesën e përcaktuar.

Anëtarët e grupit plotësojnë njëri-tjetrin me informacionet e marra.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari, për saktësinë në identifikimin e lëndëve të pastra dhe të përziera, shpjegimin e përbërjes së tyre, si dhe krahasimin e lëndëve heterogjene dhe atyre homogjene.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Prejardhja, përbërja dhe vetitë e materialeve

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Dallon përzjerjet dhe tretësirat.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1; I.3; II.8; III.4; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ndarja e përzjerjeve

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Dallon përzjerjet dhe tretësirat;
- Krijon pyetje dhe formulon përgjigje për pjesën e lexuar;
- Përshkruan ndarjen e përzjerjeve me metodën e filtrimit, dekantimit, distilimit dhe me magnet.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**  
 Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimitim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**  
*Diskutim për njohuritë paraprake*


Nxiten nxënësit të marrin pjesë në diskutim përmes pyetjeve të shtruara:

- Ku dallojnë lëndët e pastra nga lëndët e përziera?
- Çfarë mendoni ju, si mund t'i ndajmë përzjerjet?
- Pse mendoni kështu?
- A mundemi me mjete shtëpiake ta bëjmë ndarjen e lëndëve?
- Nëse po, në çfarë mënyre?

5 Ndarja e përzjerjeve

Ne mund të përdorim vetitë fizike të materialeve që janë në përbërjen e përzjerjes, që t'i ndajmë ato nga njëra-tjetra. Ekzistojnë metoda të ndryshme që mund të përdoren për ndarje:

**Filtrimi** është metodë që përdoret për ndarjen e përbërësve të një përzjerjeje, nëse njëra lëndë është e ngurtë dhe e patretshme (p.sh. rëra), ndërsa tjetra lëndë është e lëngët (p.sh. uji). Për të filtruar, duhet të kemi filtër, i cili mund të jetë ndonjë copë letre, tekstili apo ndonjë material tjetër, vrimat e të cilit duhet të jenë më të vogla se kokrrat e rërës. Në pjesën e sipërme të filtrit vendosim përzjerjen; meqë kokrrat e rërës janë më të mëdha se vrimat e filtrit, ato do të mbeten në filtër, ndërsa uji do të bjerë në enën poshtë, sepse ai lehtë kalon nëpër vrimat e filtrit. Në këtë mënyrë kemi ndarë rërën nga uji.



Metoda e filtrimit të përzjerjes ujë-rërë.

**Dekantimi (fundërrimi)** - nëse nuk kemi filtër, rërën nga uji mund ta ndani me metodën e dekantimit. Përzjerjen e vendosni në një enë dhe e lini në qetësi (nuk e tundni) për një kohë. Meqë rëra ka peshë më të madhe sesa uji, ajo fundërron (bie në fund të enës), d.m.th., rëra bie poshtë, ndërsa uji mbetet në pjesën e sipërme. Pastaj uji derdhet në një enë tjetër, ndërsa në enën ku është bërë dekantimi mbetet rëra. Ky lloj i ndarjes quhet dekantim (fundërrim). Dekantimi mund të përdoret edhe për ndarjen e lëngjeve që nuk përzihen mes vete, p.sh. nëse përzijmë ujin dhe vajin në një gotë, aty formohet një shtresë e vajit dhe një e ujit. Meqë vaji ka dendësi më të vogël se uji, ai noton në pjesën e sipërme të ujit. Ndarja e këtyre shtresave është qartë e dukshme, sepse ju shumë lehtë mund ta derdhni vajin në një gotë tjetër, ndërsa në gotën e parë do t'ju mbetet vetëm uji.



Metoda e dekantimit në një përzjerje nga uji dhe rëra






**Ndërtimi i njohurive:**  
**Përpunimi i përmbajtjes**  
*Pyetja sjell pyetjen*

Njësia mësimore ndahet në katër paragrafë. Kërkoet nga nxënësit të punohet në dyshe. Nxënësi i parë do të lexojë me zë paragrafin e parë. Nxënësi i dytë do të bëjë pyetje për këtë paragraf. Nxënësi i parë i përgjigjet pyetjes së shtruar. Më pas ndërrohen rolet, nxënësi dy lexon, nxënësi një shtron pyetjen dhe përgjigjet nxënësi dy. Kujdes kur formuloni pyetjet. Mundohuni që pyetjet të fillojnë me *pse*.



**Përforcimi:**  
**Konsolidimi i të nxënit**  
*Mbajtja e strukturuar e shënimeve*


Pas analizimit të paragrafëve, bashkë me nxënësit plotësohet grafiku me informacionet e marra gjatë punës në dyshe.



**Eksperiment:** metodën e dekantimit në një përzierje nga uji dhe vaji mund ta demonstroi në klasë, së bashku me mësuesen/in. Në fillim bëni përzierjen e vajit me ujin si në figurën lart. Pasi të paraqitet shtresimi, bëni ndarjen, duke derdhur shtresën e sipërme të përzierjes (vajin) në një enë tjetër, ndërsa uji le të mbetet.



Metoda e ndarjes së një përzierjeje nga vaji dhe uji



**Ndarja me magnet** përdoret për ndarjen e pjesëve metalike (që kanë veti magnetike) nga pjesët jometalike. P.sh., nëse përzieni copëza të hekurit me rërë, ju mund ta përdorni magnetin për t'i larguar ato nga përzierja dhe në enë do të mbetet vetëm rëra.

Ndarja e hekurit nga rëra me anën e magnetit

**Distilimi** është metodë e ndarjes së dy apo më shumë përbërësve të një përzierjeje, bazuar në dallimet që kanë ata përbërës në temperaturën e vlimit. P.sh., nëse keni një tretësirë në të cilën keni përzierje ujin dhe kripën, për t'i ndarë këta dy përbërës duhet të nxehet tretësira, uji do të avullohet, ndërsa në enë do të mbetet kripa, siç tregohet në figurë. Ndarja e tillë e përzierjeve quhet distilim.



Distilimi

1. Cilat janë mënyrat e ndarjes së përzierjeve dhe cila t'u duk më e praktike?
2. Trego dallimin në mes të filtrimit dhe dekantimit.
3. Kur mund të përdoret magneti për ndarjen e një përzierjeje?
4. Përkrahuj metodën e distilimit.



19

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari, dallimin e përzierjeve dhe tretësirave, krijimin e pyetjeve dhe formulimin e përgjigjeve për pjesën e lexuar, si dhe përshkrimin e metodave për ndarjen e lëndëve të përziera.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Prejardhja, përbërja dhe vetitë e materialeve

### Rezultatet e të nxënit të temës:

- Dallon përzierjet dhe tretësirat;
- Demonstron ndarjen e përzierjeve me metodën e filtrimit dhe dekantimit.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1; I.3; II.8; III.4; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njëësia mësimore:** Ndarja e përzierjeve - Fletore pune

### Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon mënyrat e ndarjes së përzierjeve;
- Demonstron ndarjen e përzierjeve përmes filtrimit dhe magnetit;
- Përshkruan në fletore mënyrën e filtrimit dhe ndarjes me magnet.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** enë, letër filtruese, hinkë, ujë, bimë të thara, magnet, rërë, copëza hekuri.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



### Parashikimi:

#### Përgatitja për të nxënësit

*Stuhi mendimesh*

Pyeten nxënësit:

- Cilat janë mënyrat për ndarjen e përzierjeve?
- Trego dallimin në mes të filtrimit dhe dekantimit?
- Kur mund të përdoret magneti për ndarjen e një përzierjeje?
- Po destilimin, kur e përdorim?

**Filtrimi** - është metodë që përdoret për ndarjen e përbërësve të një përzierjeje, nëse njëra lëndë është e ngurtë dhe e patretshme (p.sh.: rëra), kurse tjetra është e lëngët (p.sh.: uji). Bashkë me shokët e shoqet dhe me ndihmën e mësuesit/es, provoni të bëni filtrimin e një përzierjeje ujë-rërë.

**Eksperiment:** për filtrimin e përzierjes nevojiten: një copë letër apo një leckë tekstili, përzierja e ujit dhe e rërës.

**Ecuria e eksperimentit:** në pjesën e sipërme të filtrit, vendosim përzierjen. Meqë kokrrat e rërës janë më të mëdha se vrmat e filtrit, ato mbeten në filtër, ndërsa uji bie në enën poshtë, sepse ai kalon lehtësisht nëpër vrmat e filtrit. Në këtë mënyrë bëhet filtrimi i rërës nga uji.

Detyrë: provojë në shtëpi metodën e dekantimit në një përzierje nga uji dhe rëra. Shkruaj atë që ke vërejtur, ndërsa në klasë diskuto së bashku me mësuesin/in dhe shokët /shoqet e klasës.





**Filtrimi** - është metodë që përdoret për ndarjen e përbërësve të një përzierjeje, nëse njëra lëndë është e ngurtë dhe e patretshme (p.sh.: rëra), kurse tjetra është e lëngët (p.sh.: uji). Bashkë me shokët e shoqet dhe me ndihmën e mësuesit/ës, provoni të bëni filtrimin e një përzierjeje ujë-rëre.

**Eksperiment:** për filtrimin e përzierjes nevojiten: një copë letër apo një leckë tekstili, përzierja e ujit dhe e rërës.

**Ecuria e eksperimentit:** në pjesën e sipërme të filtrit, vendosim përzierjen. Meqë kokrrat e rërës janë më të mëdha se vrimat e filtrit, ato mbeten në filtër, ndërsa uji bie në enën poshtë, sepse ai kalon lehtësisht nëpër vrimat e filtrit. Në këtë mënyrë bëhet filtrimi i rërës nga uji.

Detyrë: provoje në shtëpi metodën e dekantimit në një përzierje nga uji dhe rëra. Shkruaj atë që ke vërejtur, ndërsa në klasë diskuto së bashku me mësuesin/in dhe shokët /shoqet e klasës.



### Ndërtimi i njohurive:

#### Përpunimi i përmbajtjes

*Demonstrim përmes punës praktike*

Bashkë me nxënësit, demonstron metoda e filtrimit dhe ndarjes me magnet.

#### Ndarja me magnet:

1. Marrim një enë në të cilën vendosim rërë dhe copëza metalike;
2. Përzihen dy lëndët e ngurta;
3. Me magnet largohen copëzat e hekurit;
4. Në enë mbetet vetëm rëra.

**Filtrimi:** për përgatitjen e një çaji bimor, duhen bimë të thara, ujë dhe vëlues uji, hinka, letër filtruese.

1. Në enë hedhim ujin dhe bimët e thara.
2. Presim derisa uji të ngrohet bashkë me bimët.
3. Më pas, përmes një hinke dhe me letër filtruese, bëhet ndarja e bimëve nga pjesa e lëngët.
4. Në pjesën e sipërme të filtrit, vendoset përzierja, pjesët e bimës mbesin në filtër.
5. Pjesa e lëngët e filtruar bie në enë, të cilën e konsumojmë.



### Përforcimi:

#### Konsolidimi i të nxënit

*Shkrim i shpejtë*

Nxënësit udhëzohen të përshkruajnë në fletore punën e demonstruar më parë, metodën e filtrimit dhe ndarjes me magnet. Puna kontrollohet dhe vlerësohet.

#### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në dallimin e mënyrave të ndarjes së lëndëve të përziera, demonstrimin e ndarjes me magnet dhe filtrim, si dhe në përshkrimin e mënyrave të ndarjes në fletore.

#### Detyrë:

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Prejardhja, përbërja dhe vetitë e materialeve

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Krahason tretjen e substancave të ndryshme në ujë dhe varësinë e tretshmërisë nga temperatura.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1; II.8; III.4; V.8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Tretja e lëndëve të ndryshme në ujë dhe varësia nga temperatura

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Identifikon faktorët që ndikojnë në tretjen e një lënde në ujë;
- Shpjegon ndikimin e temperaturës në tretjen e lëndëve;
- U përgjigjet pyetjeve të shtuara rreth tekstit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Arsimitim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënësit**

*Pyetja e ditës*

Nxiten nxënësit të marrin pjesë në diskutim përmes pyetjeve:

- Çfarë ndikon në tretjen e një lënde në ujë?
- Pse krijohen pikat e shiut në natyrë?

**Përgjigje të mundshme:** Në tretjen e një lënde në ujë mund të ndikojë sasia e lëndës, madhësia e lëndës që do të tretet, fortësia e saj, temperatura e ujit etj.

6 Tretja e lëndëve të ndryshme në ujë dhe varësia nga temperatura

Tretja e një lënde në ujë zakonisht varet nga temperatura. Rritja e temperaturës së ujit zakonisht rrit tretshmërinë e lëndëve. Për shembull, sheqeri dhe kripa janë më të tretshme në ujë të nxehtë sepe kanë temperaturë më të lartë.



Tretja e sheqerit më lehtë bëhet në ujë të nxehtë sesa në atë të ftohtë.

Gjendja agregate e lëndëve varet nga temperatura


Ju tashmë e dini që në natyrë materia gjendet në tri gjendje (forma), përkatësisht në formë të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë. Shumë lëndë mund të kenë më shumë se një gjendje, p.sh. uji (akulli) në frigorifer është i ngurtë, uji nga rubineti është i lëngshëm, ndërsa avulli i ujit është i gaztë. Nga kjo vëreni që e njëjta lëndë (uji) ndryshon gjendjen ndryshimin e temperaturës.



Gjendjet agregate të ujit

Shkrirja dhe ngrirja

Shkrirja është ndryshimi i gjendjes nga lënda e ngurtë në të lëngët. Te uji kemi ndryshimin nga akulli në ujë. Shkrirja ndodh kur temperatura e lëndës rritet. Ekziston një temperaturë e caktuar në të cilën fillon shkrirja. Kjo quhet pikë e shkrirjes. Pika e shkrirjes dhe e ngrirjes së ujit është 0°C (gradë celsius).



20

Pika e shkrirjes dhe e ngrirjes së ujit


### Avullimi dhe kondensimi

Nëse lëngu nxehet, ajo lëndë, nga gjendja e lëngët kalon në gjendje të gaztë. Ky proces quhet avullim. Temperatura në të cilën një lëng fillon të avullohet quhet pikë vlimi. Pika e vlimit të ujit është 100 °C.



Kondensimi është e kundërta e avullimit, në këtë rast lënda e gaztë, për shkak të rënies së temperaturës, kthehet në gjendje të lëngshme. Kondensimi i ujit ndodh kur avujt e ujit bien në kontakt me sipërfaqe të ftohta. Një dukuri të tillë mund ta vëreni në xhamat e dritareve, sidomos gjatë stinës së dimrit.

Vlimi i ujit



Kondensimi i ujit në xham

Bisedoni me mësuesen/in dhe shokët/shoqet e klasës pse krijohen pikat e shiut në natyrë dhe lagështia nga ana e brendshme e xhamave në dritare.

1. Çka ndikon zakonisht në tretjen e një lënde në ujë?
2. Kur ndodh shkrirja e një lënde e kur ngrirja?
3. Çfarë quajmë avullim e çfarë kondensim? Sqaro kur ndodhin këto.



21



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes INSERT

Hapet libri. Udhëzohen nxënësit ta lexojnë njësinë mësimore, në tre paragrafë. Gjatë leximit, do t'i vendosin shenjat në çdo paragraf, si më poshtë:

√	+	-	?
Këtë informacion e dija.	Ky informacioni është i ri.	Këtë informacion e dija ndryshe.	Këtë informacion nuk e kuptoj.

Shënimet mbahen në fletore. Më pas, diskutohen dhe shënohen në tabelë. Sqarohen paqartësitë, nëse ka.

Fokusi vihet tek informacionet e reja dhe shpjegimi i tyre.



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit Rishkim në dyshe

Kërkohet nga nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve të dhëna, në fletore. Pas përfundimit, fletoret shkëmbehen me shokun apo shoqen e bankës

për të parë se si i janë përgjigjur pyetjeve dhe për t'i përmirësuar ato nëse ka gabime.

1. Çfarë ndikon në tretjen e një lënde në ujë?
2. Kur ndodh shkrirja e një lënde e kur ngrirja?
3. Çfarë quajmë avullim e çfarë kondensim?
4. Kur ndodhin ato?

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në identifikimin e faktorëve që ndikojnë në tretjen e një lënde në ujë, shpjegimin e ndikimit të temperaturës në tretjen e një lënde, si dhe për përgjigjet e sakta lidhur me tekstin.

### Detyrë:

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Prejardhja, përbërja dhe vetitë e materieve

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Shpjegon se gjendja agregate e materialit varet nga kushtet e jashtme, sidomos nga temperatura.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1; II.8; III.4; V.8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Tretja e lëndëve të ndryshme në ujë dhe varësia nga temperatura - Fletore pune

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Shpjegon që gjendja e lëndës ndryshon nga temperatura;
- Demonstron tretjen dhe shkrirjen e lëndës nga ndikimi i temperaturës.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** gota qelqi, ujë, vëlues uji, sheqer, lugë, termometër, copë akulli.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Arsimitim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

*Lapsat në mes*

U shpërndahen nxënësve fletë A4 me pyetjen:

- *Cilët faktorë ndikojnë në gjendjen agregate të lëndëve? Trego me shembuj.*

Nxënësit shkruajnë përgjigjen dhe vendosin lapsat në mes të grupit. Kur të gjithë i përfundojnë përgjigjet, zgjidhet një laps dhe nxënësit që i takon tregojnë përgjigjen. Vazhdohet kështu për disa herë.

TRETJA E LËNDËVE TË NDRYSHME NË UJË DHE VARËSIA NGA TEMPERATURA

1. Detyrë: Provoje në shtëpi tretjen e sheqerit dhe të kripës në ujë të nxehtë dhe të ftohtë.

a) Merri dy gota qelqi: në një të vendos një lugë sheqer ose kripë dhe ujë të nxehtë, ndërsa në tjetrën një lugë sheqer ose kripë dhe ujë të ftohtë.



b) Përcille shpejtësinë e tretjes së tyre dhe mbaj shënime për kohën e tretjes së sheqerit ose kripës në ujë të nxehtë dhe të ftohtë. Trego ndonjë rast kur njohuritë e fituara nga eksperimenti aplikohen në jetën e përditshme. Atë që ke shkruar, diskutoje së bashku me mësuesin/in dhe shokët /shoqet e klasës.

2. Gjendja agregate e lëndëve varet nga kushtet e jashtme e veçmas nga temperatura.


a) Shkruaj, nën secilën figurë, se në çfarë temperature arrihet:

- a) pika e shkrirjes; b) pika e ngrirjes; c) pika e vlimit.



b) Pikën e shkrirjes, të ngrirjes dhe të vlimit mund t'i vërtetoni edhe vetë në shtëpi ose në shkollë, me ndihmën e mësuesit ose ndonjë të rrituri në shtëpi.


**Eksperiment:** për përcaktimin e pikës së shkrirjes së ujit nevojiten: gota e qelqit, termometri dhe copat e akullit.



**Ecuria e eksperimentit:** copat e akullit merren me dorë nga frigoriferi dhe vendosen në gotën e qelqit. Në temperaturë të dhomës, ato do të fillojnë menjëherë të shkrihen. Matet temperatura e përzierjes akull-ujë.

a) Pika e shkrirjes së ujit është në temperaturën prej \_\_\_\_\_ °C.

**Eksperiment:** për përcaktimin e pikës së vlimit të ujit nevojiten: ena për vlimin e ujit, uji, termometri, reshjoja dhe një gotë.



16

- Sa duhet të jetë temperatura kur uji është i ngrirë?
- Sa duhet të jetë temperatura që uji të kalojë në gjendje të gaztë?



**Përforcimi:**  
**Konsolidimi i të nxënit**  
*Shkrim i shpejtë*

Udhëzohen nxënësit ta përshkruajnë në fletore ecurinë e eksperimenteve të përfunduara.

Shembull:

- Sa më e lartë që është temperatura e ujit, tretshmëria është më e shpejtë, si rasti i ujit me sheqer.
- Kur një copë akulli ndodhet në temperaturë të dhomës, shumë shpejt fillon dhe shkrihet.
- Uji kalon në gjendje të gaztë kur arrin temperaturën 100 °C.
- Uji kur shkrihet, e ka temperaturën 0 °C.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në shpjegimin e ndikimit të temperaturës në tretje dhe shkrirje, si dhe në demonstrimin e ndryshimit të gjendjes agregate të ujit nga ndikimi i temperaturës.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---

---



**Ndërtimi i njohurive:**

**Përpunimi i përmbajtjes**

*Demonstrim përmes eksperimentit*

**Tretja e lëndës në ujë:**

- Marrim dy gota qelqi;
- Në njërën vendosim një lugë sheqer dhe ujë të nxehtë;
- Në tjetrën vendosim një lugë sheqer dhe ujë të ftohtë;
- Përzihen me lugë dy përzierjet;
- Matim kohën për sa tretet sheqeri në ujë të ftohtë dhe për sa kohë tretet sheqeri me ujë të nxehtë.

Shtrohen pyetjet për shqyrtim:

*Për sa kohë u tret sheqeri në ujë të nxehtë? Po në ujë të ftohtë? Pse ndodh kjo?*

**Shkrirja:**

- Marrim një gotë qelqi;
- Në të vendosim një copë akull;
- Gota lihet në temperaturë të klasës;
- Vërehet që akulli fillon menjëherë të shkrihet;
- Në atë moment, matni temperaturën e përzierjes akull-ujë.

Më pas shtrohen pyetjet:

- Sa është temperatura e përzierjes në këtë moment?

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Ajri dhe përbërësit e tij

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

- Dallon përbërësit kryesorë të ajrit (azoti, oksigjeni, dyoksidi i karbonit), si dhe demonstroi me anë të eksperimentit ndonjërin nga to;
- Interpreton rëndësinë e oksigjenit për frymëmarrjen, si dhe rëndësinë e mbrojtjes së ajrit prej papastërtive.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.1; II.8; III.4; V.8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përbërësit kryesorë të ajrit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Identifikon përbërësit kryesorë të ajrit;
- Përmbledh informacionet në grafik;
- Shpjegon rolin e oksigjenit në frymëmarrje.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

*Parashikim me terma paraprakë*

Paraqiten para nxënësve termat: *frymëmarrje, mushkëritë, jetë, bimë.*


Kërkohet nga nxënësit të mendojnë për 2 minuta se çfarë kuptojnë më fjalët e dhëna dhe çfarë u kujtojnë ato.

Diskutohet se: pa ajër nuk ka jetë, mushkëritë mundësojnë frymëmarrjen, kur kemi ambient të pastër, mbrojmë mushkëritë, marrim oksigjenin dhe lirojmë dyoksid karbonin etj.

7 AJRI DHE PËRBËRËSIT E TIJ  
Përbërësit kryesorë të ajrit

Ç'është ajri?

Ajri është përzierje e padukshme e gazeve të ndryshme që e rrethojnë planetin Tokë, të tilla si: oksigjeni, azoti dhe dyoksidi i karbonit, pa të cilat organizmat e gjallë në Tokë nuk do të mbijetonin.




Përbërja e ajrit nuk është e njëjtë në të gjitha vendet (ndryshon nga një vend në tjetrin), p.sh. në zonat e ndotura, përqendrimi i dyoksidit të karbonit është më i lartë se në ato me ajër të pastër. Përbërja e ajrit, po ashtu, ndryshon edhe me kalimin e kohës, p.sh. nëse ndizni një zjarr, në atë vend, ajri do të ketë tym dhe përbërës të tjerë, të cilët nuk i kishte para se të ndizej zjarri. Përbërësit kryesorë të ajrit janë prezantuar më poshtë:

Përbërësit e ajrit

Oksigjeni

Kur provojmë ta ndezim një qiri në mungesë të ajrit, ndezja dështon. Pse ndodh kjo? Ajri ka përbërësin që mundëson djegjen dhe ky përbërës është oksigjeni. Kështu që, pa oksigjen, nuk ka djegie. Oksigjeni është një nga përbërësit kryesorë të ajrit; ai përbën 21 % të ajrit atmosferik. Prodhuesit e oksigjenit janë bimët.



Në mungesë të oksigjenit, qiriri shuhet.



### Dyoksidi i karbonit

Dyoksidi i karbonit krijohet gjatë frymëmarrjes së bimëve (natën), të shtazëve, të njeriut dhe gjatë djegies së karburanteve (thëngjillit, naftës, benzines) etj. Ky përbërës i ajrit është në sasi të vogël (0.038%). Përqindja e tij ndryshon nga një vend në tjetrin dhe varet shumë nga shkalla e ndotjes. Dyoksidi i karbonit përdoret për shuarjen e zjarreve.

Aparatet zjarrfikëse përmbajnë dyoksid karboni sepse ai shuan zjarrin.



### Azoti

Përbërësi kryesor i ajrit është azoti. Ai përbën deri në 78 % të tij. Azoti, pos në ajër, gjendet edhe në tokë dhe në ujë, si dhe është i pranishëm te të gjithë organizmat e gjallë. Ai luan një rol kryesor në rritjen e bimëve. Kur bimëve u mungon azoti, ato zverdhën, kanë rritje të ngadaltë dhe prodhojnë lule e fruta më të vogla. Prandaj, fermerët shtojnë plehra të pasura me azot në tokë, për të ndikuar në rritjen e kulturave bimore. Njerëzit dhe kafshët azotin e marrin nga bimët përmes ushqimit.



Plehrat e pasura me azot janë të rëndësishme për rritjen e bimëve.

23




## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

*Mbajtja e strukturuar e shënimeve*

Nxënësit njoftohen me njësinë mësimore. Hapen librat dhe lexohet mësimi nga ana e nxënësve. Gjatë leximit, duhet të jenë të kujdesshëm pasi më pas do të shënojnë atë çfarë kanë kuptuar nga pjesa e lexuar.

Pas leximit, plotësohet grafiku.



## Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët

*Rishikim në dyshe*

Pas përfundimit, fletoret shkëmbehen me shokun apo shoqen e bankës për të parë se si janë përmbledhur informacionet dhe për t'i përmirësuar nëse ka gabime. Gjatë kontrollimit, nxënësit shkruajnë një koment për punën e bërë.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për identifikimin e përbërësve të ajrit, përmbledhjen e informacioneve në grafik, si dhe për shpjegimin e rolit të oksigjenit në frymëmarrje.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Ajri dhe përbërësit e tij

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Dallon përbërësit kryesorë të ajrit (azoti, oksigjeni, dyoksidi i karbonit), si dhe demonstroi me anë të eksperimentit ndonjërin nga ta.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.1; II.8; III.4; V.8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përbërësit kryesorë të ajrit - Fletore pune

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Demonstroi praninë e ajrit përmes eksperimentit;
  - Përshkruan rëndësinë e ajrit te qeniet e gjalla.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** dy gota, dy qirinj, një shkrepëse.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

*Dy të vërteta dhe një gënjeshtër*

Kërkohet nga nxënësit të shkruajnë tri fjali për ajrin. Dy prej fjalive duhet të jenë të vërteta dhe një gënjeshtër (nxënësit përpunon që gënjeshtër të mos jetë e dukshme).

Shembull:

1. Ajri është përzierje e gazrave.
2. Përbërësit e ajrit janë: oksigjeni, mushkëritë dhe azoti.
3. Ajri është pa ngjyrë, pa erë.

7

AJRI DHE PËRBËRËSIT E TIJ  
PËRBËRËSIT KRYESORË TË AJRIT

1. Ajri është një përzierje e gazrave të rëndësishme, për të cilat shumica e gjallesave kanë nevojë që të mbijetojnë. Përbërësit kryesorë të ajrit janë: oksigjeni, azoti dhe dyoksidi i karbonit. Oksigjenin si përbërës të ajrit mund ta konstatojmë vetë me anën e eksperimentit.

**Eksperiment:** mjetet dhe materiali që nevojiten janë: dy gota, dy qirinj, një shkrepëse.

**Ecuria e eksperimentit:** ndiz dy qirinj dhe menjëherë mbuloji me dy gota të madhësive të ndryshme.



a) Çfarë ndodh në atë moment me qirinj që është mbuluar me gotë të vogël e çfarë me atë që është mbuluar me gotë të madhe?

b) Cili përbërës i ajrit e ndihmon ndezjen?

c) Pse qirinjtë nuk janë fikur në të njëjtën kohë?

d) Pse ne marrim frymë?

e) Me çfarë gazi janë të mbushura aparatet zjarrfikëse, i cili mundëson fikjen e zjarrit?

f) Pse fermerët shtojnë plehra artificiale në tokat e tyre? Sqaro çfarë përmbajnë ato.



# 7

## AJRI DHE PËRBËRËSIT E TIJ

PERBËRËSIT KRYESORË TË AJRIT

1. Ajri është një përzierje e gazrave të rëndësishme, për të cilat shumica e gjallesave kanë nevojë që të mbijetojnë. Përbërësit kryesorë të ajrit janë: oksigjeni, azoti dhe dyoksidi i karbonit. Oksigjenin si përbërës të ajrit mund ta konstatojmë vetë me anën e eksperimentit.

**Eksperiment:** mjetet dhe materiali që nevojiten janë: dy gota, dy qirinj, një shkrepëse.

**Ecuria e eksperimentit:** ndiz dy qirinj dhe menjëherë mbuloji me dy gota të madhësive të ndryshme.



a) Çfarë ndodh në atë moment me qiriun që është mbuluar me gotë të vogël e çfarë me atë që është mbuluar me gotë të madhe?

\_\_\_\_\_

b) Cili përbërës i ajrit e ndihmon ndezjen?

\_\_\_\_\_

c) Pse qirinjtë nuk janë fikur në të njëjtën kohë?

\_\_\_\_\_

d) Pse ne marrim frymë?

\_\_\_\_\_

e) Me çfarë gazi janë të mbushura aparatet zjarrfikëse, i cili mundëson fikjen e zjarrit?

\_\_\_\_\_

f) Pse fermerët shtojnë plehra artificiale në tokat e tyre? Sqaro çfarë përmbajnë ato.

\_\_\_\_\_

18



### Ndërtimi i njohurive:

#### Përpunimi i përmbajtjes

Hulumtim/shqyrtim i përbashkët

Merren dy qirinj, ndizen dhe mbuloohen me gota të madhësive të ndryshme.

Gjatë eksperimentit, shtrohen pyetje si:

- Cili përbërës i ajrit e ndihmon ndezjen?
- Çfarë po ndodh me qiriun e mbuluar me gotë të vogël?
- Po qiriun me gotë të madhe?
- Qirinjtë u fikën në të njëjtën kohë. Pse?

Arrihet në përfundim se:

*Përbërësi i ajrit që mundëson djegien është oksigjeni. Qiriun i mbuluar me gotë të vogël fiket më shpejt, kurse qiriun i mbuluar me gotë të madhe fiket më ngadalë se gota tjetër, sepse ka prani të oksigjenit më shumë. Jo, qirinjtë nuk u fikën në të njëjtën kohë sepse gotat ishin me madhësi të ndryshme.*



### Përforcimi:

#### Konsolidimi i të nxënës

Mendo/puno në dyshe/shkëmbe mendime

Hapen fletoret e punës. Udhëzohen nxënësit të punojnë në dyshe, duke iu përgjigjur pyetjeve të shtruar, si:

1. Pse ne marrim frymë?
2. Cili është gazi në aparatet zjarrfikëse që mundëson fikjen e zjarrit?
3. Pse fermerët shtojnë plehra artificiale në tokat e tyre? Sqaro çfarë përmbajnë ato.

Më pas, diskutohet me gjithë klasën.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari, për saktësinë në demonstrimin e pranisë së ajrit, si dhe përshkrimin e rëndësisë së ajrit te qeniet e gjalla.

### Detyrë:

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Ajri dhe përbërësit e tij

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Interpreton rëndësinë e oksigjenit për frymëmarrjen, si dhe rëndësinë e mbrojtjes së ajrit prej papastërtive.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.1; II.8; III.4; V.8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbrojtja e ajrit nga ndotja

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përshkruan ndotësit e tokës përmes ilustrimit;
- Veçon njohuritë në tekst në bazë të kodeve të dhëna;
- Argumenton rëndësinë e mbajtjes pastër të mjedisit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

*Parashikim me terma paraprakë*

Me anë të projektorit, shfaqet ilustrimi.

Shtrohet pyetja:

- Çfarë ju vjen në mendje kur shikoni këtë foto?

Nxiten nxënësit të marrin pjesë sa më shumë në diskutim.

Ja disa përgjigje të mundshme: *Ndotja e mjedisit nga shumë faktorë, shkatërrimi i pyjeve nga njerëzit dhe ndryshimet klimatike, ndotësit e ajrit nga makinat, fabrikat, zjarret etj.*

8 Mbrojtja e ajrit nga ndotja

Ajri ka përbërësit e tij të zakonshëm, në përqindje të caktuara. Shtimi i ndonjë përbërësi të ri ose ndryshimi i madh i përqindjes së ndonjë përbërësi ekzistues të ajrit shkakton ndotje. Ajri ndotet nga tymi, grimcat e pluhurit dhe gazet e shkarkuara nga industritë, termocentralet, qarkullimi i automjeteve, oxhakët e shtëpive, djegia e mbeturinave, djegia e pyjeve, ndërtime etj. Ndotësit e ajrit kanë efekte të dëmshme në shëndetin e njeriut, dhe mund të shkaktojnë sëmundje të organeve të frymëmarrjes, siç janë: pneumonitisi, astma, kanceri i mushkërve etj. Ndotësit, gjithashtu, dëmtojnë bimët, shtazët, ndërtesat, monumentet etj. Ndotja e ajrit nga shkarkimi i gazeve nga djegia e thëngjillit në termocentralet shkakton edhe të ashtuquajturin shi të thartë (acidik), i cili, po ashtu, dëmton pemët, tokat, lumenjtë etj.



Tymi paraqet një përzierje gazesh që lirohen gjatë djegies së materialeve të ndryshme. Përbërja e tij varet nga lloji i materialit që digjet. Burime kryesore të tymit janë: termocentralet, oxhakët e shtëpive, automjetet, djegia e pyjeve, djegia e mbeturinave etj. Tymi është shumë i dëmshëm për shëndetin e të gjithë organizmave të gjallë. Gjatë stinës së vjeshtës dhe të dimrit, temperaturat ulen, ajri bëhet më i lagësht dhe krijohet mjegulla. **Mjegulla** e përzier me tym, gaze të tjera, pluhur etj. krijon **smogun**, i cili është shumë i dëmshëm për organet e frymëmarrjes të njeriut. Niveli i ndotjes është veçanërisht i lartë në qytete të mëdha dhe qendra industriale.



Smogu



Sipërfaqet e ajelbra, shtigjet për këmbësorë dhe çiklistë

**Planifikimi i mirë urban** mund të zvogëlojë ndotësit e ajrit, veçmas duke zgjeruar sipërfaqet e ajelbra për publikun. Ndotësit e ajrit zvogëlohen edhe me shtimin e shtigjeve për këmbësorë dhe çiklistë. Industritë mund të ulin ndotësit e ajrit duke përdorur pajisjet e kontrollit të ndotjes, të cilat i thithin, filtrojnë, hollojnë ose i shpërndajnë ata.

Ulja e nivelit të ndotësve në ajër është e rëndësishme për shëndetin tonë dhe mjedisin në përgjithësi. Ka shumë mënyra se si ne mund të ndikojmë në uljen e ndotësve në ajër, p.sh. mund të ecim, të lëvizim me biçikletë ose të përdorim transportin publik në vend se të udhëtojmë me makinë; shmangim djegien e mbeturinave dhe të materialeve të tjera; kursejmë energji, p.sh. ulim temperaturën e ngrohjes në banesë, kur nuk ka nevojë, ndalim dritat në dhomë etj.



1. Cilët janë shkaktarët e ndotjes së ajrit?
2. Cili është efekti i ndotjes së ajrit në shëndetin e njeriut?
3. Kë e dëmton shiu i thartë që formohet nga djegia e thëngjillit?
4. Si krijohet smogu dhe çfarë efekti negativ ka te njeriu?
5. Si mundemi ne të ndikojmë në uljen e ndotjes së ajrit?



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes *Leximi i imët me kodim*

Hapen librat. Lexohet njësia mësimore në mënyrë individuale e më pas vazhdohet puna në dyshe. Gjatë leximit përdoren kodet si:

**F** - vendoset në fund të fjalisë, ku është përmendur ndonjë faktor që ndikon në ndotjen e mjedisit.

**D** - vendoset në fund të fjalisë, ku përmenden dëmet e shkaktuara nga faktorët.

**K** - vendoset në fund të fjalisë, ku jepen këshilla lidhur me ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit. Pas përfundimit të punës në dyshe, diskutohet me gjithë klasën lidhur me informacionet e marra gjatë leximit.

(F)	(D)	(K)



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit *Shkrimi i shpejtë*

Udhëzohen nxënësit të bëjnë një shkrim të shpejtë në fletore pune tek ushtrimi 2, rreth temës:  
“Si mund të ndikojmë ne në familjet tona, sidomos nëpër institucione, në uljen e ndotjes së ajrit?”  
Shkrimet kontrollohen dhe vlerësohen me nga një koment nga shoku apo shoqja e bankës.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përshkrimin e ndotësve të mjedisit, veçimin e njohurive me anë të kodeve të dhëna, si dhe argumentimin e rëndësisë së mbajtjes pastër të mjedisit me anë të shkrimit.

### Detyrë:

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

**ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Riprodhimi i qenieve të gjalla

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Shpjegon procesin e riprodhimit të qenieve të gjalla.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.1; II.3; III.4; V.8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2.

**ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Njësia mësimore:** Riprodhimi te bimët

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Rendit informacionet për temën e përcaktuar;
  - Formulon përgjigje rreth njësisë mësimore;
  - Përshkruan me anë të vizatimit procesin e riprodhimit të bimëve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fletë A4.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimitim për zhvillim të qëndrueshëm.


**METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS**

 **Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**  
*Di*

Nxënësve u shpërndahen fletë A4, ku janë tri kolona:

DI	DUA TË DI	MËSOVA

Nxiten nxënësit të shkruajnë në kolonën *Di* se çfarë dinë rreth pyetjes: - Si bëhet riprodhimi i bimëve?.




Disa bimë nuk riprodhohen me fara, po me **qepujka, zhardhokë, pjesë të kërcellit, gjethe, rrënjë** etj. Këto mënyra të riprodhimit njihen si **riprodhim vegetativ**.




Riprodhimi i bimës nga qepujkat



Riprodhimi i bimës nga zhardhokët



Riprodhimi i bimës nga pjesët e kërcellit



Riprodhimi i bimës nga gjethja

Diskutoni në klasë për mënyrat e riprodhimit (shumimit) të luleve në shtëpitë tuaja!

1. Si quhet procesi i krijimit (lënies) të pasardhësve?
2. Cili është riprodhimi më i zakonshëm i bimëve?
3. Përkrah mënyrat e tjera të riprodhimit të bimëve.
4. Emërto mënyrat e riprodhimit vegetativ.

29



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes Dua të di - Mësova

Udhëzohen të formulojnë pyetje se çfarë dëshirojnë të dinë për riprodhimin e bimëve në kolonën *Dua të di*.

Ja disa pyetje të mundshme:


- Pse bima është organizëm i gjallë?
- Cilët faktorë ndikojnë në rritjen e bimës?
- Cili është riprodhimi më i zakonshëm i bimëve?

Më pas, vazhdohet puna, duke lexuar njësinë mësimore. Gjatë leximit, gjejnë përgjigjet për pyetjet e shtruara. Pasi nxënësit kanë lexuar njësinë mësimore, renditin informacionet e marra gjatë leximit në kolonën *Mësova*.



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit Harta e konceptit

Në dyshe, vizatohet riprodhimi i bimëve nga qepujka, zhardhoka, pjesë të kërcellit, gjethja.



### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në renditjen e informacioneve për temën e përcaktuar, formulimin e drejtë të pyetjeve rreth njësisë mësimore, si dhe për përshkrimin e procesit të riprodhimit të bimëve me anë të vizatimit.

### Detyrë:

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---



ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Riprodhimi i qenieve të gjalla

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Shpjegon procesin e riprodhimit të qenieve të gjalla.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.1; II.3; III.4; V.8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Riprodhimi te kafshët

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Identifikon llojet e riprodhimit të kafshëve dhe karakteristikat e tyre;
- Shpjegon rëndësinë e riprodhimit të kafshëve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fletë pune me strukturë të shënimeve, zile e dorës.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimitim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

*Dil rrotull - fol rrotull*

Në tabelë shkruhet pyetja: *Çfarë kuptoni me procesin e riprodhimit?*. U kërkohet nxënësve të lëvizin nëpër hapësirat e klasës. Në momentin që dëgjohet zilha e dorës nga mësuesja, ndalohet së lëvizuri dhe kapet për dorë shoku a shoqja më e afërt. Me dyshen e krijuar, diskutohet për pyetjen. Të dy nxënësit brenda dyshes duhet të japin mendimet e tyre. Më pas, mësuesja zgjedh një nga dyshet dhe i pyet.

**Shembull:**

- Mira, çfarë mësove nga Drini?
- Drini më shpjegoi se procesi i riprodhimit është aftësi e qenieve të gjalla për të krijuar pasardhës.
- Po ti, Drin, ç'mësove nga Era?
- Era shtoi se ka mënyra të ndryshme të riprodhimit.

10 Riprodhimi te kafshët

Sikurse bimët, edhe kafshët krijojnë pasardhësit e tyre. Ato e kryejnë riprodhimin përmes vezëve ose përmes lindjes së të vegjëlvë të tyre.

**Riprodhimi i kafshëve me vezë:**



Flutura



Peshku



Pëllumbi



Breshka



Bretkosa



Për shembull, pula është një rast ku shumimi bëhet me vezë. Ajo, pasi të lëshojë vezët në furrikun e saj, ulet mbi to dhe i mban të ngrohta për rreth tri javë derisa zogjtë të dalin nga vezët. Ky proces i mbajtjes së vezëve të ngrohta quhet **inkubim**.

Procesi i inkubimit

Te disa kafshë, mënyra e riprodhimit është sikurse e njeriut, pra duke i lindur të vegjlit. Qeniet e gjalla që lindin të vegjlit e tyre dhe i ushqejnë ata me qumësht quhen **gjitarë**. Pra, janë emërtuar kështu sepse kanë gjinj. Nëna mban të voglin brenda në bark derisa të zhvillohet. Koha e zhvillimit është e ndryshme, varësisht nga gjitarët, p.sh.: te njeriu ajo është nëntë muaj, te macja dy muaj, te elefanti ky proces zgjat 21 muaj etj.

Pasi i vogli të zhvillohet plotësisht, ai lind. Shumica e të vegjëlve kur linden janë të dobët dhe s'mund të kujdesen për veten. Nënata e tyre kujdesen për ta, p.sh. i ushqejnë, i mbrojnë nga rreziqet e mundshme etj. Për dallim nga gjitarët e tjerë, njeriut i nevojitet kohë më e gjatë që të kujdeset për pasardhësit e tij.

**Riprodhimi i kafshëve me lindje:**



Lepuri



Qeni




Luani



Maoja

**Rëndësia e riprodhimit**

Jeta e një individi nuk është e pafundme dhe gjatësia e jetës varet nga lloji i organizmit. Për shembull, jetëgjatësia e disa organizmave mund të jetë një ditë, ndërsa e organizmave të tjerë mund të jetë edhe 5000 vjet. Pas një kohe, secili organizëm vdes. Organizmat, edhe pse vdesin, lloji i tyre nuk zhduket falë aftësisë që kanë ata për të lënë pasardhës.



Mizë maji është insekt ujor që ka jetëgjatësinë më të shkurtër - 24 orë ose më pak.

31



**Ndërtimi i njohurive:  
Përpunimi i përmbajtjes**

*Mbajtja e strukturuar e shënimeve*

Udhëzohen nxënësit ta lexojnë mësimin. U shpërndahet fleta e punës me një strukturë organizative për mbajtjen e shënimeve. Struktura për shënime duhet të përfshijë gjithë mësimin, duke përfshirë analizë, krahasim, koncepte. Nxënësit e plotësojnë atë, duke bashkëpunuar me shokun a shoqen e bankës. Të nxiten nxënësit t'i justifikojnë me njëri-tjetrin përzgjedhjet gjatë plotësimin të shënimeve.

Ja një shembull i mbajtjes së strukturuar të shënimeve:

Riprodhimi i kafshëve				
Rëndësia e këtij procesi	Mënyrat e riprodhimit	Kafshët që riprodhohen me vezë	Çfarë nënkupton procesi i inkubimit	Shpjego disa karakteristika të riprodhimit të gjitarëve



**Përforcimi:  
Konsolidimi i të nxënit**

*Ditari trepjesësh*

Në tabelë shkruhet pyetja: *A është i rëndësishëm procesi i riprodhimit të kafshëve?*. Tabela krijohet nga nxënësit në fletore, shkruhet pyetja, përgjigja dhe bëhet argumentimi i bazuar në fakte.

Pyetja	Përgjigja	Argumenti

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për identifikimin e saktë të llojeve të riprodhimit të kafshëve dhe karakteristikat e këtyre riprodhimeve, si dhe për shpjegimin dhe argumentimin e rëndësisë së procesit të riprodhimit.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.*

---



---



ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Riprodhimi i qenieve të gjalla

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Krahason të veçantat dhe të përbashkëtat e riprodhimit tek organizmat e grupeve të ndryshme.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.1; II.3; III.4; V.8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Riprodhimi i bimëve dhe i kafshëve - Fletore pune

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përcakton mënyrën e riprodhimit të bimëve nga figurat e dhëna;
- Dallon shtazët që riprodhohen me vezë nga ato me lindje;
- Realizon riprodhimin e bimës me anë të kërcellit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektor, laptop, vazo, kërcell.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimitim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënët**

*Diskutim për njohuritë paraprake*

Në tabelë shënohet titulli *Riprodhimi i bimëve dhe i kafshëve*. Me projektor paraqitet detyra 1a në faqe 21 dhe detyra 1a në faqe 22 nga fletore pune. Të dyja detyrat plotësohen bashkërisht, duke diskutuar dhe nxitur mendimin kritik, me këtë rast rikujtohen edhe njëherë llojet e riprodhimit të bimëve dhe të kafshëve.


RIPRODHIMI I QENIEVE TË GJALLA

RIPRODHIMI TE BIMËT


9

1. Riprodhimi i bimëve kryhet në disa mënyra.

a) Shkruaj, nën secilën bimë të paraqitur në figurë, mënyrën e riprodhimit.



**Eksperiment:** mënyrën e riprodhimit të bimëve me anë të kërcellit mund ta bëni në laboratorin e biologjisë, së bashku me mësuesen/in dhe shokët/shoqet e klasës. Njëri nga ju le ta sjellë një vazo me lule në shkollë, ndërsa një tjetër një vazo me dhe. Në fillim, bëni prerjen e një pjese të kërcellit si në figurë dhe vendoseni në vazon e mbushur me dhe. Ditëve në vijim, përcilleni riprodhimin e bimës së re dhe diskutoni në klasë.



## 10 RIPRODHIMI TE KAFSHËT

1. Shtazët riprodhohen në dy mënyra: duke lëshuar vezë dhe duke i lindur të vegjlit e tyre.

a) Shkruaj në tabelë emrat e disa shtazëve që riprodhohen me vezë dhe të atyre me lindje.

Riprodhimi i shtazëve me vezë	Riprodhimi i shtazëve me lindje

b) Çfarë është inkubimi dhe pse duhet të ndodhë?

---

---

c) Pse një grup i organizmave quhen *gjitarë*?

---

---

d) Shkruaj për jetëgjatësinë e ndonjë organizmi që di ti.

---

---

22



### Ndërtimi i njohurive:

#### Përpunimi i përmbajtjes

*Demonstrim përmes eksperimentit*

Nxënësit njoftohen në orën paraprake për realizim të eksperimentit që ndodhet në faqe 19, në fletore pune. Përcaktohen disa nxënës për të sjellë mjetet e nevojshme për realizim të eksperimentit.

Realizohet eksperimenti, përfshihen sa më shumë nxënës në realizim të tij. Shënohen në formë të strukturuar në fletore:

- emri i eksperimentit;
- mjetet e nevojshme;
- fazat e realizimit;
- përfundimi.

Përfundimi bëhet ditëve në vazhdim, sepse ky eksperiment kërkon vërtetim më afatgjatë.




### Përforcimi:

#### Konsolidimi i të nxënës

*Rrjeti i diskutimit*

Nxënësve u paraqitet pohimi i dhënë:

**Inkubimi është një proces shumë i rëndësishëm të riprodhimi i kafshëve.**



Secila përgjigje duhet të argumentohet. Disa nga përgjigjet lexohen para klasës. Në fund, arrihet në përfundim me përgjigjen e duhur në mënyrë të përbashkët.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përcaktim të saktë të mënyrave të riprodhimit të bimëve, për dallim të shtazëve në bazë të riprodhimit, si dhe për realizim të eksperimentit.

### Detyrë:

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---

---

**ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Riprodhimi i qenieve të gjalla

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Shpjegon procesin e riprodhimit të qenieve të gjalla.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.1; II.3; III.4; V.8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2.

**ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Njësia mësimore:** Riprodhimi te njerëzit

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon mënyrën e riprodhimit të njeriut;
  - Dallon qelizat seksuale femërore dhe ato mashkullore;
  - Shpjegon procesin e krijimit të foshnjës gjatë shtatzënisë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fletë pune, projektor, laptop.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimitim për zhvillim të qëndrueshëm.

**METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS**

**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**  
*Di - Dua të di - Mësova*

Nxënësve u shpërndahet një fletë e punës, në të cilën është e punuar tabela e ndarë në tri kolona *Di - Dua të di - Mësova*. E njëjta tabelë paraqitet me anë të projektorit. Në fillim të fletës së punës, shënohet titulli i njësisë mësimore. Shiko shembullin në vijim:

Riprodhimi te njeriu		
Di	Dua të di	Mësova

Në këtë fazë të orës, plotësohet kolona *Di*. Nxënësit thonë gjithçka që dinë rreth njësisë. Nxiten me pyetje të ndryshme si:

**11 Riprodhimi te njerëzit**

Sikurse për organizmat e tjerë, edhe për njeriun riprodhimi është thelbësor për vazhdimin e jetës së llojit (qenieve) njerëzor. Njerëzit riprodhohen në mënyrë seksuale, përkatësisht me bashkimin e qelizës seksuale femërore (vezës) dhe qelizës seksuale mashkullore (spermatozoidit). Veza dhe spermatozoidi kur bashkohen formojnë një **zigotë**. Kështu fillon **shtatzënia**. Shtatzënia zakonisht zgjat nëntë muaj e një javë (= 280 ditë) dhe pastaj lind foshnja.




Gruaja shtatzënë



Foshnja e sapotindur duke u ushayer me qumështin e gjirit të nënës

Bashkimi i vezës dhe i spermatozoidit formon zigotën. Zigota zhvillohet në embrion, ndërsa embrioni zhvillohet në fetus dhe pas rreth 280 ditësh lind foshnja.



Bashkimi i vezës dhe i spermatozoidit

1. Shpjego mënyrën e zakonshme të riprodhimit të njerëzve.
2. Sa është kohëzgjatja e një shtatzënie te njerëzit?

## 11 Riprodhimi te njerëzit

Sikurse për organizmat e tjerë, edhe për njeriun riprodhimi është thelbësor për vazhdimin e jetës së llojit (qenieve) njerëzor. Njerëzit riprodhohen në mënyrë seksuale, përkatësisht me bashkimin e qelizës seksuale femërore (vezës) dhe qelizës seksuale mashkullore (spermatozoidit). Veza dhe spermatozoidi kur bashkohen formojnë një **zigotë**. Kështu fillon **shtatzënia**. Shtatzënia zakonisht zgjat nëntë muaj e një javë (= 280 ditë) dhe pastaj lind foshnja.




Gruaja shtatzënë



Foshnja e sapolindur duke u ushqyer me qumështin e gjirit të nënës

Bashkimi i vezës dhe i spermatozoidit formon zigotën. Zigota zhvillohet në embrion, ndërsa embrioni zhvillohet në fetus dhe pas rreth 280 ditësh lind foshnja.



Bashkimi i vezës dhe i spermatozoidit

1. Shpjego mënyrën e zakonshme të riprodhimit të njerëzve.
2. Sa është kohëzgjatja e një shtatzënie te njerëzit?



33

- Çfarë rëndësie ka riprodhimi për njerëzit?
- Sa muaj qëndron foshnja në bark të nënës?
- Si quhet procesi i rritjes së foshnjës në barkun e nënës?



### Ndërtimi i njohurive:

#### Përpunimi i përmbajtjes

Di - Dua të di - Mësova

U kërkohet nxënësve të krijojnë pyetje se çfarë duan të dinë më shumë për njësinë mësimore. Të gjitha pyetjet e krijuara shkruhen në kolonën *Dua të di*.

Shembull:

- Cila është mënyra e riprodhimit të njerëzve?
- Si quhen qelizat seksuale?
- Si ndodh ky procesi i ngjizjes?
- Si zhvillohet foshnja në barkun e nënës?

Pas krijimit dhe shkrimit të pyetjeve, hapen librat dhe lexohet njësia mësimore. Nxiten nxënësit të mbajnë shënime në fletore kur gjejnë përgjigjet e pyetjeve të parashtruara.



### Përforcimi:

#### Konsolidimi i të nxënit

Di - Dua të di - Mësova

Pas leximit të mësimit, diskutohen bashkërisht të gjitha pyetjet e parashtruara dhe jepen përgjigje nga nxënësit. Dëgjohen dy deri në tri mendime për një pyetje dhe formulohet përgjigja sa më e kompletuar. Ato shkruhen te kolona *Mësova*.

Në fund, mund të shikohet një video edukative për riprodhimin e njeriut në vegëzën e mëposhtme: <https://www.youtube.com/watch?v=4uLqoSh55M8>

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për identifikimin e mënyrës së riprodhimit të njerëzve, dallimin e qelizave seksuale riprodhuese të të dyja gjinive, si dhe për shpjegimin e saktë të procesit të zhvillimit të foshnjës gjatë shtatzënisë.

#### Detyrë:

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

**ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Riprodhimi i qenieve të gjalla

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Shpjegon procesin e riprodhimit të qenieve të gjalla.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; III.1; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2.

**ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Njësia mësimore:** Riprodhimi te njerëzit - Fletore pune

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përkufizon konceptin e riprodhimit të njeriut;
  - Përshkruan mënyrën e riprodhimit të njeriut nga figura e dhënë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fletë pune, projektor, laptop.


**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimitim për zhvillim të qëndrueshëm.

**METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS**

**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**  
*Diskutim për njohuritë paraprake*

LINK - Rendit, Kërko, Shëno dhe Mëso

Vendoset koncepti “Riprodhimi i njeriut” në mes të tabelës ose shfaqet përmes projektorit. Më pas pyeten nxënësit për lidhje të ndryshme rreth njohurive që kanë për konceptin e shënuar. Fillimisht, shënohen vetëm fjalët që ata japin e më pas thellohuni në përgjigje të mëtutjeshme. Nxitni nxënësit të pyesin rreth termave të shënuar. Shembull: *Pse të bën të mendosh që ky term ka lidhje me konceptin e riprodhimit? Pse e zgjedhe pikërisht këtë lloj lidhjeje?*



1. Riprodhimi te njeriu mundëson vazhdimin e jetës së qenieve njerëzore.

a) Si riprodhohen njerëzit?

---



---


b) Sa zgjat shtatzënia?

---



---

2. Duke u bazuar në njohuritë e fituara nga libri bazë, plotësoni vendet boshë në figurë.



## RIPRODHIMI TE NJERËZIT

11

1. Riprodhimi te njeriu mundëson vazhdimin e jetës së genieve njerëzore.

a) Si riprodhohen njerëzit?

---


---

b) Sa zgjat shtatzënia?

---

---

2. Duke u bazuar në njohuritë e fituara nga libri bazë, plotësoni vendet boshe në figurë.



23

Diskutohen bashkërisht përkufizimet, nxitet respektimi i opinioneve të tjetrit. Pasi përfundohet me diskutime, fshihet tabela, ndërsa nxënësit, në fletë të pastër, pa shikuar shënimet, shkruajnë një përkufizim për konceptin e shënuar, duke u bazuar në hulumtimet e bëra paraprakisht.



**Ndërtimi i njohurive:**

**Përpunimi i përmbajtjes**

*Të nxënësit përmes punës praktike*

Plotësohet ushtrimi 1a dhe 1b në fletore pune, në mënyrë individuale. Mësuesi kontrollon punën, jep sqarime shtesë, korrigjon dhe vlerëson përgjigjet e shënuara.



**Përforcimi:**

**Konsolidimi i të nxënit**

*Mendo/puno në dyshe/shkëmbe mendime*

Udhëzohen nxënësit ta plotësojnë ushtrimin e dytë, në faqen 23, në fletore pune, në dyshe me shokun a shoqen e bankës. Fillimisht, bëhet analizimi i detyrës në mënyrë individuale. Më pas diskutohet në dyshe. Shkëmbehen mendimet me njëri-tjetrin e më pas me gjithë klasën.

Gjatë diskutimit me klasën, udhëzohen nxënësit të argumentojnë, mbrojnë idetë me fakte, si dhe ta pyesin njëri-tjetrin për çështjet që diskutohen.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përkufizimit të riprodhimit të njeriut në bazë të termave të dhënë, si dhe për shpjegimin e duhur të procesit të riprodhimit me anë të figurës së dhënë.

**Detyrë:**

---

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---

---



ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Riprodhimi i qenieve të gjalla

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Identifikon mënyra të ruajtjes së ushqimit nga faktorët mjedisorë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.1; III.4; V.8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ndikimi i njeriut në biodiversitet

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Tregon se çfarë është biodiversiteti;
- Përshkruan ndikimin e njeriut në biodiversitet;
- Identifikon veprimtaritë shkatërruese të biodiversitetit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** kompjuter.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Arsimitim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënët**

*Harta e konceptit*

LINK - Rendit, Kërko, Shëno dhe Mëso

Jepet në mes të një flete pune koncepti themelor i njësisë mësimore: *Biodiversiteti*. Në mënyrë të strukturuar, nxënësit, duke punuar në grupe, do ta gjejnë shpjegimin e fjalës. Do të përshkruajnë një përdorim të kësaj fjale në fjali dhe çfarë përfshin biodiversiteti. Përcaktohen përfaqësues të grupeve, të cilët e bëjnë kërkimin e fjalës në fjalor dhe mund ta përdorin kompjuterin për kërkime online nëse u duhet për hulumtim. Gjatë kësaj pune, të gjithë nxënësit e grupeve punuese lexojnë njësinë mësimore dhe mundohen të gjejnë përgjigje.

12 Ndikimi i njeriut në biodiversitet

Biodiversiteti nënkupton shumëllojshmërinë e organizmave të gjallë që gjenden në planetin Tokë. Ndikimi i njeriut në biodiversitetin e planetit Tokë është i ndryshëm. Rritja e numrit të popullsisë ka ndikuar në rritjen e kërkesave për sasi më të madhe të ushqimit, të hapësirës etj. Kështu është rritur edhe domosdoshmëria e shndërrimit të zonave pyjore dhe atyre livadhore në sipërfaqe tokash të punuara dhe për ndërtimin e vendbanimeve. Biodiversiteti po dëmtohet nga njeriu edhe nga grumbullimi i pakontrolluar i bimëve mjekësore dhe aromatike, peshkimi i pakontrolluar, gjuetia ilegale, p.sh., kërkesa e lartë për lëkura, dhëmbë të fildishtë, ushqim etj.



Shenja që tregon se gjuetia ndalohet në një zonë të caktuar.



Peshkimi i pakontrolluar

Është e rëndësishme që njerëzit të kuptojnë se si veprimet e tyre ndikojnë në biodiversitet dhe rëndësinë e ruajtjes së tij në Tokë. Kjo mund të arrihet përmes edukimit të duhur.



1. Çfarë është biodiversiteti?
2. Përshkruaj ndikimin e njeriut në biodiversitet.
3. Si mund të bëhet ruajtja e biodiversitetit?



## 12 Ndikimi i njeriut në biodiversitet

Biodiversiteti nënkupton shumëllojshmërinë e organizmave të gjallë që gjenden në planetin Tokë. Ndikimi i njeriut në biodiversitetin e planetit Tokë është i ndryshëm. Rritja e numrit të popullsisë ka ndikuar në rritjen e kërkesave për sasi më të madhe të ushqimit, të hapësirës etj. Kështu është rritur edhe domosdoshmëria e shndërrimit të zonave pyjore dhe atyre livadhore në sipërfaqe tokash të punuara dhe për ndërtimin e vendbanimeve. Biodiversiteti po dëmtohet nga njeriu edhe nga grumbullimi i pakontrolluar i bimëve mjekësore dhe aromatike, peshkimi i pakontrolluar, gjuetia ilegale, p.sh., kërkesa e lartë për lëkura, dhëmbë të fildishtë, ushqim etj.



Shenja që tregon se gjuetia ndalohet në një zonë të caktuar.



Peshkimi i pakontrolluar

Është e rëndësishme që njerëzit të kuptojnë se si veprimet e tyre ndikojnë në biodiversitet dhe rëndësinë e ruajtjes së tij në Tokë. Kjo mund të arrihet përmes edukimit të duhur.



1. Çfarë është biodiversiteti?
2. Përshkruaj ndikimin e njeriut në biodiversitet.
3. Si mund të bëhet ruajtja e biodiversitetit?

34

### SHPJEGIMI I FJALËS:

Biodiversitet do të thotë shumëllojshmëri...

### BIODIVERSITETI

BIODIVERSITETI PËRFSHIN:  
Njerëzit, bimët, kafshët dhe mjedisin ku jetojnë.

PËRDORIMI NË FJALË: Mbjajta dhe ruajtja e biodiversitetit është e rëndësishme për qëllimet e ruajtjes së mjedisit.



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes Pyetja sjell pyetjen

Krijohen disa pyetje rreth njësisë mësimore. Të gjitha pyetjet fillojnë me *pse*, ku brenda vetes kanë strukturë shkak-pasojë.

Pyetjet mund të jenë:

- *Pse mbrojtja e biodiversitetit është e rëndësishme?*
- *Pse rritja e numrit të popullsisë ka ndikuar në rritje të kërkesave për sasi më të madhe ushqimi?*
- *Pse rritja e kërkesave për sasi më të madhe të ushqimit ka ndikuar në shkatërrim të biodiversitetit?*

Kërkoni nga nxënësit të studiojnë informacionet e reja në njësinë mësimore që të arrihet sa më lehtë të përgjigjja. Lexohet pyetja e parë, jepen disa minuta kohë për diskutim në grup dhe merret

një mendim nga përfaqësuesi. Për çdo pyetje të radhës, ndryshohet përfaqësuesi. Më pas, secili grup e krijon një pyetje që fillon me *pse* dhe ia parashtronë njëri-tjetrit.



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit Shkrim i lirë

Të shkruhen disa veprimtari shkatërruese të *biodiversitetit* dhe të shpjegohet si mund të parandalohen këto dukuri. Puna bëhet duke bashkëpunuar në dyshe me shokun a shoqen e bankës.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e shpjegimit të fjalës *biodiversitet*, për përshkrimin e ndikimit që ka njeriu në ndryshimin e tij, si dhe për identifikimin e saktë të veprimtarive shkatërruese të biodiversitetit.

### Detyrë:

Të plotësohet në fletore pune, faqe 24.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Ruajtja e ushqimit dhe lëndët helmuese

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

- Identifikon mënyra të ruajtjes së ushqimit nga faktorët mjedisorë;
- Analizon rëndësinë e të ushqyerit shëndetshëm.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1; II.1; II.5; III.1; V.3.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.3; 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mënyrat e ruajtjes së ushqimit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përshkruan mënyrat e ruajtjes së ushqimit;
- Organizon informacionet në grafik;
- Vlerëson rëndësinë e ruajtjes së ushqimit për shëndetin e njeriut.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fletë e bardhë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimitim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

*Parashikim me terma paraprakë*

Paraqiten para nxënësve termat: *turshi, bodrume, ngrirja, tharja.*

Kërkohet nga nxënësit të mendojnë për 2 minuta, rreth pyetjeve se çfarë kuptojnë me fjalët e dhëna dhe çfarë u kujtojnë ato.

Diskutohet se: këto janë disa mënyra të mbrojtjes së ushqimit, sidomos ushqimet e ndjeshme, zakonisht ushqimet ruhen në vende të ftohta, p.sh., bodrume, frigorifer, ngrirje etj.

13 RUAJTJA E USHQIMIT DHE LËNDËT HELMUESE  
Mënyrat e ruajtjes së ushqimit

Të gjitha ushqimet kanë një periudhë të caktuar gjatë së cilës mund të përdoren. Te disa lloje të ushqimeve kjo periudhë është e shkurtër (ushqimi mund të priset shpejt), ndërsa te disa të tjera kjo është më e gjatë (ushqimi priset më ngadalë). Gjatë gjithë kohës (përgatitjes dhe ruajtjes), ushqimet duhet të mbrohen nga faktorët e mjedisit të jashtëm dhe ndotësit e mundshëm.



Është shumë e rëndësishme që ushqimin ta mbrojmë nga faktorët e mjedisit të jashtëm (p.sh., nga temperatura, lagështia, drita e fortë etj.), si dhe nga ndotësit e ndryshëm. Të gjithëve ju ka ndodhur që ta ruani ushqimin në frigorifer. Në frigorifer (temperaturë të ulët) ushqimi ruhet më mirë dhe më gjatë. Po ashtu, kenit rastisur që të hani fruta, mish dhe ushqime të tjera të terura. Ushqimi teret (thahet) për të larguar lagështinë nga ai. Kjo mundëson ruajtje më të mirë dhe më të gjatë të ushqimit. Për ta rritur kohën e ruajtjes së ushqimit, ai mund të konservohet (p.sh., turshitë), mund të zihet dhe t'i shtohet sheqer (p.sh., reçeli, marmelata) etj. Këto forma të ruajtjes së ushqimit (temperatura e ulët, zvogëlimi i lagështisë, shtimi i kripës ose i sheqerit) pamundësojnë rritjen e mikroorganizmave. Mikroorganizmat (të tilla si maja, bakteret etj.) janë përgjegjëse për shpërbërjen (prishjen) e ushqimit.

Frigoriferi me gjëra ushqimore

Disa këshilla për ruajtjen e ushqimit

Ushqimet që prisen shpejt, p.sh. mishi, duhet të vendosen menjëherë në frigorifer ose të teren. Ushqimet e tjera si p.sh.: domatja, trangulli, specat e perime të tjera mund të ruhen në frigorifer ose në qilar të pastër dhe të errët, përndryshe mund të kalben shpejt.

Disa perime të tjera, p.sh., patatet, karotat, qepët, hudhrat, mollët, lakrat, panxhari, kalben më vështirë dhe mund të ruhen mirë në **bodrum**. Bodrumet duhet të kenë ventilim, të jenë të errëta, të mos kenë lagështi, si dhe muret dhe dyshemeja të jenë të izoluar. Në bodrum, gjërat ushqimore ruhen nga ngrirja gjatë dimrit dhe, po ashtu, mbahen të freskëta gjatë verës. Kështu parandalohet prishja e tyre.



Qilari me gjëra ushqimore



Bodrumi me gjëra ushqimore

Një mënyrë tjetër e ruajtjes së ushqimit është **tharja** e tij. Kjo mund të bëhet duke përdorur furra tradicionale tharëse, duke tharë në diell ose me tharje duke i varur. Ushqimet që thahen më së miri janë frutat, perimet, mishit dhe suxhuku.



Furrë tharëse



Frutat duke u tharë në diell



Perimet duke u tharë në diell



Tharja e mishit dhe e suxhukut duke i varur

36



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes Diagrami piramidal

Udhëzohen nxënësit të lexohet njësia mësimore. Pas leximit, në fletë A4, vendoset një titull, emërtimet e kategorive të ndara (mënyrat e ruajtjes së ushqimit) dhe detajet e marra gjatë leximit.

Ushqimet duhet të mbrohen nga faktorët e mjedisit të jashtëm dhe ndotësit.				
Bodrumi	Tharja	Turshi	Ngrirja	Këshilla për ruajtjen e ushqimit



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit Shkrim i shpejtë

Kërkohe nga nxënësit që në mënyrë individuale të shkruajnë rreth temës: “Ndikimi i ruajtjes së ushqimit në shëndetin tonë”. Shkrimet lexohen dhe vlerësohen nga shoku apo shoqja e bankës, me komente.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përshkrimin e mënyrave të ruajtjes së ushqimit, në organizimin e informacioneve të marra, si dhe në vlerësimin e ruajtjes së ushqimit për shëndetin e njeriut.

### Detyrë:

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Ruajtja e ushqimit dhe lëndët helmuese

**Rezultatet e të nxënët të temës:**

- Identifikon mënyra të ruajtjes së ushqimit nga faktorët mjedisorë;
- Analizon rëndësinë e të ushqyerit shëndetshëm.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1; II.1; II.5; III.1; V.3.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.3; 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Rëndësia e të ushqyerit shëndetshëm

**Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:**

- Dallon ushqimet e shëndetshme dhe jo të shëndetshme;
- Formulon pyetje dhe përgjigje për pjesën e lexuar;
- Përshkruan ndikimin e ushqimeve në organizimin e njeriut.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimitim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënët**

*Pyetja e ditës*

Nxiten nxënësit të marrin pjesë në diskutim përmes pyetjes:

- Cilat janë përfitimet e një ushqimi të shëndetshëm?

Ja disa përgjigje të mundshme: *Ushqimi i shëndetshëm furnizon trupin me energji, menaxhon peshën trupore më lehtë, të menduarit e shëndetshëm, duke e ushqyer trurin me vitamina etj.*

14 Rëndësia e të ushqyerit shëndetshëm

Që të kemi shëndet të mirë, pos të tjerash, duhet të ushqehemi shëndetshëm. Nëse keni pyetur dikë çka bëni që jeni të shëndetshëm, me siguri e keni dëgjuar këtë këshillë: *Ushqehuni shëndetshëm!*

Një ushqim i shëndetshëm përfshin një larmi pemësh dhe perimesh, drithëra integrale dhe amidon, yndyra të mira dhe proteina. Të hash shëndetshëm do të thotë gjithashtu t'i shmangësh ushqimet me sasi të larta të kripës, sheqerit dhe yndyrës.



Ushqimet e shëndetshme

**Cilat janë përfitimet e një ushqimi të shëndetshëm?**

Të ushqyerit e shëndetshëm ju ndihmon të keni trup dhe mendje të shëndoshë. Po ashtu, kur ushqeheni shëndetshëm, ju do të jeni më pak të rrezikuar nga paraqitja e sëmundjeve të ndryshme, disa prej të cilave po i përmendim:

1. Sëmundjet e zemrës dhe goditja në tru

Sipas të dhënave mjekësore, sëmundjet e zemrës dhe goditja në tru mund të parandalohen duke ndryshuar stilin e jetës, p.sh. përmes ushqimit të shëndetshëm dhe rritjes së aktivitetit fizik. Që t'i evitohet këto sëmundje, duhet shmangur ushqimet e përpunuara dhe të shpejta, sepse ato përmbajnë shumë kripë, yndyra dhe shumë kalori. Këto ndikojnë në rritjen e peshës, rritjen e shtypjes së gjakut dhe mpiksjes e tij. Kështu rritet rreziku i sulmit në zemër dhe goditjes në tru.



Ushqimet që përmbajnë vitaminën E

Frutat dhe perimet kanë pak kalori dhe shumë vitamina. Për shembull, vitamina E parandalon mpiksjes e gjakut e me këtë edhe sulmet në zemër dhe në tru. Ushqimet (dieta) që përmbajnë nivele të larta të vitaminës E janë të paraqitura në figurë.

## 2. Sëmundjet kanceroze

Një dietë jo e shëndetshme, e përbërë nga ushqimet e përpunuara dhe të shpejta, mund të çojë në mbipeshë, e cila mund ta rrisë rrezikun e paraqitjes së kancerit. Ndërsa, dietat e pasura me fruta dhe perime mund të ndihmojnë në mbrojtjen nga kanceri i luktit, zorrës së hollë, zorrës së trashë dhe mëlçisë. Frutat dhe perimet kanë përbërës të caktuar kimikë, të cilët i mbrojnë qelizat nga dëmtimet, si dhe pengojnë zhvillimin e kancerit.



Ushqimet e përpunuara dhe të shpejta

## 3. Diabeti

Parandalimi, por edhe menaxhimi i diabetit (menaxhimi i nivelit të sheqerit në gjak), mund të bëhet përmes marrjes së ushqimit të shëndetshëm dhe aktiviteteve fizike (ecje, vrapim dhe ushtrime të rregullta të lehta). Thelbësore për njerëzit me diabet është të kufizojnë marrjen e ushqimeve me sasi të tepërta të sheqerit dhe të kripës. Gjithashtu, duhen shmangur ushqimet e skuqura dhe yndyrat me prejardhje shtazore.



Ushqimet me sheqer dhe me sasi të madhe kripe

## 4. Eshtrat me dendësi të ulët

Parandalimi dhe menaxhimi i problemeve me eshtrat e dobëta arrihet përmes marrjes së ushqimit (dietës) me kalcium dhe magnez të mjaftueshëm. Këta përbërës janë të nevojshëm për eshtra, por dhe dhëmbë të fortë, kështu mundësojnë parandalimin e dobësisë dhe thyerjes së tyre, si dhe të degjenerimit të nyjave të eshtrave, sidomos në faza më të mëvonshme gjatë jetës.



Ushqimet që janë të pasura me magnez



Ushqimet që janë të pasura me kalcium

1. Cila është këshilla më e duhur për një shëndet të mirë?
2. Çfarë përfshin ushqimi i shëndetshëm?
3. Cilat janë përfitimet nga një ushqim i shëndetshëm?

?

39



## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes Pyetja sjell pyetjen

Hapen librat. Caktohen paragrafët që nxënësit do të lexojnë. Leximi bëhet në dyshe.

**Paragrafi 1** - Sëmundjet e zemrës dhe goditja në tru;

**Paragrafi 2** - Sëmundjet kanceroze;

**Paragrafi 3** - Sëmundja e sheqerit;

**Paragrafi 4** - Eshtrat me dendësi të ulët.

*Nxënësi 1 lexon paragrafin e parë me zë.*

*Nxënësi 2 bën pyetje për këtë paragraf.*

Pas çdo paragrafi, ndërrohen rolet në dyshe. Gjithmonë mundohen të gjejnë një përgjigje më të mirë rreth pyetjes që janë të pajtimit dy nxënësit.



## Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit Mendo/krijo dyshe/shkëmbe

Udhëzohen nxënësit të punohet në dyshe, duke iu përgjigjur pyetjeve të shtruar, si:

- Çfarë përfshin ushqimi i shëndetshëm?
- Shëno 5 këshilla për një shëndet të mirë.

Puna bëhet individuale në fillim, më pas diskutohet me gjithë klasën.

shkëmbehet në dyshe, duke nxjerrë përfundimet më të mira rreth pyetjeve të shtruar. Më pas, diskutohet me gjithë klasën.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në dallimin e ushqimeve të shëndetshme dhe jo të shëndetshme për njeriun, formulimin e pyetjeve dhe përgjigjeve për pjesën e lexuar, si dhe në përshkrimin e ndikimit të ushqimit të shëndetshëm në organizmin e njeriut.

## Detyrë:

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*



ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Ruajtja e ushqimit dhe lëndët helmuese

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 - Identifikon mënyra të ruajtjes së ushqimit nga faktorët mjedisorë;  
 - Analizon rëndësinë e të ushqyerit shëndetshëm.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1; II.1; II.5; III.1; V.3.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.3; 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Rëndësia e të ushqyerit shëndetshëm - Fletore pune

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Identifikon sa më shumë fjalë që lidhen me temën;
- Përshkruan ndikimin e ushqimeve në organizimin e njeriut;
- Argumenton qëndrimin rreth pyetjes së shtruar.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fletë të bardha.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathësi për jetë, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**  
*Alfabeti i njëpasnjëshëm në tryezë të rrumbullakët*

Nxiten nxënësit në grupe të plotësojnë tabelën me sa më shumë terma për secilën shkronjë të alfabetit, që lidhen me temën e dhënë.

A	B	C	Ç	D	Dh
E	Ë	F	G	Gj	H
I	J	K	L	Ll	M
N	Nj	O	P	Q	R
Rr	S	Sh	T	Th	U
V	X	Xh	Y	Z	Zh

1. Në katrorin poshtë, me anë të vizatimit, paraqit ushqimet e shëndetshme.



2. Shkruaj pse duhen shmangur nga shujtat e përditshme ushqimet e mëposhtme.



3. Pse pemët dhe perimet duhet të jenë pjesë e menisë sonë të përditshme?

27

Pas përfundimit, grupet shkëmbejnë termat me gjithë klasën, duke mësuar nëse grupet e tjera kanë arritur të gjejnë lidhje me shkronjat më të vështira.



**Ndërtimi i njohurive:**  
**Përpunimi i përmbajtjes**  
*Diskutimi i drejtuar*

Udhëzohen nxënësit t'i hapin fletoret e punës.

**Ushtrimi 1.** Me anë të vizatimit, paraqit ushqimet e shëndetshme.

**Ushtrimi 2.** Duke u bazuar në ilustrimin e paraqitur, shkruaj pse duhen shmangur ushqimet e paraqitura.

**Ushtrimi 3.** U përgjigjen pyetjeve të shtruara, duke argumentuar se pse frutat dhe perimet duhet të jenë pjesë e menisë sonë të përditshme.

Në fund, diskutohet puna e përfunduar.



**Përforcimi:**  
**Konsolidimi i të nxënit**  
*Rrjeti i diskutimit*

Shënohet pyetja për diskutim:

*A duhet të konsumojmë vetëm ushqime të shëndetshme?*

a) Po. Pse?                      b) Jo. Pse?

Nxënësit lëvizin në klasë për të formuar grupet për *po*, *jo* dhe ata që janë të pavendosur. Grupet shënojnë argumentet e tyre, më pas i paraqesin para të tjerëve, duke i bindur për qëndrimet e tyre. Nëse ka nxënës që ndryshon bindjet e veta, kalon në grupin tjetër.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në identifikimin e sa më shumë termave lidhur me temën, përshkrimin e ndikimit të ushqimeve në organizmin e njeriut, si dhe në argumentimin e qëndrimit rreth temës.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*



ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Ruajtja e ushqimit dhe lëndët helmuese

**Rezultatet e të nxënësve të temës:**

- Identifikon mënyra të ruajtjes së ushqimit nga faktorët mjedisorë;
- Analizon rëndësinë e të ushqyerit shëndetshëm;
- Vlerëson rolin biologjik të të ushqyerit dietal.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** I.1; II.1; II.5; III.1.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.3; 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njëësia mësimore:** Si të mbahet ushqimi pastër dhe si të ushqehemi shëndetshëm?

**Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:**

- Shkruan këshilla për ruajtjen e ushqimit;
- Demonstron paketimin e ushqimeve;
- Argumenton përzgjedhjen e ushqimeve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** letër alumini, plastika kuzhine, enë qelqi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënës**

*Karrigia e autorit*

Nxënësit ndahen në grupe me nga 4 apo 6 anëtarë, varësisht nga numri i nxënësve në klasë. Shënohet në tabelë pyetja: “Si mbahet ushqimi pastër?”. Për 4-6 minuta kohë, shkruajnë se çfarë dinë për pyetjen e shtruar. Pas shkrimit, fletoret shkëmbehen në dyshe, duke plotësuar temën me informacione shtesë, nëse duhet. Më pas, nga një nxënës prej secilit grup ulet në karrigen para nxënësve të tjerë dhe lexon shkrimin. Nxënësit e tjerë kanë mundësi të bëjnë pyetje rreth pjesës së lexuar.

15 Si të mbahet ushqimi pastër dhe si të ushqehemi shëndetshëm?

Gjatë përpunimit dhe përgatitjes së ushqimit, duhet të shmangen veprimet si: kruarja e pjesëve të trupit, prekja e flokëve, e hundës ose e gojës, pirja e duhanit, kollitja ose teshtitja etj. Personat që kanë infeksione të lëkurës, diarje ose kollitje dhe teshtitje nuk duhen lejuar që të përgatisin ushqim. Duhet të keni trup të pastër, t'i prisni thonjtë, dhe t'i pastroni duart para se të filloni të përgatisni ushqim. Para përgatitjes së ushqimit, duhet gjithashtu:

1. Të siguroni ujë të pastër.
2. Të mbahen të pastra enët, gotat dhe gjësendet e tjera, duke i larë rregullisht në ujë të pastër dhe duke i mbajtur të mbuluara.
3. Të gjitha sipërfaqet që vijnë në kontakt me ushqimin duhet të jenë të pastra.
4. Deponimi, përgatitja dhe hapësirat e shërbimit të ushqimit duhet të jenë të pastra dhe pa kafshë shtëpiake, minj dhe insekte (si miza, thnegla) si dhe pa tym cigareje e blözë.
5. Ushqimi duhet të mbulohet dhe të mbahet i ndarë nga helmet.
6. Veshjet e personave që përgatitin ushqimin duhet të ndërrohen çdo ditë dhe të zihen para përdorimit.



Pastrimi i pajisjeve shtëpiake



Mbulimi i ushqimit



Veshjet e pastra

Bisedoni në klasë se pse ata që merren me përgatitjen e ushqimit, duhet të shmangin veprimet si: kuarja e pjesëve të trupit, prekja e flokëve, e hundës ose gojës etj.

1. Pse është e rëndësishme të ushqehemi shëndetshëm?
2. Cilët persona nuk duhet përgatitur ushqime?
3. Cilat janë parimet e përgjithshme për parandalimin e ndotjes së ushqimit?



41



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

*Demonstrim përmes punës praktike*

Hapen librat. Lexohet njësia mësimore. Diskutohen këshillat e shënuara para përgatitjes së ushqimit.

Nxënësit kanë marrë me vete fruta, sende të pjekura, sende të thata, të cilat u janë kërkuar një ditë më parë që t'i sjellin në klasë.

Demonstrohet mbështjellja e ushqimit në mënyrë të sigurt, duke përdorur fletë alumini, enë qelqi apo plastikë të kuzhinës, me qëllimin të ruajtjes së tyre.



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

*Mendo/puno në dyshe/shkëmbe mendime*

Nxënësit mendojnë në mënyrë individuale për një listë të shëndetshme për një ditë të

tërë. Më pas, idetë diskutohen në dyshe dhe shënohet lista e ushqimeve të shëndetshme. Mund të zgjedhin ushqime të ndryshme për tri vakte. Argumentohet pse këto zgjedhje janë të shëndetshme dhe si mund t'i ruajnë ato. Mendimet shkëmbehen me gjithë klasën.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në shkrimin e këshillave për ruajtjen e ushqimit, demonstrimin e paketimit të ushqimit, si dhe argumentimin e përzgjedhjes së listës me ushqime për një ditë.

### Detyrë:

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Ruajtja e ushqimit dhe lëndët helmuese

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Emërton substanca helmuese - duhani, alkooli, kafja etj.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.6; III.1; V.8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.3; 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Lëndët helmuese për organizmin

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Emërton substancat helmuese të organizmit;
- Përshkruan ndikimin e tyre në organizëm;
- Përmbledh informacionet për alkoolin dhe duhanin.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** letër alumini, plastika kuzhine, enë qelqi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimitim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

*Gjetja e fjalës shenjë*

Para nxënësve, lexohen përshkrimet për alkoolin, duhanin dhe kafënë. Pas leximit, kërkohet nga nxënësit të gjejnë fjalën.

- Lëng - pihet dhe kombinohet me pije të tjera, konsumimi i tepërt dëmton organizmin (alkooli);
- Bimë e përpunuar - konsumohet duke e tymosur, dëmton mushkëritë dhe organet e frymëmarrjes (duhani);
- Lëng ngjyrë kafeje - konsumohet nga të rriturit, ka kafeinë që rrit energjinë dhe përqendrimin etj. (kafja).

Diskutohen mendimet e nxënësve deri te gjetja e fjalës së kërkuar.

16 Lëndët helmuese për organizmin

Lëndët helmuese janë substanca kimike, të cilat kur kalojnë në organizëm, shkaktojnë dëme. Lëndët helmuese janë të shumta, më të zakonshmet janë: tymi i duhanit, alkooli, droga etj. Këto lëndë helmuese sot paraqesin një problem të madh për shoqërinë njerëzore. Pse ndodh kjo?



*Pirja e duhanit nga gratë shtatzëna dëmton shëndetin e foshnjës!*

Tymi i **duhanit** përmban mijëra kimikate helmuese, që mund të shkaktojnë sëmundje vdekjeprurëse, përfshirë kancerin e mushkërive dhe sëmundjet e zemrës. Pirja e duhanit dëmton organizmin në të gjitha moshat e veçmas ndikim të lartë ka te të rinjtë dhe gratë shtatzëna.

Kur një grua shtatzënë përdor duhan, fetusi i saj nuk e merr sasinë normale të oksigjenit kështu foshnja nuk arrin peshën dhe rritjen normale dhe ka më shumë gjasa të marrë infeksione në muajt e parë të paslindjes. Jo vetëm pirja e duhanit, por edhe qëndrimi në vendet ku ka tym të duhanit ka pasojë për shëndetin tonë.



*Ndalohet pirja e duhanit!*

**Alkooli** është i dëmshëm për organizmin, sidomos nëse pihet shumë dhe shpesh. Pirja në sasi të madhe e alkoolit dëmton lukthin dhe mëlcinë, deri në atë shkallë sa të sjellë pasojë vdekjeprurëse. Alkooli nga lukthi dhe zorrët kalon në gjak dhe nëpërmjet tij shkon në tru. Kjo përcillet me humbjen e vetëkontrollit, vështirësi në lëvizje e komunikim etj., prandaj rrit mundësitë që të arrihet deri tek aksidentet. Një personi i dehur nuk është në gjendje ta ngasë makinën si duhet në komunikacion nëse ka më shumë se 0.05 % alkool në gjak, prandaj në atë gjendje dënohet në bazë të ligjit.



42



*Ndalohet me ligj vozitja nën ndikimin e alkoolit!*

Drogat, po ashtu, janë shumë të dëmshme për organizmin tonë. Disa nga pasojat e përdorimit të drogave janë: dhembja në formë të ngërçeve, lodhja, çrregullimi emocional, çrregullimi me gjumin, sëmundje të ndryshme etj. Përdorimi i drogave shkakton, po ashtu, varësi të njerëzimit, si dhe çon në vdekje të parakohshme.



Ndalohet me ligj përdorimi i drogave!



**Pirja e kafesë ka efekte pozitive dhe negative.** Kafeina në kafe mund të rrisë aktivitetin e organizmit, veçmas rrit përqendrimin. Nëse konsumohen shumë kafe brenda ditës, ajo ka dhe rreziqet e veta. Kafeina rrit shtypjen e gjakut, shpejton qarkullimin e tij dhe dëmton sistemin nervor.

1. Shkruaj sëmundjet që mund të shkaktohen nga pirja e duhanit.
2. Trego pasojat që mund të ketë foshnja nëse nëna e saj konsumon duhan gjatë shtatzënisë.
3. Cili është efekti i alkoolit nëse merret në sasi të madhe?
4. Trego pasojat e përdorimit të drogave.
5. Shpjego efektet pozitive dhe negative të pirjes së kafesë.

43



## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes Ditari trepjesësh

Kërkohet nga nxënësit t'i hapin librat dhe të lexohet njësia mësimore në mënyrë individuale. Pas leximit, plotësohet tabela me informacionet e marra për alkoolin, duhanin dhe kafeinën. Gjatë leximit të tekstit, udhëzohen të mbajnë shënime.



alkooli



kafeina



duhani



## Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit Pesëvargëshi

Kërkohet nga nxënësit të plotësojnë një pesëvargësh për alkoolin dhe një për duhanin. Ja dy shembuj të mundshëm:

Alkooli  
i lëngët i fortë  
përpunohet pihet tretet  
Alkooli dëmton shëndetin.  
Rakia

Duhani  
i ngurtë i dëmshëm  
digjet konsumohet përpunohet  
Duhani dëmton mushkëritë dhe organet e frymëmarrjes.  
Cigare

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në emërtimin e substancave helmuese të organizmit, përshkrimin e ndikimit të tyre në trupin e njeriut, si dhe përbledhjen e informacioneve me anë të pesëvargëshit për alkoolin dhe duhanin.

### Detyrë:

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Ruajtja e ushqimit dhe lëndët helmuese

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 - Emërton substancat helmuese - duhani, alkooli, kafja etj.  
 - Gjykon për efekte anësore të përdorimit të substancave helmuese.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.6; III.1; V.8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.3; 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Lëndët helmuese për organizmin  
 - Fletore pune

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përshkruan ndikimin e substancave helmuese te njeriu;
- Gjykon efektet anësore të përdorimit të këtyre substancave.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**  
 Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**  
 Diskutim rreth njohurive paraprake

Nxiten nxënësit të diskutojnë përmes pyetjeve të shtruara.

- Cilat sëmundje mund të shkaktohen nga pirja e duhanit?
- Nëse nëna pi duhan gjatë shtatzënisë, cilat janë pasojat?
- Trego pasojat e përdorimit të drogave?
- Kafeina ka vetëm efekt negativ, apo jo?

LËNDËT HELMUESE PËR ORGANIZMIN

1. Në rubrikën A, shkruaj ndikimet e dëmshme në organizëm nga konsumimi i duhanit, ndërsa në B ato nga pirja e alkoolit.

A	B
•	•
•	•
•	•
•	•

2. Pse përdorimi i drogave është i rrezikshëm për shëndetin e njeriut?

3. Nga çfarë rrezikohet një person që pi shumë kafe brenda ditës?

4. Nën secilën shenjë, shkruaj mesazhin që përcjell ajo.



5. Detyrë shtëpie

Për më shumë informacione lidhur me pasojat nga duhani, alkooli dhe drogat, hulumto në internet, nën mbikëqyrjen e prindërve a të mësuesit/ es. Mbjaj shënime në fletoren tënde dhe diskutoji në klasë me nxënësit e tjerë.



1. Në rubrikën A, shkruaj ndikimet e dëmshme në organizëm nga konsumimi i duhanit, ndërsa në B ato nga pirja e alkoolit.

A	B
•	•
•	•
•	•
•	•

2. Pse përdorimi i drogave është i rrezikshëm për shëndetin e njeriut?

---



---

3. Nga çfarë rrezikohet një person që pi shumë kafe brenda ditës?

---



---

4. Nën secilën shenjë, shkruaj mesazhin që përcjell ajo.



#### 5. Detyrë shtëpie

Për më shumë informacione lidhur me pasojat nga duhani, alkooli dhe drogat, hulumto në internet, nën mbikëqyrjen e prindërve a të mësuesit/es. Mbjaj shënime në fletoren tënde dhe diskutoji në klasë me nxënësit e tjerë.

29



#### Ndërtimi i njohurive:

#### Përpunimi i përmbajtjes

#### Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Pas rikujtimit të njësisë mësimore përmes pyetjeve të shtruara, kërkohet nga nxënësit të plotësojnë në fletore pune.

**Ushtrimi 1** - në kolonën A, shëno cilat janë efektet e pirjes së duhanit, kurse në kolonën B shëno se cilat janë efektet e dëmshme të pirjes së alkoolit.

**Ushtrimi 2.** Pse drogat nuk duhet të përdoren asnjëherë?

**Ushtrimi 3.** Cilat janë rreziqet nëse pihet shumë kafe në ditë?

**Ushtrimi 4.** Nën secilën shenjë, shkruaj mesazhin që përcjell ajo.



#### Përforcimi:

#### Konsolidimi i të nxënit

#### Demonstrim përmes lojës me role

Klasa ndahet në grupe. Secili grup krijon një histori, duke përfshirë dy personazhe: një personazh që i ndjek praktikatat e shëndetshme (*ky personazh do të jetë një shembull i sjelljes së shëndetshme, që merr vendime të mira rreth ushqimit, stërvitjes fizike dhe zgjedhjeve*) dhe një tjetër që

has në sfida për shkak të duhanit dhe alkoolit (*ky personazh do të sfidohet shumë pas pirjes së duhanit dhe alkoolit, do të marrë vendime të kundërta që mund të ndikojnë negativisht në shëndetin dhe vendimarrjen e tij*). Gjatë punës në grupe, ofrohet ndihmë dhe këshillë me shkrimin e historive.

Grupet paraqesin historitë e tyre para klasës, në formë të performimit. Pas përfundimit, diskutohet puna e grupeve dhe nxjerrin përfundime për ndërgjegjësimin mbi duhanin dhe alkoolin.

#### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përshkrimin e substancave helmuese në organizmin e njeriut, si dhe në gjykimin e efekteve anësore gjatë përdorimit të tyre.

#### Detyrë:

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Jetojmë dhe rritemi

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Përshkruan zhvillimin dhe ndryshimet e trupit, gjatë moshës së pubertetit.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, II.1, III.3, VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Zhvillimi dhe ndryshimet në trupin e njeriut

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Dallon ndryshimet në trupin e tij/saj;
- Rendit dallimet dhe ngjashmëritë të vajzat dhe të djemtë në këtë fazë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Arsimitim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënët**

*Lapsat në mes*

Udhëzohen nxënësit të ndahen në 3 grupe dhe u shpërndahen fletë të përgatitura me pyetjen:

- Cilat janë ndryshimet trupore që ndodhin në fazën e pubertetit?


Shkruajnë përgjigjen dhe vendosin lapsat në mes të grupit. Kur përfundojnë përgjigjet, zgjidhet një laps dhe pronari i lapsit i përgjigjet pyetjes.

Në fund zbulojnë titullin e njësisë së re.

17 JETOJMË DHE RRITEMI


Zhvillimi dhe ndryshimet në trupin e njeriut

Më herët keni mësuar se njeriu riprodhohet në mënyrë seksuale dhe lind pasardhësit e tij. Në fillim, pasardhësi është i vogël dhe quhet foshnjë, pastaj ai rritet dhe quhet fëmijë. Rreth moshës dhjetëvjeçare, në trupin e fëmijëve, fillojnë të vërehen ndryshime të rëndësishme. Dallimet ndërmjet trupi të femrës dhe atij të mashkullit bëhen gjithnjë e më të dukshme. Koha në të cilën ndodhin këto ndryshime quhet **pubertet**. Në fillim të pubertetit, ndryshimet e para janë në pamjen e trupit, p.sh. zgjatja e trupit, dhe quhen ndryshime fizike. Ndryshimet në pubertet zakonisht fillojnë më herët te femrat sesa te meshkujt.



Ndryshimet nga fëmijë në rritur

Në pubertet, trupi i një fëmije femër zhvillohet dhe ndryshon gradualisht. Në këtë kohë, femrat fillojnë të lëshojnë shtat, ndodhin ndryshimet hormonale, nis rritja e gjinjve dhe dalja e qimeve në pjesët intime. Nder ndryshimet kryesore në pubertetin e femrave është **cikli menstrual**. Me fillimin e tij, një femër konsiderohet e pjekur seksualisht, prandaj kjo etapë kuptohet si një tranzicion drejt moshës madhore. Natyrisht, kjo periudhë jetësore është e veçantë edhe për meshkujt. Në pubertet, trupi i një mashkulli fëmijë ndryshon gradualisht. Meshkujt fillojnë të lëshojnë shtat dhe të kalojnë nëpër ndryshime hormonale. Në këtë kohë zhvillohen gjymtyrët, shpatullat dhe muskujt, nis ndryshimi i zërit dhe dalja e qimeve në pjesët intime.



Ndryshimet nga një fëmijë në e rritur



Ndryshimet në pamjen e trupit të femrat dhe meshkujt përcillen me ndryshime emocionale. Të rinjtë, në këtë fazë të zhvillimit quhen adoleshentë. Sjelljet e vajzave dhe të djemve nisnin të ndryshojnë. Zakonisht, adoleshentët kanë dëshirë ta shprehin personalitetin e tyre me një stil të caktuar të veshjes, të muzikës që dëgjojnë, të folurit etj. Janë më të interesuar për njëri-tjetrin, prandaj i shfaqin syrimet për njohje, simpatitë dhe miqësitë. Këto situata kanë ndikim në gjendjen e tyre emocionale dhe psikologjike. Në këtë periudhë, është jashtëzakonisht e rëndësishme që adoleshentët të kenë sjellje dhe komunikim të sigurtë e të besueshëm me prindërit, mësuesit, shokët etj.



Në pubertet shfaqen simpatitë, miqësitë dhe dashuritë e para



1. Çka është puberteti?
2. Përshkruaj ndryshimet trupore që ndodhin gjatë pubertetit të meshkujt dhe femrat.
3. Trego cilat ndryshime në sjellje vërehen te meshkujt dhe te femrat në pubertet.

45



**Ndërtimi i njohurive:**  
**Përpunimi i përmbajtjes**  
*INSERT*

Udhëzohen nxënësit t'i hapin librat dhe ta lexojnë tekstin. Më pas, të vendosin shenjat në tabelat përkatëse. Pasi mbaron leximi i tekstit, u kërkojmë t'u përgjigjen pyetjeve të drejtuara:

- Cilat njohuri që i kishit më parë janë pohuar në tekst?

- Çfarë informacioni të ri nxore gjatë leximit?

Pas diskutimit të përgjigjeve të pyetjeve, ata do të punojnë në dyshe për t'i renditur informacionet në tabelë.

√	+	-	?



**Përforcimi:**  
**Konsolidimi i të nxënës**  
*Diagrami i Venit*

Udhëzohen nxënësit të ndahen në dyshe. U shpërndajmë fletët dhe u kërkojmë që së bashku të gjejnë dalimet mes djemve dhe vajzave në zhvillimin e tyre trupor.


Zhvillimi dhe ndryshimet

Zhvillimi dhe ndryshimet

në trup te vajzat

Të përbashkëtat

në trup te djemtë



**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në dallimin e ndryshimeve fizike, për pjesëmarrje aktive në veprimtari dhe për renditjen e dallimeve dhe ngjashmërive në këtë fazë.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Njeriu dhe natyra
Shkalla e kurrikulës: 2 Klasa: IV
Tema: Jetojmë dhe rritemi

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përshkruan ndryshimet fizike, emocionale dhe mendore që ndodhin në trup në fazën e pubertetit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, II.4, V.8, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njëësia mësimore: Zhvillimi dhe ndryshimet në trupin e njeriut - Fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Argumenton se puberteti është një fazë e rëndësishme;
Shpreh mendimin për sjelljet emocionale që adoleshentët mund të kenë;
Përshkruan sjelljet e djemve dhe vajzave në këtë fazë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Stuhi mendimesh

Nxënësve u paraqiten 4 fletë të palosura; brenda tyre janë pyetjet e shkruara. Secili grup ka nga një fletë. Kërkohet që të përgjigjen me pak fjalë.

- Çka është puberteti?
Cilat janë ndryshimet fizike që ndodhin në trupin tonë?
Cilat janë ndryshimet në sjellje të djemtë në këtë fazë?
Cilat ndryshime në sjellje vërehen te djemtë dhe te vajzat në pubertetet?
Përgjigjet e shkruara lexohen para nxënësve të tjerë nga përfaqësuesi i grupit.

17 JETOJMË DHE RRITEMI
ZHVILLIMI DHE NDRYSHIMET NË TRUPIN E NJERIUT

1. Trego cilat ndryshime ndodhin në trupin e femrave dhe të meshkujve në fazën e pubertetit.



Four horizontal lines for writing.



Four horizontal lines for writing.

2. Shkruaj për ndryshimet emocionale në fazën e pubertetit (adoleshencës).



Four horizontal lines for writing.

# 17

## JETOJMË DHE RRITEMI

ZHVILLIMI DHE NDRYSHIMET NË TRUPIN E NJERIUT

1. Trego cilat ndryshime ndodhin në trupin e femrave dhe të meshkujve në fazën e pubertetit.



---

---

---

---



---

---

---

---

2. Shkruaj për ndryshimet emocionale në fazën e pubertetit (adoleshencës).



---

---

---

---

30



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

*Diskutim përmes shqyrtimit të përbashkët*

Më pas udhëzohen nxënësit t'i hapin fletoret e punës dhe të shkruajnë për ndryshimet fizike që pësojnë vajzat dhe djemtë në këtë fazë.

---

---

---

---

---

---

---

---

Shkruaj për ndryshimet emocionale në fazën e pubertetit (adoleshencës).



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

*Pesëvargëshi*

Kërkohet nga nxënësit të plotësojnë një pesëvargësh për pubertetin.

Ja një shembull i mundshëm:

Puberteti  
I ndryshëm, i shpejtë  
Ndryshon, shihet, tregohet  
Puberteti i shpejtë të ndryshon shumë.  
Adoleshent

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për punën në grupe, për argumentimin e kësaj faze dhe për përshkrimin e saktë të sjelljeve të adoleshentëve.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---

---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Puberteti dhe përshtatja

**Rezultatet e të nxënësve të temës:**

Përshkruan veprimet që duhet t'i bëjë për të mirëmbajtur dhe menaxhuar trupin e tij/saj në këtë fazë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** III.1; III.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njëësia mësimore:** Mirëmbajtja e trupit

**Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:**

- Tregon njohuritë që ka për fazën e pubertetit;
- Përshkruan rëndësinë e mbajtjes së trupit në fazën e pubertetit;
- Dallon ushqimet e shëndetshme.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, fletore, burime nga interneti.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënësit**

*Brainstorming*

Diskutohet së bashku me nxënësit për pubertetin. Tregojnë për ndryshimet që pëson trupi gjatë kësaj faze. Shikojnë një video me projektor dhe pastaj e komentojnë. Videoja gjendet në vegëzën: <https://www.youtube.com/watch?v=o4LTMV9XqzU>

Mirëmbajtja e trupit është e domosdoshme, sidomos në fazën e pubertetit.

18 PUBERTETI DHE PËRSHTATJA  
Mirëmbajtja e trupit

Higjiena e trupit në pubertet

Për shkak të ndryshimeve hormonale dhe trupore, në pubertet djersiteni më shumë. Prandaj, pastërtia dhe kujdesi për trupin kërkojnë përkushtim të veçantë në këtë fazë. Trupi duhet vazhdimisht të pastrohet me ujë të ngrohtë për ta larguar djersën dhe bakteret e mundshme. Veçmas e domosdoshme është higjiena e pjesëve intime të trupit. Ato duhen pastruar çdo ditë, sepse nëse nuk pastrohen mund të paraqiten infeksione. Në pubertet, si te vajzat ashtu edhe te djemtë, gjëndrat dhjamore të lëkurës prodhojnë më shumë yndyrë se më parë dhe stimulojnë shfaqjen e puçrrave. Në fazën e pubertetit është mirë të hani më pak ëmbëlsira dhe ushqime me yndyrë, si dhe të pini më shumë ujë. Për ta ruajtur shëndetin e lëkurës, fytyra duhet pastruar çdo ditë me sapun dhe preparate kozmetike. Gjithashtu, këshillimi me mjekun është i domosdoshëm. Pas pubertetit, zakonisht puçrrat hiqen.



Mirëmbajtja e pastërtisë së trupit




1. Sqaro si duhet kujdesur për pastërtinë e trupit gjatë fazës së pubertetit.
2. Cilat lloje të ushqimit janë më pak të preferueshme në fazën e pubertetit?
3. Nga kush duhet të merren këshillat për mbajtjen e pastërtisë së trupit në fazën e pubertetit?

## 18 PUBERTETI DHE PËRSHTATJA

### Mirëmbajtja e trupit

#### Higjiena e trupit në pubertet

Për shkak të ndryshimeve hormonale dhe trupore, në pubertet djersiteni më shumë. Prandaj, pastërtia dhe kujdesi për trupin kërkojnë përkushtim të veçantë në këtë fazë. Trupi duhet vazhdimisht të pastrohet me ujë të ngrohtë për ta larguar djersën dhe bakteret e mundshme. Veçmas e domosdoshme është higjiena e pjesëve intime të trupit. Ato duhen pastruar çdo ditë, sepse nëse nuk pastrohen mund të paraqiten infeksione. Në pubertet, si te vajzat ashtu edhe te djemtë, gjëndrat dhjamore të lëkurës prodhojnë më shumë yndyrë se më parë dhe stimulojnë shfaqjen e puçrrave. Në fazën e pubertetit është mirë të hani më pak ëmbëlsira dhe ushqime me yndyrë, si dhe të pini më shumë ujë. Për ta ruajtur shëndetin e lëkurës, fytyra duhet pastruar çdo ditë me sapun dhe preparate kozmetike. Gjithashtu, këshillimi me mjekun është i domosdoshëm. Pas pubertetit, zakonisht puçrrat hiqen.



Mirëmbajtja e pastërtisë së trupit



1. Sqaro si duhet kujdesur për pastërtinë e trupit gjatë fazës së pubertetit.
2. Cilat lloje të ushqimit janë më pak të preferueshme në fazën e pubertetit?
3. Nga kush duhet të merren këshillat për mbajtjen e pastërtisë së trupit në fazën e pubertetit?

46



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes Ditari dypjesësh

Paraqitet njësia mësimore. Nxënësit udhëzohen ta ndajnë fletën e fletores në mes. Në njërën anë do ta shkruajnë paragrafin nga teksti, në anën tjetër do të shënojnë si duhet të mbahet pastër trupi në fazën e pubertetit dhe pse duhet të mbahet pastër.

Pas përfundimit, lexohen disa punime të nxënësve dhe komentojmë së bashku me ta.

Puberteti	Pastërtia



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit Lapsi në mes

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të njësisë mësimore dhe tri pyetjeve.

Nxënësit që përfundojnë pyetjet i lënë lapsat në

mes. Pasi t'i kenë përfunduar, nxënësit që ia marrim lapsin, i lexon përgjigjet e pyetjeve.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë që tregon në njohuritë që ka në fazën e pubertetit, përshkruan ndryshimet në trup, analizon mirëmbajtjen e trupit.

#### Detyrë:

Shkruan për fazën e pubertetit, duke kërkuar në internet ose libra shkencorë.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Puberteti dhe përshtatja

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Përshkruan veprimet që duhet t'i bëjë për të mirëmbajtur dhe menaxhuar trupin e tij/saj në këtë fazë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** III.1; III.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mirëmbajtja e trupit - Fletore pune

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan fazën e pubertetit;
  - Analizon rëndësinë e mbajtjes së higjienës;
  - Dallon ushqimet e shëndetshme.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, fletore, burime nga interneti.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**  
*Parashikim me terma paraprakë*

Shkruhen disa fjalë në tabelë dhe kërkohet nga nxënësit të shkruajnë një tekst në të cilin renditin fjalët dhe argumentojnë renditjen e tyre: moshë, puberteti, ndryshimet, mirëmbajtja e higjienës personale, ushqimet.

Lexohen shkrimet e disa nxënësve. Shkruhen në tabelë disa prej tyre.

PUBERTETI DHE PËRSHTATJA

MIRËMBAJTJA E TRUPIT



1. Pse i duhet kushtuar rëndësi të veçantë higjienës së trupit në fazën e pubertetit?

---



---



---

2. Pse duhen shmangur ushqimet me shumë yndyrë dhe sheqer në fazën e pubertetit?

---



---




---



## PUBERTETI DHE PËRSHTATJA

MIRËMBAJTJA E TRUPIT

18



1. Pse i duhet kushtuar rëndësi të veçantë higjienës së trupit në fazën e pubertetit?

---

---

---

---

2. Pse duhen shmangur ushqimet me shumë yndyra dhe sheqer në fazën e pubertetit?

---

---

---

---



31



**Ndërtimi i njohurive:**

**Përpunimi i përmbytjes**

*Të nxënësit në bashkëpunim*

Ritregohet njësia mësimore nga disa prej nxënësve. Pastaj nxënësit ndahen në tri grupe:

Grupi I. Pse i duhet kushtuar rëndësi të veçantë higjienës së trupit në fazën e pubertetit?

Grupi II. Pse duhen shmangur ushqimet me shumë yndyra dhe sheqer në fazën e pubertetit?

Grupi III. Nëse kemi shqetësime në fazën e pubertetit, ku dhe kujt duhet t'i drejtohemi? Pastaj plotësohen pyetjet e librit.



**Përforcimi:**

**Konsolidimi i të nxënit**

*Ditari dypjesësh*

Kërkohet nga nxënësit që fletën e fletores ta ndajnë në dy shtylla me një vijë në mes, në anën e majtë shkruajmë fjalinë e urtë, ndërsa në anën e djathtë shkruhet komenti i fjalës së urtë.

Pastërtia është gjysma e shëndetit.

Komenti

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë në përshkrimin e fazës së pubertetit, në analizimin e mbajtjes së pastërtisë, në dallimin e ushqimeve të shëndetshme.

**Detyrë:**

Shkruajnë për mbajtjen e pastërtisë.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---

---



ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Bashkëveprimet dhe lëvizjet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Përkufizon masën, vëllimin dhe dendësinë dhe dallon trupat e ngurtë, lëndët e lëngëta dhe lëndët e gazta sipas vetive të tyre.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** I.1; II.1, II.6; II.8; III.4; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.4; 1.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përkufizimi i masës, i vëllimit dhe i dendësisë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përkufizon masën, vëllimin dhe dendësinë;
- Tregon rëndësinë e masës;
- Bën dallimin midis vëllimit dhe dendësisë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

*Stuhi mendimesh (brainstorming)*

Shkruhet në tabelë tema “Masa, vëllimi dhe dendësia”. Nxënësit japin mendime rreth masës, vëllimit dhe dendësisë, duke sjellë edhe shembuj nga vëzhgimi i tyre që kanë bërë më parë. Mendimet shkruhen në tabelë, pa bërë komente për to.



19 BASHKËVEPRIMET DHE LËVIZJET  
Përkufizimi i masës, i vëllimit dhe i dendësisë

Çdo lëndë, ka masë, vëllim dhe dendësi të caktuar.

**Masa**

Masa është sasia e materies (lëndës) në një objekt. Sa më shumë të ketë masë një trup, ai peshon më shumë dhe anasjelltas. Masa e trupave matet me peshore dhe zakonisht shprehet me gramë ose kilogramë.



Peshorja

**Vëllimi**

Vëllimi është hapësira që zë një objekt. Matja e vëllimit përcaktohet me mililitër apo litër (ml apo l) dhe centimetër ose metër kub (cm<sup>3</sup> apo m<sup>3</sup>).

Matja e vëllimit përcaktohet duke matur gjatësinë, gjerësinë dhe lartësinë e një trupi, bie fjala, të kubit. Për shembull, nëse e matim vëllimin e një dhome ose kubi, duhet ta matim gjatësinë, gjerësinë dhe lartësinë e dhomës ose kubit, dhe t'i shumëzojmë ato ndërmjet vete. Shembull:  $gjatësia \times gjerësia \times lartësia = rezultati$  (centimetër kub - cm<sup>3</sup> ose metër kub - m<sup>3</sup>).



Matja e vëllimit të një kubi

**Eksperiment:** mereni një kub dhe, me ndihmën e mësuesit/es, bëjeni matjen e tij me anë të vizores. Në fund, përcaktoni vëllimin e kubit në centimetër kub (cm<sup>3</sup>).

## Dendësia

Dendësia është masa e materies në një vëllim të caktuar. D.m.th., sa më shumë të ketë masë në një hapësirë, aq më i madh është densiteti dhe anasjelltas. Për të gjetur dendësinë, së pari duhet të gjejmë masën dhe vëllimin e objektit.

Dendësia = masa (kg)/vëllimi ( $m^3$ )

Njësia me të cilën matet dendësia është  $kg/m^3$ , por mund të jetë edhe më e vogël, p.sh.,  $g/cm^3$ . Nëse kemi dy objekte me vëllim të njëjtë, por të përbërë me materiale të ndryshme (p.sh. dru dhe hekuri), ata do të kenë densitete të ndryshme. Hekuri ka densitet më të lartë (materia është shumë e dendur) krahasuar me drurin, tek i cili materia është më pak e dendur. Prandaj vëllimi i njëjtë i hekurit peshon më shumë se i njëjti vëllim i drurit.

Shikoni figurën poshtë dhe, bashkë me mësuesin/en e shokët në klasë, e klasës përcaktoni cili nga katrorët poshtë ka densitet më të lartë dhe sqaroni pse.


---

---

---

---

---



Dendësia e katrorëve

1. Çfarë janë masa, vëllimi dhe dendësia e një objekti? Krahasoju ata.
2. Si përcaktohet masa, vëllimi dhe dendësia e një objekti?
3. Shpjego pse druri dhe hekuri me vëllim të njëjtë kanë peshë të ndryshme.



49



## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes Të nxënësit në bashkëpunim

Në këtë temë, do të shohim se çfarë janë masa, vëllimi dhe dendësia. Ndahet klasa në 4 grupe me nga 4 nxënës. Në çdo grup emërtohen nxënësit me shkronjat: A, B, C, D.

Kërkohet nga nxënësit t'i hapin librat dhe pyetjet e përgatitura do të ndihmojnë nxënësit që ta kuptojnë tekstin.

**Nxënësi A:** 1. Çfarë është masa?

2. Me çka matet masa e trupave?

**Nxënësi B:** 1. Kush e përcakton matjen e vëllimit?

2. Si matet vëllimi i kubit?

**Nxënësi C:** 1. Çfarë është dendësia?

2. Çfarë duhet të bëjmë për ta gjetur dendësinë?

**Nxënësi D:** 1. Shpjego pse druri dhe hekuri me vëllim të njëjtë kanë peshë të ndryshme.

Më pas, u tregohet grupeve se ku do të përquendrohen (nxënësit me shkronjën A në grupin A e kështu me radhë). Pas marrjes së informacioneve, ata kthehen në grupet e mëparshme për të diskutuar rreth informacioneve të marra.



## Përforsimi: Konsolidimi i të nxënit Mendo/krijo në dyshe/diskuto

Kërkohet nga nxënësit të punojnë në dyshe, ku përmbledhin informacionet e marra më parë. Nxënësi me numër 1 për 1 minutë i shpjegon shokut për pjesën e pëlqyer, ku ndërkohë ata ndërrojnë rolet. Pastaj, nxënësi numër dy do t'i tregojë shokut sende interesante që ka mësuar, por njëherazi duke mos i përsëritur ato që ka thënë shoku. Vazhdohet kështu (për kohë të caktuar që caktohet nga mësuesi), ku dhe ata do të pyesin edhe për sendet e paqarta.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari, përkufizimin e masës, vëllimit dhe dendësisë, dallimin midis vëllimit dhe dendësisë, si dhe për punën në grupe.

## Detyrë:

U përgjigjen pyetjeve në faqen 49.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---

---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Bashkëveprimet dhe lëvizjet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Përkufizon masën, vëllimin dhe dendësinë dhe dallon trupat e ngurtë, lëndët e lëngëta dhe lëndët e gazta sipas vetive të tyre.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.1; II.6; III.1; V,8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.4; 1.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përkufizimi i masës, i vëllimit dhe i dendësisë - Fletore pune

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përkufizon masën e trupave;
- Përcakton dendësinë e trupave;
- Shpjegon mënyrën e përcaktimit të vëllimit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** kubi, pako e qumështit, mprehëse, copë druri, vizore.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Matematikë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënësit**

*Diskutim për njohuritë paraprake*

Nxënësve u shpërndahen fletët e punës dhe në qendër shkruhet koncepti *masë*. Ata plotësojnë konceptin me njohuritë e marra nga mësimi paraprak. Më pas, fjalët e shkruara do të lexohen. Ata pyeten rreth fjalëve të shkruara, në mënyrë që të qartësohet çdo gjë dhe, gjatë dhënies së përgjigjeve, bisedohet dhe zbulohet ajo se çfarë kemi mbajtur në mend rreth temës së lartpërmendur.

BASHKËVEPRIMET DHE LËVIZJET

PËRKUFIZIMI I MASËS, I VËLLIMIT DHE I DENDËSISË

**Eksperiment:** përcakto peshën e një molle dhe paraqite me njësinë matëse përkatëse.

Mjetet dhe materiali i duhur: **peshorja, një mollë.**



**Eksperiment:** përcakto vëllimin e një pakoje të qumështit dhe paraqite me njësinë matëse përkatëse.

Mjetet dhe materiali i duhur: **metri apo vizorja, pakoja e qumështit.**



**Eksperiment:** bazuar në figurën poshtë, trego se a ka densitet më të lartë një trup nga druri a një trup nga hekuri, nëse të dy këta trupa kanë vëllim të njëjtë. Shëno njësinë matëse që përdoret për matjen e densitetit.



## BASHKËVEPRIMET DHE LËVIZJET

PËRKUFIZIMI I MASËS, I VËLLIMIT DHE I DENDËSISË

19

**Eksperiment:** përcakto peshën e një molle dhe paraqite me njësinë matëse përkatëse.

Mjetet dhe materiali i duhur: **peshorja, një mollë.**



**Eksperiment:** përcakto vëllimin e një pakoje të qumështit dhe paraqite me njësinë matëse përkatëse.

Mjetet dhe materiali i duhur: **metri apo vizorja, pakoja e qumështit.**



**Eksperiment:** bazuar në figurën poshtë, trego se a ka densitet më të lartë një trup nga druri a një trup nga hekuri, nëse të dy këta trupa kanë vëllim të njëjtë. Shëno njësinë matëse që përdoret për matjen e densitetit.



33



**Ndërtimi i njohurive:**

**Përpunimi i përmbajtjes**

*Demonstrim përmes punës praktike*

Kërkohet nga nxënësit të ndahen në 3 grupe.

**Grupi 1.** Marrin kubin dhe me ndihmën e vizores do të bëjnë matjen e tij, ku do të masin gjatësinë, gjerësinë dhe lartësinë e tij.

**Grupi 2.** Marrin pakon e qumështit dhe me vizore do të bëjnë matjen e gjatësisë, gjerësisë dhe lartësisë.

Pas matjes, të dyja grupet do të përcaktojnë vëllimet e objekteve në centimetër kub ( $\text{cm}^3$ ). *Shembull:* gjatësia  $\times$  gjerësia  $\times$  lartësia = rezultati (centimetër kub -  $\text{cm}^3$  ose metër kub -  $\text{m}^3$ ).

**Grupi 3.** Marrim një vizore dhe e vendosim mbi një kub të vogël. Në njërën anë vendosim mprehesen e hekurt dhe në anën tjetër vendosim një copë druri. Të dyja kanë vëllim të njëjtë.

Kërkohet nga nxënësit të tregojnë se a ka densitet më të lartë një trup nga druri a një trup nga hekuri.

Dendësia = masa (kg)/vëllimi ( $\text{m}^3$ )



**Përforcimi:**

**Konsolidimi i të nxënit**

*Shkrim i lirë*

Kërkohet nga nxënësit që shkurtimisht me pak fjali të shkruajnë në fletore atë se çfarë kanë mësuar, vepruar dhe kuptuar nga masa, vëllimi dhe dendësia e trupave.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari, për punën në grupe, për shpjegimin dhe mënyrën e përcaktimit të masës, vëllimit dhe dendësisë.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrezultatin e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Bashkëveprimet dhe lëvizjet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Përkufizon masën, vëllimin dhe dendësinë dhe dallon trupat e ngurtë, lëndët e lëngëta dhe lëndët e gazta sipas vetive të tyre.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** I.1; I.3; II.1; II.6; III.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vetitë e trupave

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Klasifikon trupat sipas vetive të tyre;
- Identifikon trupat në tri gjendje agregate;
- Shpjegon gjendjen agregate të trupave.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** foto.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimitim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënësit**

*Diskutim për njohuritë paraprake*

Nxënësit emërtojnë tri gjendjet e lëndës: e ngurtë, e lëngët, e gaztë.

Drejtohen pyetja: *Ç'kuptoni me gjendje agregate të lëndës?* Nxënësit japin mendimet e tyre.

Më pas marrim një shishe me ujë dhe e hedhim ujin në gotë. *Çfarë mendoni se po ndodh me ujin?*

Lënda në gjendje të lëngët merr formën e enës në të cilën ndodhet. *A ndodh kjo edhe me trupat e tjerë të ngurtë? Pse?* Nxënësit japin paraprakisht mendime.



20 Vetitë e trupave

Dallimi mes trupave të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë

Tashmë e dini që materien mund ta gjejmë në tri gjendje: të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë. Kemi marrë shembullin e ujit, i cili mund ta ketë njëherë nga cilado gjendje agregate. Kjo varet nga temperatura. Në temperaturë të ulët (nën 0 °C), uji është i ngurtë, kur temperatura është ndërmjet 0 °C dhe 100 °C, ai është i lëngët, ndërsa në temperatura mbi 100 °C uji është gaz (avull). Gjendja agregate e ujit shpreh dhe dendësinë e tij. Uji është më i dendur në gjendje të lëngshme, kurse kur ngrihet, ka dendësi më të vogël (prandaj akulli noton mbi ujë), siç tregohet në figurë. Ndërsa, në formë të avullit ka dendësi edhe më të vogël.



Akulli noton mbi ujë.



Trupat me gjendje të ndryshme agregate, siç tregohet në figurën më lart, kanë dhe këto karakteristika:

- Trupat e ngurtë kanë formë dhe vëllim të caktuar.
- Trupat e lëngët kanë vëllim të caktuar, por marrin formën e enës.
- Gazet nuk kanë formë ose vëllim të caktuar.



1. Nga kush varen gjendjet agregate të ujit?
2. Në cilën gjendje agregate është uji më i dendur?
3. Krahaso trupat e ngurtë, të lëngët dhe të gaztë.

50


## 20 Vetitë e trupave

### Dallimi mes trupave të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë

Tashmë e dini që materien mund ta gjejmë në tri gjendje: të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë. Kemi marrë shembullin e ujit, i cili mund ta ketë njërin nga cilado gjendje agregate. Kjo varet nga temperatura. Në temperaturë të ulët (nën 0 °C), uji është i ngurtë, kur temperatura është ndërmjet 0 °C dhe 100 °C, ai është i lëngët, ndërsa në temperatura mbi 100 °C uji është gaz (avull). Gjendja agregate e ujit shpreh dhe dendësinë e tij. Uji është më i dendur në gjendje të lëngshme, kurse kur ngrihet, ka dendësi më të vogël (prandaj akulli noton mbi ujë), siç tregohet në figurë. Ndërsa, në formë të avullit ka dendësi edhe më të vogël.



Akulli noton mbi ujë.



Trupat me gjendje të ndryshme agregate, siç tregohet në figurën më lart, kanë dhe këto karakteristika:

- Trupat e ngurtë kanë formë dhe vëllim të caktuar.
- Trupat e lëngët kanë vëllim të caktuar, por marrin formën e enës.
- Gazet nuk kanë formë ose vëllim të caktuar.

?

1. Nga kush varen gjendjet agregate të ujit?
2. Në cilën gjendje agregate është uji më i dendur?
3. Krahaso trupat e ngurtë, të lëngët dhe të gaztë.

50



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes


*Të nxënësit me këmbime (grupet e ekspertëve)*

Kërkohet nga nxënësit të punojnë në tri grupe. Ata do të identifikojnë trupa që janë në gjendje të lëngët, të gaztë dhe të ngurtë.

**Grupi 1** – trupat e ngurtë kanë formë dhe vëllim të caktuar.

**Grupi 2** – trupat në gjendje të gaztë nuk kanë formë ose vëllim të caktuar.

**Grupi 3** – trupat në gjendje të lëngët kanë vëllim të caktuar, por marrin formën e enës.



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

*Turi i galerisë*

Pasi grupet përfundojnë punën e tyre, ata paraqesin para nxënësve të klasës atë, ku shpjeg-

ohen trupat që janë në gjendje të lëngët, të gaztë dhe të ngurtë.

Secili grup vlerësohet nga grupet e tjera.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari për identifikimin e lëndëve në tri gjendjet, për shpjegimin dhe klasifikimin e tyre sipas gjendjes.

### Detyrë:

Shkruani dallimin ndërmjet trupave të ngurtë dhe trupave të gaztë.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*



ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Bashkëveprimet dhe lëvizjet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Dallon lloje të ndryshme të rrugëve dhe të lëvizjeve të trupave.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1, II.1, III.2, VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.5, 2.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Lëvizjet e trupave

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përshkruan funksionin e lëvizjes së trupave;
- Identifikon llojet e lëvizjes së trupave.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektor.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Matematikë, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënët**

*Dil rrotull - fol rrotull*

Shkruhet në tabelë fjala *lëvizje*. Kërkohet prej nxënësve të shkruajnë fjali në lidhje me të. Kështu, ata do të bëjnë rrethin, ku do të kenë emërtime të tilla si: lëvizje drejtvizore, lëvizje rrethore, lëvizje periodike, lëvizje rrotulluese.

Nga të gjitha këto emërtime bëhet renditja në tabelë. Nxënësit, duke lëvizur nëpër klasë, mendojnë për pak çaste, në momentin që bëhet përplasja e pëllëmbëve të duarve, ata hyjnë në rreth duke shpjeguar njërin nga emërtimet e cekura më lart, kthehet në vend dhe kështu vazhdon me radhë.

21 Lëvizjet e trupave

Lëvizja është ndryshimi i pozitës së një objekti në raport me një objekt tjetër (që nuk lëviz). Psh.: kur një person është ulur në një ulëse (pushimore) në një park, atëherë themi se trupi është në qetësi dhe nuk është në lëvizje. Ndërsa kur ai fillon të ecë, atëherë gjendja e tij ndryshon dhe themi se trupi është në lëvizje.



Trupi në qetësi dhe ai në lëvizje

Trupat në natyrë bëjnë lëvizje të ndryshme. Kur trupi lëviz në një vijë të drejtë (shembull: ecja e ushtarëve në rresht, hedhja e topit poshtë-lart, vetura në rrugë të drejtë, treni në binarë etj.), quhet **lëvizje drejtvizore**.



Treni në binarë




Vetura në rrugë të drejtë



Topi poshtë-lart


**Lëvizje rrethore** është kur një objekt fshihet lëviz rreth një pike të caktuar dhe largësia e tij nga qendra mbetet e njëjtë. (Shembull: vetura në rreth, akrepat e orës, freskuesja e ajrit me flutur etj.)



Vetura në rreth




Akrepat e orës




Freskuesja e ajrit me flutur



Një lëvizje që përsëritet pas një periudhe të caktuar kohore quhet **lëvizje periodike**. (Shembull: ora, luhatësja, ushtrimet me litar etj.)



Luhatësja



Ushtrimet me litar

Nëse shtyni një top futboll në një fushë të gjelbër, ju mund të shihni se ai në të njëjtën kohë bën **lëvizje drejtore** dhe **lëvizje rrethore**. Kjo quhet **lëvizje rrotulluese**.



Topi në fushë



1. Çfarë lëvizje të trupave kemi?
2. Krahaso llojet e lëvizjeve të trupave.
3. Trego një shembull të lëvizjes rrotulluese.

52



## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

*Sistemi ndërveprues i shënimeve*

Theksohet se lëvizja është ndryshimi i pozitës së një objekti në raport me një objekt tjetër. Trupat në natyrë bëjnë lëvizje të ndryshme. Kërkoet nga nxënësit të lexojnë tekstin dhe të vendosin shenjat, pasi mbaron leximi i tekstit me pyetjet e drejtuara:

- Cilat njohuri që i kishit më parë janë pohuar në tekst?

- Çfarë informacioni të ri nxorët gjatë leximit?

Pas diskutimit të përgjigjeve të pyetjeve, ata do të punojnë në dyshe për t'i renditur informacionet në tabelë.



## Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

*Shkrim i shpejtë*

Shfaqet një video para nxënësve, ku flitet për lëvizjet e trupave dhe mënyrën e lëvizjes së tyre. Videoja gjendet në vegëzën: <https://www.youtube.com/watch?v=nIvePkFzaMw>

Pas shikimit të videos, udhëzohen nxënësit për

një kohë të shkurtër (5 min.) t'i përgjigjen me shkrim pyetjes: - Si mund ta përshkruash mënyrën se si trupat lëvizin?.

Në përfundim të shkrimit, disa nxënës do të lexojnë atë që kanë shkruar dhe nxiten diskutime të shkurt-ra rreth saj.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive, për përshkrimin e saktë të lëvizjes së trupave, si dhe për identifikimin e tyre.

### Detyrë:

Përgjigjiuni pyetjeve, faqe 52.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Bashkëveprimet dhe lëvizjet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Përkufizon masën, vëllimin dhe dendësinë dhe dallon trupat e ngurtë, lëndët e lëngëta dhe lëndët e gazta sipas vetive të tyre.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** II.1, II.8, III.4,V.8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vetitë dhe lëvizjet e trupave - Fletore pune

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Shpjegon ndikimin e lëvizjes së trupave;
- Plotëson fjalitë me fjalë a grupe fjalësh;
- Tregon rëndësinë e vetive të trupave.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Matematikë, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**  
*Përsërisim përmes lojës*

Klasa do të ndahet në 4 grupe të mëdha.

**Grupi I.** Në mënyrë individuale, do të shkruajë në fletë të bardhë 2 mohime dhe 1 pohim në lidhje me vetitë e trupave.

**Grupi II.** Në mënyrë individuale, do të shkruajë në fletë të bardhë 2 mohime dhe 1 pohim në lidhje me lëvizjet e trupave.


**Grupi III.** Në mënyrë individuale, do të shkruajë në fletë të bardhë 2 mohime dhe 1 pohim në lidhje me lëvizjet drejtvizore dhe periodike.

**Grupi IV.** Në mënyrë individuale, do të shkruajë në fletë të bardhë 2 mohime dhe 1 pohim në lidhje me lëvizjet rrethore dhe rrotulluese.

Nxënësit do të lexojnë çfarë kanë shkruar. Ata do të diskutojnë për të gjetur se cila nga fjalitë është pohim.

20 VETITË E TRUPAVE

1. Shihni dallimin në mes të trupave të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë.



Duke u bazuar në tri figurat që patë më lart, plotëso duke shkruar gjendjen agragate për secilin shpjegim:

- A) Trupat nuk kanë vëllim, por as formë të caktuar \_\_\_\_\_
- B) Trupat kanë vëllim të caktuar, por formën e marrin nga ena \_\_\_\_\_
- C) Trupat kanë vëllim dhe formë të caktuar \_\_\_\_\_

## LËVIZJET E TRUPAVE

21


1. Përcakto kur një trup është në qetësi e kur në lëvizje.

---



---



2. Lidh me një vijë figurat në të majtë dhe në të djathtë me shprehjet përkatëse në kuti.



Lëvizje rrethore

Lëvizje drejtvizore

Lëvizje periodike




35



## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes Harta e konceptit

Nxënësit, të ndarë në grupe, do të punojnë hartën e konceptit për vetitë e trupave (grupi I, II) dhe për lëvizjet e trupave (grupi III, IV).



## Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët Mendo - plotëso

1. Kërkohet nga nxënësit të plotësojnë në fletoren e punës ushtrimet për këto njësi.

Duke u bazuar në këto tri figura, zgjidh detyrën e mëposhtme.

Detyrë: çfarë gjendje agregate kanë trupat nga

përshkrimi i bërë?

A) Trupat nuk kanë një vëllim, por as formë të caktuar. \_\_\_\_\_

B) Trupat kanë një vëllim të caktuar, por formën e marrin nga ena. \_\_\_\_\_

C) Trupat kanë vëllim dhe formë të caktuar. \_\_\_\_\_

2. Përcakto kur një trup është në qetësi e kur në lëvizje. \_\_\_\_\_

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari, në shpjegimin e në zgjerimin e fjalëve, si dhe për përshkrimin e rëndësisë së vetive të trupave.

Detyrë:

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Bashkëveprimet dhe lëvizjet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Përshkruan mënyrat e krijimit të valëve dhe shembuj të paraqitjes së tyre në natyrë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1; II.1; II.3; III.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Valët dhe mënyra e krijimit të tyre

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Identifikon tingujt e ndryshëm;
- Tregon si prodhohet tingulli;
- Strukturon të dhënat në tabelë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** shishe etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Edukatë muzikore.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

*Di*

Nxënësve u drejtohen pyetje dhe në kolonën *Di* do të shkruajnë njohuritë që kanë për valën dhe tingullin.


Si krijohen valët?

Kush bën tinguj?


DI	DUA TË DI	MËSOVA
Objektet e ndryshme krijojnë zë, p.sh.: instrumentet e ndryshme muzikore, kafshët e ndryshme, motori dhe buria e makinave etj. Valët përhapen në forma të ndryshme.		

22 Valët dhe mënyra e krijimit të tyre

Në natyrë, kemi **valë** të ndryshme, p.sh. valët e ujit, valët e zërit, valët e dritës etj. Ato krijohen në mënyra të ndryshme. Valët në ujë zakonisht krijohen nga era. Ato krijohen nga fërkimi midis erës dhe ujit sipërfaqësor. Derisa era fryn në sipërfaqen e një oqeani, deti ose liqeni, vazhdimisht krijohen një varg valësh.



Valët e ujit




Krijimi i tingujve

Kur një objekt dridhet, krijohet **tingulli (zëri)**. Vala e zërit udhëton nëpër mjedisë të tilla si ajër, ujë ose lëndë të ngurtë. Kur vala e zërit arrin në vesh, ne mund ta ndiejmë formën e tingullit. Objektet e ndryshme krijojnë zë p.sh.: instrumentet e ndryshme muzikore, kafshët e ndryshme, motori dhe buria e makinave etj. Edhe ju krijoni zë kur flisni ose këndon. Në figurë, mund të shihni shembullin e krijimit të valëve të zërit me shishe - këtë mund ta bëni edhe ju në klasë. Nëse shisheet i mbushni me ujë në nivele të ndryshme, ato do të krijojnë valë të ndryshme zëri.


1. Dallo valët e ndryshme në natyrë.
2. Si krijohen valët në ujë?
3. Trego kur krijohet tingulli.
4. Në cilat mjedisë apo lëndë përhapet zëri?

## 22 Valët dhe mënyra e krijimit të tyre

Në natyrë, kemi **valë** të ndryshme, p.sh. valët e ujit, valët e zërit, valët e dritës etj. Ato krijohen në mënyra të ndryshme. Valët në ujë zakonisht krijohen nga era. Ato krijohen nga fërkimi midis erës dhe ujit sipërfaqësor. Derisa era fryn në sipërfaqen e një oqeani, deti ose liqeni, vazhdimisht krijohen një varg valësh.



Valët e ujit



Krijimi i tingujve

Kur një objekt dridhet, krijohet **tingulli (zëri)**. Vala e zërit udhëton nëpër mjediset të tilla si ajër, ujë ose lëndë të ngurtë. Kur vala e zërit arrin në vesh, ne mund ta ndiejmë formën e tingullit. Objektet e ndryshme krijojnë zë p.sh.: instrumentet e ndryshme muzikore, kafshët e ndryshme, motori dhe buria e makinave etj. Edhe ju krijoni zë kur flisni ose këndon. Në figurë, mund të shihni shembullin e krijimit të valëve të zërit me shishe - këtë mund ta bëni edhe ju në klasë. Nëse shisheet i mbushni me ujë në nivele të ndryshme, ato do të krijojnë valë të ndryshme zëri.

1. Dallo valët e ndryshme në natyrë.
2. Si krijohen valët në ujë?
3. Trego kur krijohet tingulli.
4. Në cilat mjediset apo lëndë përhapet zëri?



53



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes Dua të di

Kërkohet nga nxënësit t'i hapin librat dhe të fillojnë të ndërtojnë pyetje për gjëra që dëshirojnë t'i dinë dhe ato pyetje t'i vendosin te kolona *Dua të di*.

Ja disa pyetje të mundshme:


- Si krijohen valët në ujë?
- Si krijohet tingulli?
- Ku udhëtojnë valët e zërit?

DI	DUA TË DI	MËSOVA
	Si krijohen valët në ujë? Si krijohet tingulli? Ku udhëtojnë valët e zërit?	



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit Mendo - plotëso

Në bankën para nxënësve, vendosim dy shishe të mbushura me ujë në nivele të ndryshme. Nëse i fryjmë, ato krijojnë valë të ndryshme zëri. Më pas, secili nga ta, na jep nga një mendim mbi atë se çfarë po sheh dhe çfarë po dëgjon. Përgjigjet e marra i shkruajnë te kolona *Mësova*.



### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive, strukturimin e saktë të informacioneve në tabelë, si dhe për shpjegimin e rëndësisë që ka zëri.

### Detyrë:

Përgjigjiuni pyetjeve të mësimin në faqe 53.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Bashkëveprimet dhe lëvizjet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Përshkruan mënyrat e krijimit të valëve dhe shembuj të paraqitjes së tyre në natyrë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1; II.8; III.4; V.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Valët dhe mënyra e krijimit të tyre - Fletore pune

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Identifikon tinguj të ndryshëm;
- Analizon rezultatet e punës praktike, duke nxjerrë përfundime;
- Plotëson fjalitë me fjalë a grupe fjalësh.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** gota plastike, spango.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënët**

*Mendo - plotëso*

Kërkohet nga nxënësit të plotësojnë në fletoren e punës ushtrimet për këtë njësi.

1. Duke u bazuar në librin bazë, plotëso fjalinë poshtë:

a) Valët në ujë zakonisht krijohen nga \_\_\_\_\_

2. Krijimin e valëve të zërit mund ta bëni dhe ju përmes një eksperimenti të thjeshtë. Gjithë ç'ju nevojitet është një shishe qelqi. Ecuria e eksperimentit: merr një shishe qelqi boshe dhe fryj me gojë në grykën e hapur të saj. Në këtë rast, ju keni krijuar valë të zërit.

Çfarë mësuat nga ky eksperiment i thjeshtë? \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

22

VALËT DHE MËNYRA E KRIJIMIT TË TYRE

1. Duke u bazuar në librin bazë, plotëso fjalinë poshtë:

a) Valët në ujë zakonisht krijohen nga \_\_\_\_\_

2. Krijimin e valëve të zërit mund ta bëni dhe ju përmes një eksperimenti të thjeshtë.

Gjithë ç'ju nevojitet është një shishe qelqi.

**Ecuria e eksperimentit:** merr një shishe qelqi boshe dhe fryj me gojë në grykën e hapur të saj. Në këtë rast ju keni krijuar valë të zërit.

Çfarë mësuat nga ky eksperiment i thjeshtë?

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_





1. Duke u bazuar në librin bazë, plotëso fjalinë poshtë:

a) Valët në ujë zakonisht krijohen nga \_\_\_\_\_

2. Krijimin e valëve të zërit mund ta bëni dhe ju përmes një **eksperimenti** të thjeshtë.

Gjithë ç'ju nevojitet është një **shishe qelqi**.

**Ecuria e eksperimentit:** merr një shishe qelqi boshe dhe fryj me gojë në grykën e hapur të saj. Në këtë rast ju keni krijuar valë të zërit.

Cfarë mësuar nga ky eksperiment i thjeshtë?

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

*Demonstrim përmes punës praktike*

Kjo punë praktike do të bëhet me qëllim që nxënësit të mësojnë që zëri përhapet jo vetëm në ajër, por edhe tek trupat e ngurtë.

Të ndarë në dyshe, kërkojmë nga nxënësit të ndërtojnë një telefon. Para tyre vendosim nga dy gota plastike dhe një fije spango. Gotave do t'iu bëjmë nga një vrimë që ta futim spangon dhe për të parë se si funksionon telefoni i ndërtuar nga ta, kërkojmë që njëri nga ta të dalë në oborr dhe tjetri të rrijë brenda. Dy nxënësit që mbajnë në duar gotat duhet të jenë aq larg nga njëri-tjetri sa të mos dëgjohet nëpërmjet ajrit ajo që thonë. Nxënësit e provojnë dyshe-dyshe telefonin, njëri duke folur dhe tjetri duke e mbajtur në vesh gotën. Më pas, nxënësi tregon se çfarë tha shoku nga ana tjetër e telefonit. Nxënësi që flet, do ta konfirmojë atë që e ka dëgjuar shoku.



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit *Shkrim i lirë*

Pas përfundimit të punës praktike, përshkruhet vëzhgimi i punës dhe shënohet përgjigja e pyetjes së kërkimit nga vetë nxënësit: “A përhapet zëri edhe në trupa të ngurtë?”

Disa nga shkrimet e nxënësve lexohen.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari, për saktësinë e zgjerimit të fjalive me fjalë a grupe fjalësh.

### Detyrë:

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Bashkëveprimet dhe lëvizjet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Shpjegon shndërrimet e kthyeshme dhe të pakthyeshme të lëndës.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1; II.5; II.8; V.8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1;4

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ndryshimet (shndërrimet) e kthyeshme dhe të pakthyeshme të lëndës

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përkufizon shndërrimet e kthyeshme dhe të pakthyeshme;
  - Identifikon lëndët e kthyeshme dhe të pakthyeshme;
  - Shpjegon para nxënësve të tjerë pjesën e tij/saj.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fije shkrepeşeje, çokolatë, balonë, gotë me ujë etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënët**

*Shkrime sipas këndvështrimit shkencor*

Kërkohet nga nxënësit që t'i hapin librat dhe për 10 minuta ta lexojnë tekstin. Më pas, udhëzohen të ndahen në 4 grupe. Secili grup zgjedh një send apo dukuri dhe do të shkruajnë për të nga këndvështrimi i vetës së parë. Ato sende i vendosim mbi bankë. Ata, përmes tregimeve të tyre, do të japin sa më shumë përmbajtjen e mësimet. Pasi t'i lexojnë tregimet e tyre, diskutojnë, si dhe marrin komente dhe sugjerime nga nxënësit e tjerë. Ja një shembull i mundshëm:

<p><b>Akulli</b>                  Nuk jam shumë i ndërlikuar, por kam shumë rëndësi. Jam pa ngjyrë dhe pa shije, formën e marr nga ena. Nëse mua më vendosni në frigorifer, atëherë unë bëhem akull, por unë përsëri mund të bëhem ujë përmes shkrirjes.</p>	<p><b>Çokollata</b>                  Jam e ëmbël dhe e shijshme, të gjithë fëmijët më duan. Më gjeni në përmasa të ndryshme, por nëse unë shkrimem, atëherë unë e kam të pamundur të kthehem në gjendjen që isha në fillim.</p>
<p><b>Letra</b>                  Më gjeni në ngjyrë të bardhë, por edhe në shumë ngjyra të tjera. Shërbej që të tjerët të shkruajnë mbi mua. Por, nëse unë digjem, të gjitha shënimet së bashku me mua zhduken dhe nuk kthehen më.</p>	<p><b>Balona</b>                  Me mua luani shumë, zakonisht më fryni dhe më përdorni nëpër festa. Në ditëlindje jam gjithnjë e pranishme. Nëse mua më mbushni me ajër dhe pastaj e lironi ajrin që kam brenda, atëherë ju mund të më fryni përsëri, po nëse unë pëlças, atëherë është e pamundur që unë të kthehem përsëri ashtu siç isha.</p>

23 Ndryshimet (shndërrimet) e kthyeshme dhe të pakthyeshme të lëndës

Lënda (materia) mund të ndryshojë dhe këto ndryshime mund të jenë të kthyeshme ose të pakthyeshme.

**Ndryshimet e kthyeshme**

Kur një material ndryshon, mirëpo mund të kthehet prapë në gjendjen e tij origjinale, kemi të bëjmë me ndryshime të kthyeshme. Pra, në këtë rast, nuk janë krijuar materiale të reja. Te ndryshimet e kthyeshme lënda ndryshon formën, dukjen fizike, por nuk e ndryshon sasinë dhe përbërjen. P.sh., nëse marrim një copë akulli dhe e shkrijmë, në këtë rast do të shohim se akulli ndryshon gjendjen, nga ajo e ngurtë në atë të lëngët, por e ruan sasinë dhe përbërjen e njëjtë. Nëse e ngrijmë ujin, ai kthehet prapë në akull (gjendje të ngurtë), siç ka qenë më parë.



Akulli i shkrirë në ujë

Nëse marrim një balonë dhe e fryjmë, ajo do të ndryshojë formën dhe dukjen fizike, sepse nga një balonë e vogël shndërrohet në një balonë më të madhe. Por kur të shfryhet, balona do të kthehet në gjendjen origjinale të saj.



Balona e shfryrë dhe ajo e fryrë

**Ndryshimet e pakthyeshme**

Kur një lëndë ndryshon dhe është e pamundshme të kthehet në gjendjen e saj origjinale, kemi të bëjmë me ndryshim të pakthyeshëm. Për shembull, kur gatujmë ushqimin, zakonisht kemi të bëjmë me ndryshime të pakthyeshme. Skuqja e vezës është një rast i tillë; ajo do të jetë akoma një vezë, mirëpo tashmë ka ndryshuar strukturën, formën, aromën dhe pamjen e saj. Përmes nxehtësisë, ne kemi realizuar një ndryshim të pakthyeshëm dhe veza s'mund të kthehet në gjendjen e mëparshme.




Veza e skuqur

Përbërësit e miellit, gjalpit, vezëve, qumështit dhe sheqerit përdoren për të bërë një tortë. Ata ndryshojnë kur përzihen dhe piqen. Nxehësia bën që të krijohet një lëndë e re - torta. Kjo është një përzjerje e pakthyeshme. Pra, është e pamundshme që një tortë përsëri të kthehet në përbërësit e saj.



Përbërësit e tortës

Nëse keni ndezur një turrë drush, zjarri do t'i kthejë drutë në hi, siç tregohet në figurë. Hiri nuk mund të kthehet prapë në dru, prandaj është shndërrim i pakthyeshëm.



Shndërrimi i druve në hi

1. Kur kemi ndryshim të kthyeshëm të një lëndë? Sqaro përmes shembujve pse ndodh kthimi.
2. Kur kemi ndryshim të pakthyeshëm të një lëndë? Sqaro çfarë ndodh me lëndën që bëhet e pakthyeshme në gjendjen origjinale.



55



## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Demonstrim përmes punës praktike

Shndërrimet e lëndëve mund të jenë të kthyeshme, por edhe të pakthyeshme.

- Çfarë janë shndërrimet e pakthyeshme?

Marrim një fije shkrepëseje dhe e ndezim. Më pas pyesim: "A e vutë re si digjet një fije shkrepëseje?"

Fija e shkrepëses është prej druri dhe koka e saj e kuqe përbëhet nga një lëndë kimike e veçantë, që ndizet lehtë. Prej djegies shkaktohen flaka, tymi dhe mbetja e hirit të drurit me ngjyrë të zezë. Pra, fija e shkrepëses ka ndryshuar jo vetëm në formë, por edhe në përmbajtje. Në çdo lloj djegieje ndodh pothuajse e njëjta gjë.



Kështu ndodh edhe me drutë kur i vendosim në zjarr. Pas kësaj, është e pamundur që t'i kthejmë në gjendjen e tyre të mëparshme. Shndërrime të tilla janë të pakthyeshme.



## Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit Mendo - plotëso

I japim secilit nxënës nga një kopje të tabelës, ku në të ata do të shkruajnë emrat e disa lëndëve, që pasojnë shndërrime të kthyeshme dhe të pakthyeshme.

Shndërrime të kthyeshme	Shndërrime të pakthyeshme
Qelqi	Letra
Akulli	Druri

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në diskutim, për bashkëpunim me grupin, për saktësinë në identifikimin e lëndëve të kthyeshme dhe të pakthyeshme.

### Detyrë:

Përgjigjiuni pyetjeve në faqen 55.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Bashkëveprimet dhe lëvizjet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Shpjegon shndërrimet e kthyeshme dhe të pakthyeshme të lëndës.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.1; II.8; III.4; V.8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.4; 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ndryshimet (shndërrimet) e kthyeshme dhe të pakthyeshme të lëndës - Fletore pune

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përkufizon rëndësinë e lëndëve të kthyeshme;
- Krahason ndryshimet e kthyeshme me ndryshimet e pakthyeshme të lëndës.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

*Loja e shoqërimit*

Bashkë me nxënësit, të ndarë në katër grupe, luhet loja e shoqërimit, me qëllim të rikujtimit të njohurive paraprake. Udhëzohen nxënësit dhe ndahen në dy grupe, ku njëri grup shkruan lëndët e kthyeshme dhe grupi tjetër lëndët e pakthyeshme.

Lëndët e kthyeshme	Lëndët e pakthyeshme
Akulli	Vezët
Balona	Fleta
Çokollata	Druri


NDRYSHIMET (SHNDËRRIMET) E KTHYESHME DHE TË PAKTHYESHME TË LËNDËS

1. Te ndryshimet e kthyeshme, lënda ndryshon formën, dukjen fizike, por nuk e ndryshon sasinë.

**Eksperiment:** vërteto ndryshimin e kthyeshëm me anë të çokollatës.

Mjetet dhe materiali i duhur: **çokollata.**

**Ecuria e eksperimentit:** të lihet një çokollatë të qëndrojë në temperaturë më të lartë se ajo e dhomës. Në këtë rast, ajo do të shkrihet, do të humbë formën, por nuk do t'i humbë strukturën, aromën, shijen dhe sasinë. Kështu, nëse e ngrin çokollatën, ajo kthehet prapë në gjendjen e njëjtë që ka pasur para shkrirjes.



2. Një lëndë e ndryshuar që nuk mund të kthehet në gjendjen e saj origjinale është një shndërrim i pakthyeshëm.

**Eksperiment:** vërteto ndryshimin e pakthyeshëm përmes letrës.

Mjetet dhe materiali i duhur: **letra, shkrepësja.**

**VËREJTJE!**

Ky eksperiment duhet të kryhet në prani të prindit ose mësueses/it, për shkak se mund të sjellë rreziqe.



**Ecuria e eksperimentit:** merre një letër dhe ndize me shkrepëse. Ajo do të digjet dhe, si e tillë, do t'i humbë formën dhe strukturën. Kështu, flaka ka sjellë një ndryshim të pakthyeshëm të letra.

**NDRYSHIMET (SHNDËRRIMET) E KTHYESHME DHE TË PAKTHYESHME TË LËNDËS**


**23**

1. Te ndryshimet e kthyeshme, lënda ndryshon formën, dukjen fizike, por nuk e ndryshon sasinë.

**Eksperiment:** vërteto ndryshimin e kthyeshëm me anë të çokollatës.

Mjetet dhe materiali i duhur: **çokollata.**

**Ecuria e eksperimentit:** të lihet një çokollatë të qëndrojë në temperaturë më të lartë se ajo e dhomës. Në këtë rast, ajo do të shkrihet, do të humbë formën, por nuk do t'i humbë strukturën, aromën, shijen dhe sasinë. Kështu, nëse e ngrin çokollatën, ajo kthehet prapë në gjendjen e njëjtë që ka pasur para shkrirjes.



2. Një lëndë e ndryshuar që nuk mund të kthehet në gjendjen e saj origjinale është një shndërrim i pakthyeshëm.

**Eksperiment:** vërteto ndryshimin e pakthyeshëm përmes letrës.

Mjetet dhe materiali i duhur: **letra, shkrepësja.**

**VËREJTJE!**

Ky eksperiment duhet të kryhet në prani të prindit ose mësueses/it, për shkak se mund të sjellë rrezikë.



**Ecuria e eksperimentit:** merre një letër dhe ndize me shkrepëse. Ajo do të digjet dhe, si e tillë, do t'i humbë formën dhe strukturën. Kështu, flaka ka sjellë një ndryshim të pakthyeshëm te letra.

37



**Ndërtimi i njohurive:**

**Përpunimi i përmbajtjes**

*Demonstrim përmes eksperimentit*

Hapim fletoret e punës dhe fillojmë të vërtetojmë ndryshimin e kthyeshëm me anë të çokollatës dhe ndryshimin e pakthyeshëm përmes letrës. Marrim një çokollatë dhe e lëmë të qëndrojë në temperaturë më të lartë se ajo e klasës. Në këtë rast, ajo do të shkrihet, do ta humbë formën, por nuk do t'i humbë strukturën, aromën, shijen dhe sasinë. Kështu, nëse e ngrin çokollatën, ajo kthehet prapë në gjendjen e njëjtë që ka pasur para shkrirjes.



Marrim një letër dhe e ndezim me shkrepës. Ajo do të digjet dhe, si e tillë, do t'i humbë formën dhe strukturën. Kështu, flaka ka sjellë një ndryshim të pakthyeshëm te letra.



**Përforcimi:**

**Konsolidimi i të nxënit**


*Diagrami i Venit*

U shpërndajmë nxënësve fletët me diagramin e vendosur dhe kërkojmë nga ta që, përmes eksperimenteve të bëra më lart, të shkruajnë ngjashmëritë dhe dallimet në mes lëndëve të kthyeshme dhe atyre të pakthyeshme.

Ndryshimet e kthyeshme

Të përbashkëtat

Ndryshimet e pakthyeshme



**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për krahasimin e ndryshimeve të kthyeshme me të pakthyeshme të lëndës, për pjesëmarrje aktive në veprimtari gjatë eksperimenteve.

**Detyrë:**

Detyrë shtëpie: shkruaj disa lëndë, të cilat nuk kthehen më në gjendjen e tyre fillestare.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

**ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Bashkëveprimet dhe lëvizjet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Shpjegon shndërrimet e kthyeshme dhe të pakthyeshme të lëndës.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.6; III.4; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.5; 2.5.

**ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Njësia mësimore:** Demonstrimi i shembujve nga bashkëveprimet dhe lëvizjet e trupave

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Argumenton bashkëveprimin dhe lëvizjen e trupave;
  - Identifikon trupat që lundrojnë, zhyten dhe fundosen.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.


**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** enë, top pingpongu, laps, mprehëse, çelës.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathësi për jetë, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.


**METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS**

**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**  
*Diagrami shkak-pasojë*

U shpërndajmë nxënësve kopje të diagramit shkak-pasojë. Hapim librat dhe lexojmë tekstin. Më pas fillojmë dhe plotësojmë diagramin.








Procesi i lundrimit, i zhytjes dhe i fundosjes

**Eksperiment:** mënyrën e lundrimit, të zhytjes dhe të fundosjes mund ta demonstroi në klasë së bashku me mësuesen/in dhe shokët/shoqet e klasës. Merrni tri gota dhe mbushni me ujë në sasi të njëjtë. Merrni një copë tape, një copë druri dhe një copë hekuri, të gjitha me madhësi të njëjtë dhe vendosni në gota veç e veç. Përcillni çka po ndodh në secilën gotë dhe diskutoni së bashku.

**Forca shtytëse në trupin e zhytur në lëng**

Nëse e marrim një top dhe e fusim në një enë me ujë, topi do të lundrojë mbi sipërfaqe të ujit. Kjo ndodh për shkak të peshës së lehtë të topit, në raport me forcën shtytëse të ujit. Në rast se provojmë ta fundosim topin në fund të enës me ujë, forca shtytëse bëhet gjithnjë e më e madhe dhe pengon zhytjen e tij.



Forca shtytëse

1. Si krijohet mjegulla? Sqaro nga cilat përzierje të lëndëve krijohet.
2. Çfarë ndikon në lundrimin, zhytjen dhe fundosjen e një objekti në ujë?
3. Çfarë është forca shtytëse? Sqaro përmes ndonjë shembulli.



**Ndërtimi i njohurive:  
Përpunimi i përmbajtjes**

*Demonstrim përmes eksperimentit*

Eksperimentojmë forcën shtytëse në trupin e zhytur në lëng.

Marrim një enë me ujë dhe e vendosim topin e pingpongut brenda. Topi nuk zhytet në fund të enës, por qëndron në sipërfaqen e ujit.

Provoni ta shtyni me gisht topin e pingpongut për ta fundosur. Çfarë do të ndodhë?

U kërkohet nxënësve që secili në mënyrë individuale të shkruajë në fletore përfundimin që nxori.



**Përforcimi:  
Konsolidimi i të nxënit**

*Demonstrim përmes punës praktike*

Do ta eksperimentojmë procesin e lundrimit, zhytjes dhe fundosjes së trupave në ujë.

Marrim një enë, e mbushim me ujë dhe vendosim gjëra të ndryshme nga plastika, metali, druri. Duke i vendosur, ne përcjellim se cilat gjëra po lundrojnë, cilat po zhyten dhe cilat fundosen dhe i radhisim në tabelë.



Gjërat që lundrojnë	Gjërat që zhyten	Gjërat që fundosen

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari, për saktësinë në identifikimin e trupave që lundrojnë, zhyten dhe fundosen, si dhe për saktësinë e vendosjes së të dhënave në tabelë.

**Detyrë:**

Të plotësohet në fletore pune, faqe 35 dhe 36.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Bashkëveprimet dhe lëvizjet

**Rezultatet e të nxënësve të temës:**  
 Shpjegon shndërrimet e kthyeshme dhe të pakthyeshme të lëndës.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.2; II.4; III.3.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.2; 2.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Shtypja atmosferike dhe pesha e ajrit

**Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:**

- Përkufizon çfarë është atmosfera;
- Dallon shtypjen atmosferike nga pesha e ajrit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** gotë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Arsimitim për zhvillim të qëndrueshëm.


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënësit**  
*Stuhi mendimesh*

Shkruhet në tabelë tema “Atmosfera dhe shtypja atmosferike”. Nxënësit japin mendime rreth atmosferës dhe shtypjes atmosferike. Mendimet shkruhen në tabelë, pa bërë komente për to.




25 Shtypja atmosferike dhe pesha e ajrit



Atmosfera është mbështjellësi i gaztë i Tokës. Ajo ka pesë dhe shtyn (shtyp) çdo gjë poshtë saj. Shtypja që shkakton pesha e ajrit mbi sipërfaqe të Tokës quhet shtypje atmosferike. Për të demonstruar shtypjen atmosferike, merrni një gotë me ujë dhe mbulojeni sipër me një letër, mbani letërën me një dorë që të mos lëvizë dhe me dorën tjetër kthejeni gotën përmby. Pastaj, largojeni dorën ngadalë nga letra, ajo do të qëndrojë ngjitur me gotën. Kjo ndodh për shkak të shtypjes atmosferike nga poshtë në drejtim të letërës.


Për të vrojtuar peshën e ajrit, zhvillojmë këtë eksperiment: marrim dy balona të mbushura me sasi të njëjtë ajri dhe i vendosim secilën në të dyja anët e shkropit, siç tregohet në figurë. Pastaj, nëse shpini me gjilpërë njërin balonë, do të shihni se baraspesha e balonave do të prishet, sepse ana ku është e vendosur balona e fryrë do të bjerë më poshtë për shkak të peshës më të madhe që jep ajri në brendësi të saj.



Provoni t'i realizoni këto eksperimente në klasë së bashku me mësuesen/in dhe shokët/shoqet e klasës.

- ?
1. Çfarë është atmosfera?
  2. Çfarë quajmë shtypje atmosferike?
  3. A ka pesë ajri? Sqaro përmes shembullit të balonave në figurë.


## 25 Shtypja atmosferike dhe pesha e ajrit



Shtypja atmosferike

Atmosfera është mbështjellësi i gaztë i Tokës. Ajo ka peshë dhe shtyn (shtyp) çdo gjë poshtë saj. Shtypja që shkakton pesha e ajrit mbi sipërfaqe të Tokës quhet shtypje atmosferike. Për të demonstruar shtypjen atmosferike, merrni një gotë me ujë dhe mbulojeni sipër me një letër, mbani letrën me një dorë që të mos lëvizë dhe me dorën tjetër kthejeni gotën përmbys. Pastaj, largojeni dorën ngadalë nga letra, ajo do të qëndrojë ngjitur me gotën. Kjo ndodh për shkak të shtypjes atmosferike nga poshtë në drejtim të letrës.

Për të vrotuar peshën e ajrit, zhvillojmë këtë eksperiment: marrim dy balona të mbushura me sasi të njëjtë ajri dhe i vendosim secilën në të dyja anët e shklopit, siç tregohet në figurë. Pastaj, nëse shpini me gjilpërë njëri balonë, do të shihni se baraspesha e balonave do të prishet, sepse ana ku është e vendosur balona e fryrë do të bjerë më poshtë për shkak të peshës më të madhe që jep ajri në brendësi të saj.



Provoni t'i realizoni këto eksperimente në klasë së bashku me mësuesen/in dhe shokët/shoqet e klasës.



1. Çfarë është atmosfera?
2. Çfarë quajmë shtypje atmosferike?
3. A ka peshë ajri? Sqaro përmes shembullit të balonave në figurë.

58



### Ndërtimi i njohurive:

#### Përpunimi i përmbajtjes

*Demonstrim përmes punës praktike dhe eksperimentit*

Ndajmë nxënësit në dy grupe dhe me njërin grup demonstrojmë “shtypjen atmosferike”, kurse me grupin tjetër eksperimentojmë “peshën e ajrit”. Për të demonstruar shtypjen atmosferike, marrim një gotë me ujë dhe mbulojmë sipër me një letër, mbajmë letrën me një dorë që të mos lëvizë dhe me dorën tjetër kthejeni gotën përmbys. Pastaj, largojmë dorën ngadalë nga letra, ajo do të qëndrojë ngjitur me gotën për shkak të shtypjes atmosferike nga poshtë në drejtim të letrës.

Për të shikuar shtypjen e ajrit, së bashku zhvillojmë një eksperiment të vogël:

Marrim dy balona të mbushura me sasi të njëjtë ajri dhe i vendosim secilën në të dyja anët e shklopit. Pastaj, nëse shpojme me gjilpërë njëri balonë, do të shohim se baraspesha e balonave do të prishet. Kjo ndodh për shkak se pesha e ajrit ndryshon. Hapen librat dhe lexojmë.



### Përforcimi:

#### Konsolidimi i të nxënit

*Ditari dypjesësh*

Kërkohe nga nxënësit që pjesën që u ka bërë më së shumti përshtypje ta shkruajnë si citim. Për 5 minuta kohë, japin komentet e tyre mbi të. Nxënësit lexojnë komentet për pjesën e zgjedhur.

Citim/fragment	Koment/sugjerime

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në demonstrimin e punës praktike dhe eksperimentit, në saktësinë e dallimit në mes të shtypjes atmosferike dhe peshës së ajrit.

### Detyrë:

Të plotësohet në fletore pune, faqe 40.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Bashkëveprimet dhe lëvizjet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Paraqet shembuj të zgjerimit të ajrit, me zmadhimin e temperaturës dhe shpjegon qarkullimin e tij, si dhe motin e klimën.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.3; III.2; III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ndikimi i temperaturës në qarkullimin e ajrit dhe në mot

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përkufizon motin, klimën;
- Mëson pjesën e njësisë së caktuar;
- Argumenton ndikimin që ka temperatura në ajër.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**


**Përgatitja për të nxënët**

*Të nxënët me këmbime*

Në këtë temë do të shohim se si ndikon temperatura në qarkullimin e ajrit dhe në mot. Ndahet klasa në 4 grupe me nga 4 nxënës. Në çdo grup emërtohen nxënësit me shkronjat: A, B, C, D. Kërkohej nga nxënësit t'i hapin librat dhe pyetjet e përgatitura do t'u ndihmojnë nxënësve që ta kuptojnë tekstin.

26 Ndikimi i temperaturës në qarkullimin e ajrit dhe në mot

Temperatura ka ndikim të drejtpërdrejtë në vëllimin e ajrit. Kur rritet temperatura, distanca mes përbërësve të ajrit rritet - ajri zgjerohet dhe anasjellas. Ndikimin e temperaturës në zgjerimin e ajrit mund ta shihni në figurën e mëposhtme. Në dy shishe me ajër janë vendosur balonat; njëra shishe është vendosur në një enë me ujë të ftohtë, ndërsa tjetra në një enë me ujë të nxehtë. Në shishen me ujë të ftohtë vërehet se balona ka mbetur e pafryrë, ndërsa balona në enën me ujë të nxehtë (nën të cilën është i ndezur zjarri) është fryrë, si rezultat i zgjerimit të ajrit nga rritja e temperaturës.



Ndikimi i temperaturës në zgjerimin e ajrit

Moti

Hidhni një vështrim jashtë dritares suaj; a është ditë me diell, me vranësira dhe shi apo me borë? Kështu shihni çfarë moti keni sot. Moti është gjendja e atmosferës, e ndikuar nga temperatura dhe lagështia e përditshme e ajrit dhe nga reshjet e ndryshme. Moti ndryshon gjatë stinëve, por mund të ndryshojë edhe gjatë një dite. Për ta ditur motin, duhet t'i matim faktorët e ndryshëm që përcaktojnë atë si p.sh.: temperaturën me termometër; lagështinë e ajrit me higrometër; shpejtësinë e lëvizjes së ajrit me anemometër etj.



Moti



Anemometri



Higrometri

## Klima

Klima është shprehja për kushtet atmosferike (kushtet e motit) në një rajon për një kohë shumë të gjatë, të ndikuara nga temperatura dhe reshjet e ndryshme. Klima në Tokë mund të jetë: e nxehtë, e ftohtë dhe mesatare. Vendi ynë gjendet në zonën ku dominon klima mesatare. Moti është i rëndësishëm për njerëzit, sepse ai ndikon në shumë aspekte të jetës sonë, si në prodhim të ushqimit, në strehim, madje edhe në sigurinë tonë.



Klima e ftohtë, e nxehtë dhe mesatare



1. Identifiko dhe përshkruaj faktorin që ndikon në zgerimin e ajrit.
2. Çfarë paraqet moti dhe cilët faktorë ndikojnë në të?
3. Çfarë është klima?
4. Trego çfarë klime dominon në vendin tonë.

60



## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes Të nxënësit me këmbime

Brenda grupit diskutohet për njohuritë që mësuat. Zgjidhet nga një përfaqësues i secilit grup dhe shpjegon pjesën e tij. Kështu vazhdon për secilin grup. Shkruhen pyetjet dhe paqartësitë që kanë.

Nxënësi A: 1. Si ngrohet ajri?  
2. Çfarë ndikimi ka temperatura në ajër?

Nxënësi B: 1. Çfarë është moti?  
2. Cilët janë faktorët për matjen e motit?

Nxënësi C: 1. Çfarë klime mendoni se dominon në vendin tonë?

Nxënësi D: 1. Çfarë është klima?  
2. Si mund të jetë klima në Tokë?



## Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit Të nxënësit me këmbime

Më pas u tregohet grupeve se ku do të përquendrohen (nxënësit me shkronjën A në grupin A e kështu me radhë). Pas marrjes së informacioneve,

ata kthehen në grupet e mëparshme për të diskutuar rreth informacioneve të marra. Udhëzohen nxënësit që pyetjet e shkruara t'i paraqesin para klasës. Ata nxënësit që mësuat atë pjesë, përgjigjen.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për mësimin e pjesës së njësisë, për shpjegimin e pjesës së tyre dhe për përgjigjet e pyetjeve të paqarta, si dhe për mënyrën e bashkëpunimit në grupe.

### Detyrë:

Hulumtoni në internet për klimën që mbizotëron në vendin tonë dhe vendet përreth.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Bashkëveprimet dhe lëvizjet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Paraqet shembuj të zgjerimit të ajrit, me zmadhimin e temperaturës dhe shpjegon qarkullimin e tij, si dhe motin e klimën.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.3; II.8; III.1.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.4, 2.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ndikimi i temperaturës në qarkullimin e ajrit dhe në mot - Fletore pune

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Tregon funksionin e motit dhe klimës;
  - Analizon rezultatet e eksperimentit, duke nxjerrë përfundime.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** shishe, balona, enë etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathhtësi për jetë, Matematikë, Arsimim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë:**  
*Rikujtim i njohurive paraprake*

U kërkojmë nxënësve t'i hapin librat dhe fletoret e punës. Plotësohen detyrat nga 2 deri në 5, duke iu përgjigjur pyetjeve të dhëna.

1. Çfarë ndikon në ndryshimin e motit? \_\_\_\_\_
2. Çfarë e përcakton klimën e një rajoni? \_\_\_\_\_
3. Çfarë klime dominon në vendin tonë? \_\_\_\_\_
4. Pse njohja e motit është e rëndësishme për njerëzit? \_\_\_\_\_

NDIKIMI I TEMPERATURËS TE QARKULLIMI I AJRIT DHE TE MOTI

1. Ndikimin e temperaturës në zgjerimin e ajrit mund ta eksperimentoni siç tregohet në figurën poshtë.



a) Sqaro pse balona në shishen e vendosur në një enë me ujë të ftohtë ka mbetur e shfryrë, ndërsa balona në shishen e vendosur në një enë me ujë të nxehtë është fryrë?

---



---



---



---

2. Çfarë ndikon në ndryshimin e motit?

---



---

3. Çfarë e përcakton klimën e një rajoni?

---



---

4. Çfarë klime dominon në vendin tonë?

---



---

5. Pse njohja e motit është e rëndësishme për njerëzit?

---



---



## NDIKIMI I TEMPERATURËS TE QARKULLIMI I AJRIT DHE TE MOTI

26

1. Ndikimin e temperaturës në zgjerimin e ajrit mund ta eksperimentoni siç tregohet në figurën poshtë.



a) Sqaro pse balona në shishen e vendosur në një enë me ujë të ftohtë ka mbetur e shfryrë, ndërsa balona në shishen e vendosur në një enë me ujë të nxehtë është fryrë?

---

---

---

---

2. Çfarë ndikon në ndryshimin e motit?

---

---

3. Çfarë e përcakton klimën e një rajoni?

---

---

4. Çfarë klime dominon në vendin tonë?

---

---

5. Pse njohja e motit është e rëndësishme për njerëzit?

---

---

41



Ndërtimi i njohurive:


Përpunimi i përmbajtjes

Demonstrim përmes eksperimentit

Kërkohet nga nxënësit ta përcjellin eksperimentin me vëmendje, sepse në fund do t'iu përgjigjen pyetjes së dhënë nga mësuesi/ja.

Marrim dy shishe dhe dy enë. Në të dyja shisheet me ajër, i vendosim balonat; njëren shishe e vendosim në një enë me ujë të ftohtë, ndërsa tjetrën në një enë me ujë të nxehtë.

Vërejmë se balona në shishen me ujë të ftohtë ka mbetur pa fryrë, ndërsa balona në enën me ujë të nxehtë është fryrë.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit

Shkrim i lirë

Pas përfundimit të eksperimentit, përshkruhet vëzhgimi i punës dhe shënohet përgjigja e pyetjes:

- Pse balona në shishen e vendosur në një enë me ujë të ftohtë ka mbetur e shfryrë, ndërsa balona në shishen e vendosur në një enë me ujë të nxehtë është fryrë?

Disa nga shkrimet e nxënësve lexohen.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari, për saktësinë e përshkrimit të eksperimentit dhe për saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

Detyrë:

Vizato termometrën, higrometrin, anemometrën dhe trego për çfarë përdoren.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---

---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Bashkëveprimet dhe lëvizjet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Shqyrton shembuj të avullimit, valimit dhe lëngëzimit të ujit në varësi të temperaturës.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.4; II.1; II.6; III.3.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vlimi, avullimi dhe lëngëzimi i ujit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përshkruan procesin e vlimit, avullimit dhe kondensimit;
- Identifikon faktorët që ndikojnë në procesin e vlimit, avullimit dhe kondensimit;
- Tregon dallimin mes procesit të avullimit dhe procesit të kondensimit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Arsimitim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

*Pyetja sjell pyetjen*

?

Çfarë po mësojmë në këtë çast?

Nga cili faktor varet procesi i vlimit, i avullimit dhe i lëngëzimit të ujit?

+

Çfarë di rreth kësaj teme?

Procesi i vlimit, avullimit dhe lëngëzimit të ujit varet nga temperatura.

=

**Marrëdhënia shkak-pasojë**

Këto procese varen nga temperatura. Pse? Sepse për atë arsye bëhet qarkullimi i ajrit në atmosferë. Ky ndryshe quhet edhe ciki i ujit. Pse? Si rezultat i vlimit të ujit arrihet avullimi i tij, i cili qarkullon në atmosferë dhe në fund kondensohet ai ujë dhe vjen në tokë në formë të reshjeve të shiut.

27 Vlimi, avullimi dhe lëngëzimi i ujit

Shihni shembullin e vlimit, të avullimit dhe të lëngëzimit të ujit në varësi të temperaturës.

Vlimi i ujit ndodh në temperaturën 100 °C. Si rezultat i vlimit të ujit arrihet deri te shndërrimi i tij nga gjendja e lëngët në atë të gaztë (avuj të ujit). Këta avuj qarkullojnë me ndihmën e ajrit në atmosferë dhe pastaj kondensohen. Kondensimi është ndryshimi i ujit nga forma e tij e gaztë (avuj të ujit) në ujë të lëngshëm. Kondensimi zakonisht ndodh në atmosferë, kur ajri i ngrohtë ftohet dhe humb aftësinë e tij për të mbajtur avujt e ujit. Si rezultat, avujt e tepërt të ujit kondensohen dhe formojnë pikat e ujit siç tregohet në figurë.



Shembullin për vlimin, avullimin dhe lëngëzimin e ujit, diskutojeni me mësuesin/in duke krahasuar atë me dukurinë e reshjeve të shiut.

1. Nga cili faktor varet procesi i vlimit, i avullimit dhe i lëngëzimit të ujit?
2. Çfarë ndodh gjatë vlimit të ujit?
3. Çfarë është kondensimi?

## 27 Vlimi, avullimi dhe lëngëzimi i ujit

Shihni shembullin e vlimit, të avullimit dhe të lëngëzimit të ujit në varësi të temperaturës.

Vlimi i ujit ndodh në temperaturën 100 °C. Si rezultat i vlimit të ujit arrihet deri te shndërrimi i tij nga gjendja e lëngët në atë të gaztë (avuj të ujit). Këta avuj qarkullojnë me ndihmën e ajrit në atmosferë dhe pastaj kondensohen. Kondensimi është ndryshimi i ujit nga forma e tij e gaztë (avuj të ujit) në ujë të lëngshëm. Kondensimi zakonisht ndodh në atmosferë, kur ajri i ngrohtë ftohet dhe humb aftësinë e tij për të mbajtur avujt e ujit. Si rezultat, avujt e tepërt të ujit kondensohen dhe formojnë pikat e ujit siç tregohet në figurë.



Vlimi i ujit në 100°C

Shembullin për vlimin, avullimin dhe lëngëzimin e ujit, diskutojeni me mësuesen/in duke krahasuar atë me dukurinë e reshjeve të shiut.

1. Nga cili faktor varet procesi i vlimit, i avullimit dhe i lëngëzimit të ujit?
2. Çfarë ndodh gjatë vlimit të ujit?
3. Çfarë është kondensimi?

61



**Ndërtimi i njohurive:**  
**Përpunimi i përmbajtjes**  
*Mendo - diskuto*

Shfaqet një video para nxënësve, ku flitet për lëvizjet e trupave dhe mënyrën e lëvizjes së tyre. Videoja gjendet në vegëzën: [https://www.youtube.com/watch?v=lbSEkI\\_QHxo](https://www.youtube.com/watch?v=lbSEkI_QHxo)  
Nxënësit do ta shikojnë videon për t'iu përgjigjur pyetjeve:

- Çfarë sheh te çajniku?
  - Ku po shkon uji?
  - Si quhet gazi që formohet kur avullon uji?
- Më pas nxënësit do të diskutojnë rreth përgjigjeve të marra.



**Përforcimi:**  
**Konsolidimi i të nxënit**  
*Rrjeti i diskutimit*

Kërkojmë nga nxënësit që ta lexojnë pjesën e zgjedhur dhe pas leximit ata pyeten: “A pakësohet uji nga procesi i avullimit?”. Më pas kërkojmë nga ta të ndahen në dyshe për të nxjerrë anët kundërshtuese të një çështjeje.




PO

Arsyet

A pakësohet uji gjatë procesit të kondensimit?

Çështje kondensimi?

Përfundime

JO




### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në identifikimin e faktorëve, në përshkrimin e procesit, si dhe për dallimin mes procesit të avullimit dhe kondensimit.

### Detyrë:

Përgjigjuni pyetjeve në faqen 61.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

**ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Bashkëveprimet dhe lëvizjet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Dallon burimet e energjisë së pastër nga burimet që e ndotin mjedisin.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.8; II.2; II.6; V.9.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.2.

**ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Njësia mësimore:** Burimet e energjisë së pastër dhe burimet që e ndotin mjedisin



- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon burimet e energjisë në natyrë;
  - Dallon burimet e ripërtëritshme dhe të paripërtëritshme të energjisë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** gota, balona, shkop.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**  
 Gjuhë amtare, Shkathhtësi për jetë, Matematikë.

**METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS**

-  **Parashikimi:**
-  **Përgatitja për të nxënë:**  
*Mendo, krijo në dyshe dhe diskuto*



**28** Burimet e energjisë së pastër dhe burimet që e ndotin mjedisin

Energjia përkufizohet si aftësi për të kryer punë ose për të shtyrë diçka që të lëvizë. Ka forma të ndryshme të energjisë, si: energjia elektrike, e nxehtësisë, e lëvizjes, e dritës etj. Energjia mund të jetë energji e ripërtëritshme dhe energji jo e ripërtëritshme. Energjia e ripërtëritshme është energji, burimet e së cilës nuk harxhohen dhe mund të riciklohen. Shembuj të energjisë së ripërtëritshme kemi energjinë diellore, energjinë e erës, energjinë e ujit etj.



Energjia e erës është burim i rëndësishëm për prodhimin e energjisë elektrike, nuk shkakton ndotje të madhe të mjedisit.

Turbinat (mullinjtë) e erës



Ashtu sikurse energjia e erës, edhe ajo diellore është burim i jashtëzakonshëm për prodhimin e energjisë elektrike të pastër dhe të qëndrueshme.

Panelet diellore nga të cilat fitohet energjia elektrike



Hidrocentrali nga i cili fitohet energjia elektrike

Energjia hidrike (ujore) gjithashtu është një burim i rëndësishëm për prodhimin e energjisë elektrike. Ajo përfitohet nga makineritë që vihen në lëvizje nga rrjedhat e lumenjve. Energjia hidrike, e erës dhe ajo diellore janë burime të energjisë së pastër që përdoren edhe në vendin tonë.



Termocentrali nga i cili fitohet energjia elektrike

Te rasti i energjisë së joripërtëritshme, burimet e energjisë harxhohen gjatë procesit të prodhimit të energjisë dhe nuk mund të riciklohen, prandaj kanë ndikim të madh në ndotjen e mjedisit. Kulloj i energjisë prodhohet nga makineritë, të cilat për t'u vënë në lëvizje, përdorin thëngjillin, naftën dhe gazin. Në vendin tonë, si material jo i ripërtëritshëm është thëngjilli, i cili kryeson për përfitimin e energjisë elektrike.

Bisedoni me mësuesen/in dhe shokët/shoqet e klasës për burimet e energjisë së ripërtëritshme dhe të joripërtëritshme që shfrytëzohen në vendin tonë për përfitimin e energjisë elektrike. Komentoni së bashku efektet e shfrytëzimit të tyre në mjedis.

1. Çfarë është energjia e ripërtëritshme dhe cilat janë burimet e saj?
2. Pse është e rëndësishme të shfrytëzohet energjia e ripërtëritshme?
3. Cilat janë burimet e energjisë së joripërtëritshme dhe pse prodhimi i kësaj energjie nuk është i preferuar?



63




### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Mbajtja e strukturuar e shënimeve

U kërkohet nxënësve t'i hapin librat dhe t'i shikojnë fotot që kemi në libër dhe më pas fillojmë t'i komentojmë së bashku.

Burimet e energjisë i ndajmë në dy grupe:  
Cilat mendoni se janë ato? Cilat janë karakteristikat e tyre?



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënësve Rrjeti i diskutimit

Po

A mendoni se burimet e paripërtëritshme do të zhduken? Pse?

Jo

1.

1.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në diskutim, për identifikimin e burimeve të energjisë, për saktësinë në dallimin e burimeve të ripërtëritshme dhe të paripërtëritshme.

### Detyrë:

Përgjigjiuni pyetjeve në faqen 63.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Bashkëveprimet dhe lëvizjet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Dallon burimet e energjisë së pastër nga burimet që e ndotin mjedisin.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.7; II.8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.5; 2.6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Burimet e energjisë së pastër dhe burimet që e ndotin mjedisin - Fletore pune

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Plotëson karakteristikat e secilit burim energjie;
- Argumenton rëndësinë e përdorimit të energjisë së pastër për ambientin;
- Krahason burimet e energjisë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, laptop, projektor, foto, fletë A4.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë shqipe, Shkathësi për jetë, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

*Diskutim për njohuritë paraprake*

Nxiten nxënësit të diskutojnë përmes pyetjes si më poshtë:

- Pse është e rëndësishme të përdorim sa më shumë burime të energjisë së pastër?

Nxënësit diskutojnë për energjinë e pastër për rëndësinë që kanë burimet e pastra të energjisë për ambientin tonë.

BURIMET E ENERGJISË SË PASTËR DHE BURIMET QË E NDOTIN MJEDISIN

1. Në tabelë, plotëso karakteristikat e secilit burim energjie.

Burimi i energjisë	E ripërtërishme	Jo e ripërtërishme	Përdorshmëria	Përparësitë	Mangësitë
Era					
Nafta					
Dielli					
Thëngjilli					
Gazi					
Uji					

2. Plotëso fjalitë.

Burimet e energjisë së ripërtërishme nuk \_\_\_\_\_ dhe mund të \_\_\_\_\_

Burimet e energjisë së joripërtërishme \_\_\_\_\_ gjatë procesit të prodhimit të energjisë dhe nuk \_\_\_\_\_ prandaj kanë ndikim të madh \_\_\_\_\_ e mjedisit.

3. Detyrë

Shkruaj për burimet e përfitimit të energjisë elektrike që përdoren në rrethinën ku jeton dhe, pastaj, diskutoni së bashku në klasë.



**BURIMET E ENERGJISË SË PASTËR DHE BURIMET QË E NDOTIN MJEDISIN**

**28**

1. Në tabelë, plotëso karakteristikat e secilit burim energjie.

Burimi i energjisë	E ripërtërishme	Jo e ripërtërishme	Përdorshmeria	Përparësitë	Mangësitë
Era					
Nafta					
Dielli					
Thëngjilli					
Gazi					
Uji					

2. Plotëso fjalitë.

Burimet e energjisë së ripërtërishme nuk \_\_\_\_\_ dhe mund të \_\_\_\_\_

Burimet e energjisë së joripërtërishme \_\_\_\_\_ gjatë procesit të prodhimit të energjisë dhe nuk \_\_\_\_\_ prandaj kanë ndikim të madh \_\_\_\_\_ e mjedisit.

**3. Detyrë**

Shkruaj për burimet e përfitimt të energjisë elektrike që përdoren në rethinën ku jeton dhe, pastaj, diskutoni së bashku në klasë.

43



**Ndërtimi i njohurive:  
Përpunimi i përmbajtjes  
Vëzhgo, diskuto, plotëso**

Me anë të projektorit, paraqiten burime të energjisë së ripërtërishme dhe energjisë jo të ripërtërishme. Nxënësit i emërtojnë ato, duke diskutuar për rëndësinë që kanë burimet e energjisë së ripërtërishme për ruajtjen e ambientit. Kërkohet nga nxënësit t'i hapin fletoret e punës në f. 43.

Ushtrimi 1. Nxiten nxënësit ta plotësojnë tabelën me karakteristikat e secilit burim të energjisë.


Ushtrimi 2. Plotësohen fjalitë, më pas lexohen nga nxënës të ndryshëm.



**Përforcimi:  
Konsolidimi i të nxënit  
Diagrami i Venit**

Në tabelë paraqitet Diagrami i Venit, kërkohet nga nxënësit që të shkruajnë për të veçantat dhe të përbashkëtat e burimeve të energjisë së pastër dhe burimeve të energjisë që e ndotin ambientin.

Burimet e energjisë së pastër



Burimet e energjisë së pastër

Të përbashkëtat

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për dallimin e saktë të burimeve të energjisë së pastër, si dhe për rëndësinë që ka përdorimi i energjisë së pastër për ruajtjen e ambientit.

**Detyrë:**

Punohet ushtrimi 3 në fletoren e punës, f. 43.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Bashkëveprimi elektrik dhe magnetik

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Ndërton elektroskopin e thjeshtë dhe me të dallon trupat që ngarkohen dhe nuk ngarkohen me elektricitet.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** I.3; III.4; III.7; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Elektriciteti dhe magnetizmi

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Tregon çfarë është elektriciteti;
  - Shpjegon se çfarë formojnë energjia elektrike dhe magnetizimi;
  - Ndërton elektroskopin e thjeshtë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, gotë plastike, tel metalik, copëza alumini.


**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë:**  
*Stuhi mendimesh*

Në tabelë shkruhet fjala “elektriciteti”, nxiten nxënësit të tregojnë së çfarë dinë për të, duke u ndihmuar nga pyetjet:

1. Ç’është elektriciteti?
2. Ku prodhohet ai?



Së bashku me nxënësit, shikohet videoja në të cilën flitet për mënyrat e prodhimit të elektricitetit. Videoja gjendet në vegëzën: [www.switchedonkids.org.uk/where\\_does.html](http://www.switchedonkids.org.uk/where_does.html).

29 BASHKËVEPRIMI ELEKTRIK DHE MAGNETIK  
 Elektriciteti dhe magnetizmi

Elektriciteti është formë e energjisë, që disa objekteve u jep energji për punë. Prodhet nga makina që quhen gjeneratorë. Gjeneratorët, format e tjera të energjisë, si: energjinë e erës, të diellit, të ujit, nxehësinë që lirohet nga djegia e thëngjillit, e gazit etj., i kthejnë në energji elektrike. Nga gjeneratori deri tek objekti (mjeti që përdor elektricitetin, p.sh. llambat ndriçuese, televizori, telefoni etj.) bartet përmes telave. Energjia elektrike mund të ruhet në bateri dhe të përdoret sipas nevojës pastaj.

Edhe ju mund të krijoni elektricitet, po që se merrni një balonë dhe e fërkoni me një leckë dhe nëse pranë saj afroni copa të vogla të letres, ajo do t’i tërheqë ato. Po ashtu, nëse balonën e afroni afër flokëve, ai do t’i tërheqë ata si një magnet. Tërheqja ndodh për shkak të elektricitetit, përkatësisht ngarkesave të ndryshme elektrike ndërmjet balonës dhe flokëve ose letres. Këtë mund ta eksperimentoni në klasë, së bashku me mësuesen/in dhe shokët/shoqet.

Ngarkesa elektrike e një objekti mund të matet. Matja bëhet me instrumentin që quhet elektroskop.



Elektroskopi i thjeshtë

Ju mund të ndërtoni një elektroskop të thjeshtë.

Për ndërtimin e një elektroskopi të thjeshtë nevojiten: një gotë plastike, një tel metalik dhe dy copëza alumini. Merrret gota plastike, së cilës i shpohet fundi për ta vendosur telin. Teli duhet të jetë i lakuar në njërin anë, ku të vendosen dy copëza të shpuara të aluminit, ndërsa ana tjetër e tij duhet të përdridhet. Gotën e kthejmë përmbyb dhe fillojmë të testojmë trupat që bartin elektricitet, siç tregohet në figurë.

Marrim një shkop plastike dhe e fërkojmë me një leckë. Kur atë e afrojmë te teli i përdredhur, sipër do të vërejmë se copëzat e aluminit të varura poshtë do të largohen nga njëra-tjetra.


1. Çfarë formojnë energjia elektrike dhe magnetizmi?
2. Çfarë krijon një ngarkesë elektrike në lëvizje?
3. Cili është instrumenti që bën matjen e ngarkesës elektrike?

## 29 BASHKËVEPRIMI ELEKTRIK DHE MAGNETIK Elektriciteti dhe magnetizmi

Elektriciteti është formë e energjisë, që disa objekteve u jep energji për punë. Prodhohet nga makina që quhen gjeneratorë. Gjeneratorët, format e tjera të energjisë, si: energjinë e erës, të diellit, të ujit, nxehtësinë që lirohet nga djegia e thëngjillit, e gazit etj., i kthejnë në energji elektrike. Nga gjeneratori deri tek objekti (mjeti që përdor elektricitetin, p.sh. llambat ndriçuese, televizori, telefoni etj.) bartet përmes telave. Energjia elektrike mund të ruhet në bateri dhe të përdoret sipas nevojës pastaj.

Edhe ju mund të krijoni elektricitet, po që se merrni një balonë dhe e fërkoni me një leckë dhe nëse pranë saj afroni copa të vogla të letërës, ajo do t'i tërheqë ato. Po ashtu, nëse balonën e afroni afër flokëve, ai do t'i tërheqë ata si një magnet. Tërheqja ndodh për shkak të elektricitetit, përkatësisht ngarkesave të ndryshme elektrike ndërmjet balonës dhe flokëve ose letërës. Këtë mund ta eksperimentoni në klasë, së bashku me mësuesin/in dhe shokët/shoqet.

Ngarkesa elektrike e një objekti mund të matet. Matja bëhet me instrumentin që quhet elektroskop.



Ju mund të ndërtoni një elektroskop të thjeshtë.

Për ndërtimin e një elektroskopi të thjeshtë nevojiten: një gotë plastike, një tel metalik dhe dy copëza alumini. Merret gota plastike, së cilës i shpohet fundi për ta vendosur telin. Teli duhet të jetë i lakuar në njërin anë, ku të vendosen dy copëza të shpuara të aluminit, ndërsa ana tjetër e tij duhet të përdridhet. Gotën e kthejmë

përmbs dhe fillojmë të testojmë trupat që bartin elektricitet, siç tregohet në figurë.

Marrim një shkop plastike dhe e fërkojmë me një leckë. Kur atë e afrojmë te teli i përdredhur, sipër do të vërejmë se copëzat e aluminit të varura poshtë do të largohen nga njëra-tjetra.



1. Çfarë formojnë energjia elektrike dhe magnetizmi?
2. Çfarë krijon një ngarkesë elektrike në lëvizje?
3. Cili është instrumenti që bën matjen e ngarkesës elektrike?

64



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Hapen librat në f. 64. Lexohet dhe diskutohet gjatë leximit mbi informacionin që jepet në libër. Më pas shtrohen pyetjet:

- Çfarë është elektriciteti?
- Si quhet makina në të cilën prodhohet ai?
- Ku mund të ruhet energjia elektrike?
- Po ju, a mund të krijoni elektricitet? Si?
- Si quhet instrumenti që bën matjen e ngarkesës elektrike?



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit Demonstrim përmes eksperimentit

Diskutohet modeli i ndërtimit të elektroskopi të dhënë në libër. Lexohet informacioni i dhënë në lidhje me ndërtimin e tij. Drejtohen pyetjet:

- Cilët përbërës na nevojiten për ndërtimin e elektroskopi?
- Cilët janë hapat që duhen ndjekur për ndërtimin e tij?

Pasi të sqarohet mirë ndërtimi i elektroskopi, së bashku me nxënësit demonstron ndërtimi i elektroskopi. Testohen trupat që bartin elektricitet, duke e kthyer gotën përmbyss siç tregohet në figurë.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në shpjegimin se çfarë është elektriciteti, çfarë formojnë energjia elektrike dhe magnetizmi, si dhe ndërtimin e elektroskopi.

### Detyrë:

Punohen pyetjet në f. 64.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Bashkëveprimi elektrik dhe magnetik

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Shpjegon elektricitetin atmosferik dhe mbrojtjen prej tij.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.1; II.6; II.8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.6; 2.6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Elektriciteti atmosferik dhe mbrojtja prej tij

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shpjegon çfarë është rrufeja dhe si krijohet ajo;
  - Tregon cilat forma të energjisë lirohen nga goditja e rrufesë;
  - Përshkruan pse janë krijuar rrufepritësit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, foto, atlas, interneti etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**  
 Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**  
 Diskutim për njohuritë paraprake

Në tabelë vendosen figura të ndryshme që kanë lidhje me elektricitetin atmosferik dhe mbrojtjen prej tij.  
 Nxënësit i vëzhgojnë me kujdes, më pas u drejtohen pyetje për secilën figurë veç e veç.

30 Elektriciteti atmosferik dhe mbrojtja prej tij

Energjia elektrike nuk gjendet vetëm në linjat (telat) e rrjetit elektrik, të ndërtuara nga njeriu, por gjithashtu gjendet edhe në natyrë. Gjatë motit të vrenjtur dhe me shi, shpesh kemi parë stuhi rrufesh. Retë janë të ngarkuara me ngarkesa të ndryshme elektrike (disa me ngarkesë pozitive, ndërsa të tjerat me ngarkesë negative). Kur ato takohen, ndodhin shkarkimet elektrike ose rrufetë. Rrufetë janë shkarkime elektrike natyrore, me ç'rast shkarkohet një sasi e madhe e energjisë elektrike.


Gjatë shkarkimeve krijohet dritë, e cila quhet **vetëtimë**, por krijohet edhe një zë që quhet **bubullimë**. Së pari, shohim dritën, pastaj dëgjojmë bubullimën, sepse drita lëviz shumë më shpejt se zëri. Rrufeja (shkarkimi elektrik) mund të ndodhë në qiell, ndërmjet reve, ose mund të ndodhë ndërmjet reve dhe tokës. Në tokë, zakonisht ato godasin objektet më të larta. Shpesh prej rrufesë goditen pemë, kafshë, por edhe njerëz.



Goditja e pemës nga rufeja




Rufeja - vetëtimja



Duke pasur parasysh rrezikun nga goditjet e rrufeve, njeriu ka krijuar rrufepritësit për t'u mbrojtur, të cilët i vendosen në objektet e banimit. Nëse rufeja godet një objekt ku gjendet rrufepritësi, ai e pranon energjinë e shkarkuar dhe e përcjell në tokë, pa ndonjë pasojë për objektin dhe njerëzit. Gjatë stuhive të rrufeve, nuk preferohet të mbahen gjëra metalike në duar sepse i tërheqin rrufetë, siç tregohet në figurë.

Rrufepritësi



Gjatë stuhive të rrufeve, nuk preferohet të mbahen gjëra metalike në duar.

Bisedoni me mësuesen/in dhe shokët/shoqet e klasës pse shohim së pari vetëtimën, e pastaj e dëgjojmë bubullimën.



1. Çfarë është rrufeja dhe si krijohet ajo?
2. Cilat forma të energjisë lirohen nga goditja e rrufesë?
3. Ku krijohet rrufeja?
4. Pse njeriu ka krijuar rrufepritisit?
5. Pse nuk preferohet të mbahen gjëra metalike në duar gjatë stuhive të rrufeve?

66



**Ndërtimi i njohurive:**  
**Përpunimi i përmbajtjes**  
*Di - Dua të di*

Në tabelë shkruhen: *elektriciteti atmosferik, vetëtimja, bubullima, rrufepritisit.*

Udhëzohen nxënësit të shkruajnë çfarë dinë rreth këtyre temave të shtylla e parë e tabelës *Di*. Te shtylla e dytë shkruajnë çfarë duan të dinë më shumë rreth temave të mësipërme.

Pasi të plotësohen dy kolonat e para, nga disa nxënës shkruhen në tabelë disa prej pyetjeve që kanë lidhje me objektivat e kësaj ore mësimore. Lexohet mësimi në heshtje nga nxënësit.

DI	DUA TË DI	MËSOVA



**Përforcimi:**  
**Konsolidimi i të nxënit**  
*Mësova*

Diskutohet me klasën për pikat kryesore të

mësimimit, duke u ndihmuar edhe nga figurat e dhëna.

Plotësohet edhe shtylla e tretë e tabelës, duke ofruar ndihmë aty ku ka nevojë.

DI	DUA TË DI	MËSOVA

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e sqarimeve rreth formave të energjisë që lirohen nga goditja e rrufesë, strukturimin e saktë të informacioneve në tabelë, si dhe përshkrimin e krijimit të rrufepritisit.

**Detyrë:**

Punohen pyetjet e mësimimit në faqe 66.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Bashkëveprimi elektrik dhe magnetik

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Shpjegon elektricitetin atmosferik dhe mbrojtjen prej tij.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.7; II.8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.5; 2.6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Elektriciteti atmosferik dhe mbrojtja prej tij - Fletore pune

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Diskuton rreth njohurive paraprake;
- Sqaron se energjia elektrike nuk gjendet vetëm në linjat e energjisë;
- Tregon si të mbrohemi gjatë stuhive të rrufeve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fletore pune.


**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënët**  
 Diskutim për njohuritë paraprake

Në qendër të tabelës shkruajmë *elektriciteti atmosferik* dhe më pas nxënësit shkruajnë çfarë dinë për të.



ELEKTRICITETI ATMOSFERIK DHE MBROJTJA PREJ TIJ

1. Plotëso fjalitë.
  - a) Energjia elektrike nuk gjendet vetëm në linjat e energjisë dhe elektronikën e bërë nga njeriu, por gjithashtu gjendet \_\_\_\_\_
  - b) Ne e shohim energjinë elektrike nga shfaqja e \_\_\_\_\_
  - c) Përveç energjisë elektrike, nga rrufeja lirohet edhe energjia e \_\_\_\_\_, si dhe energjia \_\_\_\_\_ që e dëgjojmë si \_\_\_\_\_



- d) Goditjet e rrufesë kanë efekt \_\_\_\_\_
- e) Duke pasur parasysh rrezikun për ne nga goditjet e rrufeve që vijnë nga retë, njeriu ka arritur që të krijojë \_\_\_\_\_
- f) Gjatë stuhive të rrufeve, nuk preferohet të mbahen \_\_\_\_\_ në duar, sepse janë tërheqëse për \_\_\_\_\_
- g) Pse ndonjëherë shohim së pari rrufe e pastaj dëgjojmë bubullima?



1. Plotëso fjalitë.

- a) Energjia elektrike nuk gjendet vetëm në linjat e energjisë dhe elektronikën e bërë nga njeriu, por gjithashtu gjendet \_\_\_\_\_
- b) Ne e shohim energjinë elektrike nga shfaqja e \_\_\_\_\_
- c) Përveç energjisë elektrike, nga rrufeja lirohet edhe energjia e \_\_\_\_\_, si dhe energjia \_\_\_\_\_ që e dëgjojmë si \_\_\_\_\_



- d) Goditjet e rufesë kanë efekt \_\_\_\_\_
- e) Duke pasur parasysh rrezikun për ne nga goditjet e rrufeve që vijnë nga retë, njeriu ka arritur që të krijojë \_\_\_\_\_
- f) Gjatë stuhive të rrufeve, nuk preferohet të mbahen \_\_\_\_\_ në duar, sepse janë tërheqëse për \_\_\_\_\_
- g) Pse ndonjëherë shohim së pari rrufe e pastaj dëgjojmë bubullima?  
\_\_\_\_\_

45



**Ndërtimi i njohurive:**  
**Përpunimi i përmbajtjes**  
*Vëzhgo, analizo, plotëso*

Vëzhgohet dhe analizohet figura e dhënë në fletore pune. Më pas diskutohet rreth saj. Lexohen fjalitë e ushtrimit 1 dhe plotësohen me fjalët e duhura. Pasi të plotësohen fjalitë, lexohen nga nxënës të ndryshëm.



**Përforcimi:**  
**Konsolidimi i të nxënës**  
*Shkrimi i shpejtë*

Së bashku me nxënësit, do ta shikojmë videon në të cilën jepen këshilla se si duhet të mbrohemi nga vetëtimat. Videoja gjendet në vegëzën: [www.youtube.com/watch?v=W62y-ERPcOc](http://www.youtube.com/watch?v=W62y-ERPcOc) Pasi të dëgjohen këshillat e dhëna në video, nxënësit shkruajnë në fletore disa nga këshillat e mësuara. Më pas shkrimet lexohen nga nxënës të ndryshëm.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në rikujtimin e njohurive për elektricitetin magnetik, sqarimin se energjia elektrike nuk gjendet vetëm në linjat e energjisë, si dhe shkrimin e disa rregullave se si të mbrohen gjatë stuhive të rrufeve.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Bashkëveprimi elektrik dhe magnetik

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

- Dallon përcjellësit dhe veçuesit elektrikë me ndihmën e qarkut elektrik;
- Demonstron mbylljen e qarkut elektrik me tretësi të ujore të kripës.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; III.1, III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.5, 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Qarku i thjeshtë elektrik

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Shpjegon çfarë paraqet një qark elektrik i thjeshtë;
- Sqaron çfarë quajmë përcues e çfarë izolator elektrik;
- Demonstron mbylljen e qarkut elektrik me tretësi të ujore të kripës.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, bateria, telat, llamba, ndërprerësi uji, kripa, interneti.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë shqipe, Shkathësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**  
*Stuhi mendimesh*


Në tabelë vendosim figurën e qarkut elektrik. Ftohen nxënësit ta shohin figurën. Pyeten:

- Çfarë është paraqitur në figurë.
- Përse shërben?

U sqarohet nxënësve se ky është qarku elektrik nëpër të cilin kalon rryma elektrike.

31 Qarku i thjeshtë elektrik


Qarku elektrik është rruga në të cilën kalon rryma elektrike. Ai përbëhet nga katër përbërës kryesorë: burimi i energjisë (p.sh. bateria), rruga përcuese (p.sh. teli i rrymës), rezistori (p.sh. poçi elektrik) dhe ndërprerësi i rrymës.




Përcuesit dhe veçuesit elektrikë

Disa materiale përcojnë (përcjellin) energjinë elektrike më mirë se të tjerat. Këto materiale quhen përcues (përcjellës) elektrikë. Materialet që e përcjellin energjinë elektrike më së miri janë metalet. Nga të gjitha metalet, argjendi më së miri përcjell energjinë elektrike, por meqë gjendet më rrallë dhe ka kosto të lartë, ai ka përdorim të kufizuar.

Sot bakri është përcuesi që përdoret më shumë, kjo për shkak të përcueshmërisë së mirë dhe çmimit të lirë që ka. Materialet e tjera që janë rezistente ndaj përcimit të rrymës elektrike quhen veçues (izolues). Përcuesit dhe izoluesit kanë ndërtim të ndryshëm dhe gjejnë përdorim në fushën e elektronikës. Në figurën poshtë (A), mund të shihni shembuj të materialeve që janë përcuese të rrymës elektrike dhe (B) shembuj të materialeve që janë rezistente ndaj përcimit të rrymës elektrike.



Përcuesit dhe izolatorët



Që të mundësojë lëvizjen e energjisë elektrike, qarku elektrik duhet të jetë një hark i mbyllur. Zakonisht qarqet ndërtohen nga metale të ndryshme, por ato mund të ndërtohen edhe nga materiale të tjera që përçojnë energjinë elektrike. P.sh., qarkun mund ta krijojmë edhe duke përdorur tretësirë ujore të kripës, siç është demonstruar në figurën anash. Për demonstrim duhen: bateria, ena me tretësirë ujore të kripës, telat dhe llamba.

- ?
1. Çfarë paraqet një qark elektrik i thjeshtë? Sqaro nga cilat pjesë ndërtohet.
  2. Çfarë quajmë përcues e çfarë izolator elektrik?
  3. Trego disa nga përcuesit dhe jopërcuesit (izolatorët) e rrymës elektrike.

68



## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes Pyetja sjell pyetjen

Hapen librat në f. 67. Lexohet teksti. Zhvillohet diskutim për pyetjet:

- Çfarë paraqet qarku elektrik?
- Cilët janë përbërësit e qarkut elektrik?
- Si quhet metali që e përcjell më së miri energjinë elektrike?
- Pse bakri përdoret më shumë se materialet e tjera?
- Cili është përcuesi që përdoret më së shumti?
- Çfarë quajmë përcues e çfarë izolator elektrik?
- Si mund ta krijojmë qarkun elektrik me tretësirë ujore të kripës?



## Përforcimi: Konsolidimi i të nxënës

*Demonstrim përmes punës praktike*

Së bashku me nxënësit, demonstron krijimi i qarkut elektrik me tretësirë ujore, sipas udhëzimeve të marra në tekst dhe nga videoja që do ta shikojmë bashkë me nxënësit. Videoja gjendet në vegëzën:

[https://www.youtube.com/watch?v=SidZOBPS\\_tU](https://www.youtube.com/watch?v=SidZOBPS_tU)

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e shpjegimit të përbërjes së qarkut elektrik të thjeshtë, sqarimit të termit përcues dhe izolator elektrik, si dhe demonstrimin e krijimit të qarkut elektrik.

### Detyrë:

Vizatoni qarkun elektrik dhe emërtoni pjesët e tij.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Bashkëveprimi elektrik dhe magnetik

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Ndërton qarkun e thjeshtë elektrik, ilustron skemën e tij dhe përshkruan rolin e çdo pjese përbërëse.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** II.6, 8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.5; 2.3

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Qarku i thjeshtë elektrik - Fletore pune

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Rikujton njohuritë për qarkun elektrik;
  - Ndërton qarkun elektrik;
  - Përshkruan rolin e çdo pjese përbërëse të tij.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** bateri, dy tela përçues të veshur, llambë e vendosur në një mbajtëse, çelës, shirit ngjitës.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë shqipe, Shkathhtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**  
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Ora mësimore fillon me përsëritjen e shpejtë të atyre që i kemi mësuar deri tani për qarkun, duke u drejtuar nxënësve disa nga pyetjet e mëposhtme:

- Çka është qarku elektrik?
- Cilat janë elementet e një qarku elektrik?

BATERIA



LLAMBA



NDËRPRERËSI



TELAT PËRÇUES



1. Vizatoni në katrorin e mëposhtëm një qark të thjeshtë elektrik dhe shkruani pjesët nga të cilat ndërtohet ai.



2. Plotëso fjalitë.

a) Materialet përcuese më të mira elektrike janë \_\_\_\_\_

b) Sot, përcuesi elektrik më i përdorur është \_\_\_\_\_

3. Nën secilën figurë, shkruaj cili material është përcues e cili jopërcues (rezistent ndaj përcuarjes) i rrymës elektrike.

Materialet që \_\_\_\_\_



Materialet që \_\_\_\_\_



4. Shkruaj mjetet dhe materialin e nevojshëm për ndërtimin e qarkut elektrik të mbyllur.

---

---

---

47



**Ndërtimi i njohurive:**

**Përpunimi i përmbajtjes**

*Demonstrim përmes punës praktike*

Hapen fletoret e punës në f. 46. Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur sipas kërkesës së dhënë në ushtrimin 1. Më pas u tregohet nxënësve se sot do të ndërtojnë një qark elektrik. Fillimisht vendosen mbi tavolinë të gjitha mjetet që duhen për ta ndërtuar qarkun elektrik. Emërtohen të gjitha elementet që do të përdoren si: bateria, përcjellësi, llamba, telat përcues. Ndahen nxënësit në grupe dhe secili grup vendos mbi banka materialet e nevojshme për ta ndërtuar qarkun elektrik. Ndhimohen nxënësit, duke u shtruar pyetje rreth ndërtimit të qarkut elektrik.



**Përforcimi:**

**Konsolidimi i të nxënit**

*Pyetje-përgjigje*

Secili grup do ta prezatojë punën e vet, duke u ndihmuar nga pyetjet që u shtrohen nxënësve që prezantimi të bëhet më lehtë.

- Çfarë ndërtuat?
- Cilat mjete përdorët për ta ndërtuar qarkun elektrik?

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për rikujtimin e njohurive të marra për qarkun elektrik, ndërtimin e qarkut, si dhe prezantimin e punës së bërë.

### Detyrë:

Vizatoni qarkun elektrik dhe emërtoni pjesët e tij.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---

---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Bashkëveprimi elektrik dhe magnetik

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Identifikon pajisjet e përditshme në shtëpi që punojnë me rrymë, qarkun e shkurtër dhe rrezikun nga rryma elektrike.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** III.1, 2, 4; V.8; VI.9.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.5; 2.6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Pajisjet që punojnë me rrymë dhe rreziku nga rryma elektrike

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përshkruan disa pajisje që funksionojnë me energji elektrike në shtëpi;
- Identifikon pajisje të thjeshta elektrike;
- Tregon si zbatohen rregullat e sigurisë gjatë punës me pajisje elektrike për t'u mbrojtur nga rreziqet e mundshme.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, fletorja e punës, foto etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënët**  
 Parashikim me terma paraprakë

Në tabelë shkruhen fjalët: *televizor, rrobalarëse, fshesë elektrike, shporet elektrik*. Nxënësit, duke përdorur këto fjalë, bëjnë një përshkrim të shkurtër. Më pas i lexojnë ato.

**Pyesim:**

- Përse i përdorim këto pajisje?
- Si funksionojnë këto pajisje?

32 Pajisjet që punojnë me rrymë dhe rreziku nga rryma elektrike

Ju sigurisht që keni pajisje në shtëpi të cilat vihen në punë përmes energjisë elektrike. Këtyre pajisjeve, që u duhet rryma që të vihen në punë, u themi pajisje elektrike. Ato zakonisht përbëhen nga një ose më shumë qarqe të ndryshme elektrike, përkatësisht përçues, llamba, ndërprerës energjie etj. Disa nga pajisjet që funksionojnë me energji elektrike dhe që i përdorni në shtëpitë tuaja janë: televizori, frigoriferi, hekuri për hekurosje, fshesa elektrike, aparati i kafesë, shporet elektrik, rrobalarësja, enëlarësja etj.




Pajisjet që funksionojnë me energji elektrike



### Rreziqet nga energjia elektrike!

Kur përdorni pajisje elektrike, duhet të tregoheni shumë të kujdesshëm, sepse ato mund të jenë të rrezikshme dhe t'ju shkaktojnë lëndime ose vdekje. Jini të kujdesshëm: mos i prekni telat e zbuluar të rrymës elektrike, pajisjet e dëmtuara, pajisjet e lagura nga uji etj., sepse mund të goditeni nga rryma, siç tregohet në figurë.



Rreziku nga rryma



1. Çfarë janë pajisjet elektrike?
2. Trego disa nga pajisjet që funksionojnë me energji elektrike e që i përdorni në shtëpitë tuaja.
3. Në cilat raste jemi të rrezikuar nga rryma elektrike?

70



### Ndërtimi i njohurive:

#### Përpunimi i përmbajtjes

*Hulumtim, shqyrtim i përbashkët*

Hapen librat në f. 69. Vëzhgohen figurat e dhëna në tekst. Më pas emërtohen pajisjet e dhëna si më poshtë: *fshesa elektrike, peshorja, frigoriferi, televizori, hekuri për hekurosje, aparati i kafesë, rrobalarësja, enëlarësja* etj.

Nxiten nxënësit të diskutojnë për pajisjet që ata i kanë në shtëpitë e tyre e të cilat vihen në punë përmes energjisë elektrike, të cilave u themi pajisje elektrike.

Po ashtu, diskutohet për rrezikun që mund të na shkaktojnë pajisjet elektrike nëse nuk tregohemi të kujdesshëm gjatë përdorimit të tyre.



### Përforcimi:

#### Konsolidimi i të nxënit

*Shkrim i shpejtë*

Nxiten nxënësit të shikojnë dhe diskutojnë rreth figurave të dhëna në tekst, të cilat tregojnë për rrezikun nga rryma elektrike. Pasi të diskutohet rreth këtyre figurave, nxënësit do të shkruajnë disa rregulla të sigurisë, të cilat i zbatojnë gjatë përdorimit të pajisjeve elektrike në shtëpi.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përshkrimit të pajisjeve elektrike, si dhe shkrimin e rregullave të sigurisë gjatë përdorimit të pajisjeve elektrike.

### Detyrë:

Punohet ushtrimi 1, në fletore pune, f. 48.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---

---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Bashkëveprimi elektrik dhe magnetik

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Shpjegon me demonstrim veprimin magnetik të magnetit në mjedise dhe dallon lëndët që magnetizohen nga ato që nuk magnetizohen.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; III.4, 7, VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Veprimi magnetik

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Klasifikon, përmes vrojtimit, materialet magnetike dhe ato jomagnetike;
- Tregon formën dhe përbërjen e magnetëve;
- Përcakton polet e magnetit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, magnetë me pole të ndryshme, topi, shishe plastike, interneti etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë:**  
*Demonstrim përmes punës praktike*

Mbi tavolinë vendoset një lugë e madhe metal. Pyeten nxënësit:

- Si mund ta bëjmë lugën të lëvizë?

1. *Mund ta shtyjme.* Një nxënës e shtyn atë, duke i ndërruar vendin.

2. *Mund ta tërheqim.* E tërheq në drejtim të vetes një nxënës.

- A ka ndonjë mënyrë që luga të lëvizë pa e prekur?


Nëse nuk marrim përgjigje nga nxënësit, atëherë mësuesi/ja afron magnetin pranë saj dhe nxënësit komentojnë lëvizjen. U tregohet magneti dhe përcaktohet përbërja e tij.

Pra, ky lloj metal ka një veti të veçantë për të tërhequr trupa të tjerë.


Në këtë mënyrë veprohet edhe me një top plastik, për të ardhur në përfundim se topi, për dallim nga luga, nuk magnetizohet.

33 Veprimi magnetik

Veprimi magnetik (magnetizmi) është forca që tërheq objektet magnetike. Objektet që kanë këto forca quhen magnetë. Nëse dy magnetë i vendosim afër njëri-tjetrit, ata tërhiqen mes vete. Magnetët tërheqin edhe metalet me veti magnetike.



Magneti i tërheq metalet me veti magnetike.



Tërheqja e magnetëve mes vete

Varësisht prej strukturës së ndërtimit, disa lëndë magnetizohen kur janë në kontakt me një magnet tjetër, ndërsa materiale të tjera nuk magnetizohen.

Disa prej materialeve, p.sh. çeliku, mund të magnetizohet dhe të kalojë në magnet të përhershëm, ndërsa të tjerat, p.sh. gozhda, piruni, thika e hekurt gjithashtu magnetizohen kur janë në kontakt me magnetin, por ata humbin vetitë e tyre magnetike pasi të largohen nga magneti. Në këtë rast kemi magnetizim të përkohshëm. Vetë magnetike (që tërhiqen nga magnetët) kanë disa lëndë, si: hekuri, nikeli dhe kobalti.



Disa lëndë të tjera nuk tërhiqen nga magneti, por edhe nuk magnetizohen kur janë në kontakt me magnetë. Këto lëndë quhen lëndë jomagnetike, si plastika, goma, uji, por edhe shumë metale si bakri, alumini, bronzi, kallaji, argjendi dhe plumbi.



1. Çfarë është veprimi magnetik?
2. Çfarë janë lëndët që magnetizohen e çfarë ato që nuk magnetizohen?
3. Trego disa nga lëndët që magnetizohen dhe disa që nuk magnetizohen.

72



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes Veprimtari e drejtuar

Hapen librat në f. 71. Vëzhgohen figurat, lexohet dhe diskutohet pjesa e parë e mësimit. Në tabelë shkruhen këto pika:

- Magneti është metal që tërheq metale me veti magnetike.

- Ka formë të ndryshme si: shufër, formën si U-ja, sferike, gjilpërë.

- Ka dy pole: veri, që shënohet me të kaltër, dhe jug, që shënohet me të kuqe.


Më pas, lexohet pjesa e dytë dhe diskutohet për materialet që tërhiqen nga magneti dhe lëndët e tjera që nuk tërhiqen nga magneti.

- Po cilat lëndë nuk magnetizohen?



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit Harta e konceptit

Plotësohet harta e konceptit në grupe dhe lexohet.



### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e klasifikimit të materialeve që magnetizohen dhe atyre që nuk magnetizohen, si dhe dallimin e poleve dhe formave magnetike.

### Detyrë:

Punohen pyetjet në libër, f. 72

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Bashkëveprimi elektrik dhe magnetik

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Ndërton elektromagnetin e thjeshtë dhe demonstroi vetitë magnetike të tij.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** I.3; II.4; III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Elektromagneti i thjeshtë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Tregon se cilat pajisje nevojiten për ndërtimin e elektromagnetit të thjeshtë;
- Përshkruan mënyrën e ndërtimit të një elektromagnetit të thjeshtë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, bateria, teli i bakrit, një gozhdë, interneti.


**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë shqipe, Shkathësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë:**  
*Stuhi mendimesh*

Në tabelë shkruhet fjala “magnetët” dhe lihen nxënësit të shkruajnë fjalë që kanë lidhje me të.




Po ashtu, pyeten nxënësit se çfarë dinë për elektromagnetin, si dhe përdorimin e tij në jetën e përditshme.

34 Elektromagneti i thjeshtë

Si mund të ndërtohet një elektromagnet i thjeshtë dhe si të demonstrohen vetitë magnetike të tij?

Pajisjet që nevojiten për ndërtimin e një elektromagnetit janë: bateria, teli i bakrit, një gozhdë. Teli i bakrit duhet të përdridhet në formë spiraleje rreth gozhdës, pastaj në njërin anë teli lidhet në bateri te shenja +, ndërsa në anën tjetër lidhet te shenja -. Në momentin kur bëhet lidhja, te pjesa e spirales ku është e vendosur gozhdja, krijohet fusha magnetike dhe ndodh tërheqja e trupave magnetizues, siç tregohet në figurë.




Elektromagneti i thjeshtë

1. Emërto pajisjet që nevojiten për ndërtimin e elektromagnetit të thjeshtë.
2. Përshkruaj mënyrën e ndërtimit të një elektromagnetit të thjeshtë.

## 34 Elektromagneti i thjeshtë

Si mund të ndërtohet një elektromagnet i thjeshtë dhe si të demonstrohen vetitë magnetike të tij?

Pajisjet që nevojiten për ndërtimin e një elektromagneti janë: bateria, teli i bakrit, një gozhdë. Teli i bakrit duhet të përdridhet në formë spiraleje rreth gozhdës, pastaj në njërin anë teli lidhet në bateri te shenja +, ndërsa në anën tjetër lidhet te shenja -. Në momentin kur bëhet lidhja, te pjesa e spirales ku është e vendosur gozhda, krijohet fusha magnetike dhe ndodh tërheqja e trupave magnetizues, siç tregohet në figurë.



Elektromagneti i thjeshtë

1. Emërto pajisjet që nevojiten për ndërtimin e elektromagnetit të thjeshtë.
2. Përkrahuj mënyrën e ndërtimit të një elektromagneti të thjeshtë.

73



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

*Demonstrim përmes punës praktike*

Hapen librat në f. 73. Lexohet informacioni i dhënë në tekst për ndërtimin e elektromagnetit të thjeshtë.

- Mbi tavolinë vendosen pajisjet për ndërtimin e elektromagnetit si: bateria, teli i bakrit, një gozhdë.
- Demonstron ndërtimin e elektromagnetit.
- Teli i bakrit duhet të përdridhet në formë spiraleje rreth gozhdës.
- Pastaj, në njërin anë, teli lidhet në bateri te shenja +, ndërsa në anën tjetër lidhet te shenja -.
- Në momentin kur bëhet lidhja, te pjesa e spirales ku është e vendosur gozhda, krijohet fusha magnetike.
- Ndodh tërheqja e trupave magnetizues, në këtë rast kapëset e letrave.



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënësve

*Ditari dypjesësh*

Nxënësit vizatojnë dhe shkruajnë për pajisjet që nevojiten për ndërtimin e elektromagnetit dhe mënyrën e ndërtimit të tij. Punimet e nxënësve lexohen.

Pajisjet për ndërtimin e elektromagnetit	Mënyra e ndërtimit të elektromagnetit

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për angazhimin në dhënien e përgjigjeve se cilat mjete nevojiten për ndërtimin e elektromagnetit, si dhe për mënyrën e ndërtimit të tij.

### Detyrë:

Ndërtoni një elektromagnet të thjeshtë.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

**ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Bashkëveprimi elektrik dhe magnetik

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Shpjegon me demonstrim veprimin magnetik të magnetit në mjedise dhe dallon lëndët që magnetizohen nga ato që nuk magnetizohen.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; III.4; III.7; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I.5.

**ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Njësia mësimore:** Veprimi magnetik - Fletore pune

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Dallon lëndët që magnetizohen nga ato që nuk magnetizohen;
- Shpjegon veprimin magnetik të magnetit në mjedise;
- Ndërton elektromagnetin e thjeshtë, duke demonstruar vetitë magnetike të tij.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, fletorja e punës, magnetë me pole të ndryshme, topi, shishe plastike, interneti etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

**METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS**

**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënët**  
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Në tabelë shkruhet fjala *magneti* dhe pyeten nxënësit:


- Çështje magneti?
- Çfarë mund të bëjë ai?

Para tabelës vendoset një bankë dhe mbi të disa gjilpëra. Kërkohet prej njërit prej nxënësve t'i mbledhë ato. Më pas, një nxënësi tjetër i japim një magnet në dorë dhe e shikojmë se sa gjilpëra dhe për sa kohë do t'i mbledhë ato.

**VEPRIMI MAGNETIK**

1. Lëndët magnetike janë ato lëndë që tërhiqen nga \_\_\_\_\_, ndërsa lëndët që nuk i tërheq një magnet janë lëndë \_\_\_\_\_.
2. Plotëso tabelën, duke renditur lëndët magnetike dhe ato jomagnetike.

Lëndë magnetike	Lëndë jomagnetike



**3. Ndërto një elektromagnet të thjeshtë në shtëpi** dhe demonstroji vetitë magnetike të tij në shkollë, së bashku me shokët/shoqet e klasës.

Mjetet dhe materialet e nevojshme: **bateria, një tel bakri, një gozhde.**

**Mënyra e ndërtimit:** teli i bakrit duhet të përdridhet në formë spiraleje rreth gozhdës, pastaj në njërin anë teli lidhet në bateri te shenja +, ndërsa në anën tjetër lidhet te shenja -. Në momentin kur bëhet lidhja, te pjesa te spirala ku është e vendosur gozhda, krijohet fusha magnetike dhe ndodh tërheqja e trupave magnetizues.

**VËREJTJE!**  
 Gjatë ndërtimit të elektromagnetit të thjeshtë duhet të përdoret bateria (D) me voltazh të vogël (1.5 volt), që të mos paraqitet ndonjë rrezik. Kujdes! Eksperimentin kryejini në praninë e një të rrituri!



## VEPRIMI MAGNETIK

33

1. Lëndët magnetike janë ato lëndë që tërhiqen nga \_\_\_\_\_, ndërsa lëndët që nuk i tërheq një magnet janë lëndë \_\_\_\_\_.

2. Plotëso tabelën, duke renditur lëndët magnetike dhe ato jomagnetike.

Lëndë magnetike	Lëndë jomagnetike



3. Ndërto një elektromagnet të thjeshtë në shtëpi dhe demonstroji vetitë magnetike të tij në shkollë, së bashku me shokët/shoqet e klasës.

Mjetet dhe materialet e nevojshme: **bateria, një tel bakri, një gozhdë.**

**Mënyra e ndërtimit:** teli i bakrit duhet të përdridhet në formë spiraleje rreth gozhdës, pastaj në njërin anë teli lidhet në bateri te shenja +, ndërsa në anën tjetër lidhet te shenja -. Në momentin kur bëhet lidhja, te pjesa te spiralja ku është e vendosur gozhda, krijohet fusha magnetike dhe ndodh tërheqja e trupave magnetizues.

### VËREJTJE!

Gjatë ndërtimit të elektromagnetit të thjeshtë duhet të përdoret bateria (D) me voltazh të vogël (1.5 volt), që të mos paraqitet ndonjë rrezik. Kujdes! Eksperimentin kryejini në praninë e një të rrituri!

49



### Ndërtimi i njohurive:

#### Përpunimi i përmbajtjes

*Mbajtja e strukturuar e shënimeve*

Hapen fletoret e punës. Punohen ushtrimet e dhëna.

Ushtrimi 1. Plotësohet fjalia me fjalët që mungojnë.

Ushtrimi 2. Plotësohet tabela, duke renditur lëndët magnetike dhe ato jomagnetike.

Lëndët magnetike	Lëndët jomagnetike
piruni, gozhda, thika	plastika, goma, uji
hekuri, nikeli, kobalti	bakri, alumini, kallaji, argjendi, plumbi

Pasi të përfundohen ushtrimet, lexohen nga nxënës të ndryshëm.



### Përforcimi:

#### Konsolidimi i të nxënës

*Demonstrim përmes punës praktike*

Mbi tavolinë vendosen mjetet dhe materialet si: bateria, një tel bakri, një gozhdë. Demonstronhet para nxënësve mënyra e ndërtimit të elektromagnetit sipas udhëzimeve të dhëna në libër. Më pas, ndërtimi i elektromagnetit demonstronhet edhe nga nxënës të ndryshëm, me qëllim që nxënësit e tjerë ta kenë më lehtë ndërtimin e elektromagnetit në shtëpitë e tyre.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për dallimin e lëndëve që magnetizohen nga ato që nuk magnetizohen, shpjegimin e veprimit magnetik në mjedise, si dhe demonstrimin e ndërtimit të elektromagnetit.

### Detyrë:

Ndërtoni një elektromagnet të thjeshtë në shtëpi.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Vendi dhe hapësira

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Shpjegon pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, lëvizjet e Tokës, të Diellit, Hënës dhe të trupave të tjerë të këtij sistemi dhe përshkruan mënyrat kryesore të orientimit në natyrë (nëpërmjet Diellit, busullës, Yllit Polar, Hënës, orës së dorës, hijes së mesditës, objekteve, drurëve etj.).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** III.1, 4, VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.5; 2.6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Pozita e Tokës në Sistemin Diellor

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Shpjegon pozitën e Tokës në Sistemin Diellor;
- Përshkruan çfarë fenomenesh ndodhin në Tokë nga lëvizja dhe pozicioni i saj rreth Diellit;
- Tregon kohën e rrotullimit të Tokës rreth boshtit të vet dhe rreth Diellit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, interneti etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

*Stuhi mendimesh*

Në tabelë vendosen figurat e planetëve që formojnë Sistemin Diellor. Nxiten nxënësit t'i emërtojnë figurat.


Shtrohen pyetjet si:

- Çfarë janë figurat që emërtuat?
- Çfarë formojnë ata?
- Rreth kujt sillen ata?
- Ku ndodhet Toka sipas largësisë nga Dielli?

35 VENDI DHE HAPËSIRA  
Pozita e Tokës në Sistemin Diellor

Sistemi Diellor përbëhet nga Dielli dhe gjithçka që sillet përreth tij, përfshirë dhe Tokën. Lëvizjet e Tokës dhe pozita e saj në raport me Diellin ndikojnë në fenomene të ndryshme në Tokë, si: ndryshimet ditë-natë, ndërrimi i stinëve, baticat dhe zboticat etj.

Ju tashmë e dini që Toka ka formë elipsoide (si të rrumbullakët, të shtypur në pole). Ajo sillet vazhdimisht rreth boshtit të vet dhe mundëson ndërrimet ditë-natë. Ditë është kur pjesa e Tokës (ku gjendeni ju) është e kthyer nga Dielli, ndërsa natë është kur pjesa e Tokës është e kthyer nga ana e kundërt e Diellit (errësira), prandaj Diellin nuk mund ta shohim natën, sepse ai gjendet në anën e kundërt me vendin ku gjendeni ne.




Lëvizja e Tokës rreth Diellit mundëson ndërrimet ditë-natë dhe stinët

Kur shikojmë qiellin, Dielli duket se lëviz nga njëri skaj te skaji tjetër i qiellit. Në të vërtetë, është Toka ajo që lëviz, por meqë ne jetojmë në Tokë na duket e kundërta.

*Dielli lind çdo ditë, qielli bëhet i ndritshëm, ai perëndon në mbrëmje dhe qielli bëhet i errët.*

Kjo është ajo çka ndodh gjatë një rrotullimi të plotë të Tokës rreth boshtit të vet, i cili zgjat 24 orë, që sjell ndryshimet ditë-natë. Pos rrotullimit të Tokës rreth boshtit të vet, thamë që rrotullohet edhe rreth Diellit. Për t'u rrotulluar rreth Diellit, Tokës i duhet një vit. Ndryshimet e Tokës në raport me Diellin gjatë këtij rrotullimi përcillen me ndryshimet e stinëve në Tokë.



Pozita e Tokës në Sistemin Diellor



1. Çfarë e përbën Sistemin Diellor?
2. Çfarë fenomenesh ndodhin në Tokë nga lëvizja dhe pozicioni i saj rreth Diellit?
3. Pse nuk mund ta shohim Diellin natën?

76



**Ndërtimi i njohurive:**  
**Përpunimi i përmbajtjes**  
*INSERT*

Hapen librat në f. 72. Njohuritë e reja do të merr-  
en duke lexuar mësimin me vëmendje dhe duke  
shënuar te çdo paragraf simbolet e mëposhtme.  
Pasi lexohet dhe plotësohet me simbole teksti,

e dija këtë	e dija ndryshe	nuk e kuptoj	nuk e dija
✓	-	?	+

plotësohet tabela e mësipërme në fletore. Nxë-  
nësit në tabelë do të shkruajnë idetë kryesore  
dhe jo tërë paragrafin.

Pasi nxënësit ta mbarojnë detyrën, paraqitet në  
mënyrë të strukturuar mësimi. Në kolonën e  
tretë sqarohen paqartësitë e nxënësve.



**Përforcimi:**  
**Konsolidimi i të nxënit**  
*Copëza të përziera*

Jepen përkufizimet kryesore në formën e përzier. Nxënësit i renditin saktë etiketat e fjalëve, diskutojnë  
dhe i lexojnë ato. Secili grup ka përkufizime të ndryshme.

të shtypur

elipsoide

Toka

në pole

ka formë

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari, shpjegimin e pozitës së Tokës, emërtimin e  
planetëve në Sistemin Diellor, si dhe përshkrimin e fenomeneve që ndodhin në Tokë, nga lëvizja dhe  
pozicioni i saj rreth Diellit.

**Detyrë:**

Modeloni Sistemin Diellor.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Vendi dhe hapësira

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Shpjegon pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, lëvizjet e Tokës, të Diellit, Hënës dhe të trupave të tjerë të këtij sistemi dhe përshkruan mënyrat kryesore të orientimit në natyrë (nëpërmjet Diellit, busullës, Yllit Polar, Hënës, orës së dorës, hijes së mesditës, objekteve, drurëve etj.).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** III.1; III.4; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.5; 2.6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Pozita e Tokës në Sistemin Diellor - Fletore pune

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Shpjegon pozitën e Tokës në Sistemin Diellor;
- Përshkruan fenomenet që ndodhin në Tokë nga lëvizja dhe pozicioni i saj rreth Diellit;
- Modelon Sistemin Diellor.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

*Tryeza e rrumbullakët*

Në tabelë shkruhet: *Pozita e Tokës në Sistemin Diellor.*

Nxënësit, të ulur në grupe, shkruajnë nga një fjali në një fletë, në lidhje me temën. Fleta kalon me radhë te çdo anëtar i grupit. Fjalitë nuk duhet të përsëriten, prandaj nxënësit duhet të jenë të vëmendshëm kur shkruan shoku. Secili mund të shkruajë me ngjyra të ndryshme. Kjo mënyrë do të shërbejë për t'i rikujtuar njohuritë e mësimi të mëparshëm. Kur mbaron puna, lexohen fjalitë. Ato mund të jenë:

*Sistemi Diellor përbëhet nga Dielli dhe gjithçka që sillet përreth tij, përfshirë edhe Tokën.*


VENDI DHE HAPËSIRA

POZITA E TOKËS NË SISTEMIN DIELLOR

1. Sa planetë e ndërtojnë Sistemin Diellor? \_\_\_\_\_. Shkruaji emrat e tyre në tabelën poshtë:


2. Për sa ndodh rrotullimi i Tokës rreth Diellit (shih ilustrimin poshtë)?

- a) 1 ditë;
- b) 1 vit;
- c) 1 stinë;
- d) 1 natë.



## VENDI DHE HAPËSIRA


POZITA E TOKËS NË SISTEMIN DIELLOR

34

1. Sa planetë e ndërtojnë Sistemin Diellor? \_\_\_\_\_ . Shkruajni emrat e tyre në tabelën poshtë:


2. Për sa ndodh rrotullimi i Tokës rreth Diellit (shih ilustrimin poshtë)?

- a) 1 ditë;
- b) 1 vit;
- c) 1 stinë;
- d) 1 natë.



51

*Toka ka formë elipsoide.*

*Toka sillet rreth boshtit të vet dhe mundëson ndër-*

*rimet ditë-natë.*

*Rrotullimi i Tokës rreth boshtit të vet zgjat 24 orë.*

*Për t'u rrotulluar rreth Diellit, Tokës i duhet një vit.*



**Ndërtimi i njohurive:**

**Përpunimi i përmbajtjes**

*Vëzhgo - analizo*

Hapen fletoret e punës në f. 51. Punohen ushtrimet e dhëna.

Ushtrimi 1. Nxënësit shkruajnë numrin e planetëve që e ndërtojnë Sistemin Diellor. Më pas shkruajnë emrat e tyre në tabelën e dhënë.

Ushtrimi 2. Vëzhgohet dhe analizohet figura e dhënë. Pastaj nxënësit rrethojnë përgjigjen e saktë.



**Përforcimi:**

**Konsolidimi i të nxënit**

*Turi i galerisë*

Nxënësit ndahen në grupe dhe modelojnë Sistemin Diellor me plastelinë dhe me mjete të tjera. Tregojnë se Dielli është i palëvizshëm; Toka dhe planetët rrotullohen rreth tij.

Punimet e nxënësve vendosen në tabelë ose në murin e klasës.



### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për shpjegimin e pozitës së Tokës në Sistemin Diellor, përshkrimin e fenomeneve që ndodhin në Tokë, si dhe modelimin e Sistemit Diellor.

**Detyrë:**

Vizatoni Sistemin Diellor.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Vendi dhe hapësira

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Shpjegon pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, lëvizjet e Tokës, të Diellit, Hënës dhe të trupave të tjerë të këtij sistemi dhe përshkruan mënyrat kryesore të orientimit në natyrë (nëpërmjet Diellit, busullës, Yllit Polar, Hënës, orës së dorës, hijes së mesditës, objekteve, drurëve etj.).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1; III.3; III.4; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Orientimi në natyrë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Tregon pse është e rëndësishme të dimë të orientojemi në natyrë;
- Shpjegon se cilat janë mënyrat e orientimit në natyrë;
- Përcakton katër anët e horizontit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, busulla, harta, ora e dorës, interneti etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë:**

*Diskutim për njohuritë paraprake*

Në tabelë shkruhet:

Pyeten nxënësit:

- Ç'është të thotë të orientojesh në natyrë?
  - Pse është e rëndësishme të dimë të orientojemi?
  - Cilat mjete na ndihmojnë të orientojemi në natyrë?
- Nxënësit japin përgjigjen në bazë të njohurive që kanë.

36 Orientimi në natyrë

Të dilni dhe ta "eksploroni" natyrën është një mënyrë e shkëlqyeshme për t'i shijuar bukuritë natyrore dhe për të marrë energji. Ndonjëherë nisemi për një vend të caktuar e ndonjëherë vetëm dalim për shëtitje. E rëndësishme është që të dimë se si ta gjejmë vendin që duam ose si të kthehemi në shtëpi pastaj. Gjetja e drejtimit quhet **orientim**. Drejtimit kryesore se nga mund të shkoni janë: veriu, lindja, jugu dhe perëndimi.



Në natyrë mund të orientojeni duke përdorur pozitën e Diellit gjatë ditës apo Yllit Polar gjatë natës. Po ashtu, mund të orientojeni edhe me **busull**. Busulla është mjet që na mundëson gjetjen e drejtimit.

*Orientimi përmes busullës*

Orientimi pa busull mund të jetë i ndërlikuar, por nëse ajo ju mungon, është e domosdoshme ta gjeni drejtimin duke përdorur elemente të ndryshme të natyrës. Për një fillestar, mënyra më e lehtë për t'u orientuar pa busull në natyrë do të ishte përdorimi i një **harte**. Në hartë duhen kërkuar vende specifike: kodra, shtigje, ndonjë lumë, dhe pastaj të përdoren si *pika orientuese*.




*Orientimi me ndihmën e hartës*



### Si të orientohehi natën?

Gjatë natës, orientohehi duke përdorur **yjet**. Gjetja e drejtimit me ndihmën e yjeve është shumë e shpejtë, e lehtë dhe shumë më argëtuese. Për t'u orientuar në këtë mënyrë, së pari duhet të gjeni një grup me shtatë yje. Në qiell dalloni dy grupe yjesh të përbëra me nga shtatë yje. Njëri grup quhet "Arusha e Madhe", tjetri "Arusha e Vogël".


Katër prej yjeve formojnë harkun, ndërsa tre të tjerët formojnë një dorezë. Ylli i fundit i dorezës së "Arushës së Madhe" është në drejtim të yllit të fundit të harkut të "Arushës së Vogël". Ylli i fundit i "Arushës së Vogël" është Ylli Polar (Ylli i Veriut) që na tregon drejtimin e veriut. Ai nuk e ndërron asnjëherë pozitën, prandaj është i përshtatshëm për orientim. Mënyra e identifikimit të drejtimit të veriut duke përdorur Yllin Polar (Yllin e Veriut) është shumë e lashtë.



Dy grupet me nga shtatë yje që quhen "Arusha e Madhe" dhe "Arusha e Vogël"

### Orientimi përmes Hënës

Orientimi me ndihmën e Hënës është një metodë që funksionon vetëm nëse Hëna është në fazat e gjysmehënës. Fazat e gjysmehënës zakonisht ndodhin në fillim dhe në fund të muajit. Vizatoni një vijë imagjinare nga "brirët" e Hënës në horizont. Duke vështruar Hënën, përfytyroni një vijë nga dy pikat e gjysmehënës që shkon deri në fund të horizontit, si në figurë. Ky orientim nuk është plotësisht i saktë.



Orientimi me ndihmën e Hënës

78



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes Pyetja sjell pyetjen

Hapen librat në f. 77 dhe nxënësit fillojnë ta lexojnë njësinë mësimore. Pasi të lexohet teksti, shtrohen pyetjet:

- Si quhet gjetja e drejtimit?
- Cilat janë drejtimet kryesore se nga mund të shkoni?
- Po pozitën e Diellit dhe Yllit Polar, kur mund ta përdorim për orientim?

Vazhdohet me pyetje:

- Çfarë është busulla?
- Për çfarë shërben ajo?
- Po hartën, kur mund ta përdorim?
- Cilat vende duhen kërkuar në hartë që të orientohehi më lehtë?
- Po natën, si orientohehi?

Përgjigjet e nxënësve plotësohen edhe me informacione shtesë.



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit Demonstrim përmes punës praktike

Së bashku me nxënësit, kujtojmë drejtimet kryesore tek orientimi. Pastaj ftohet një nxënës të dalë para tabelës, hap krahët dhe kthehet me fytyrë nga Dielli që tregon lindjen. Pas tij është perëndimi, në të majtë është veriu, kurse në të djathtë është jugu. Ky aktivitet përsëritet nga nxënës të ndryshëm.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e shpjegimit të mënyrave të orientimit në natyrë, si dhe përcaktimin e drejtimeve të orientimit.

### Detyrë:

Punohen pyetjet në libër, f. 80.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Vendi dhe hapësira

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Shpjegon pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, lëvizjet e Tokës, të Diellit, Hënës dhe të trupave të tjerë të këtij sistemi dhe përshkruan mënyrat kryesore të orientimit në natyrë (nëpërmjet Diellit, busullës, Yllit Polar, Hënës, orës së dorës, hijes së mesditës, objekteve, drurëve etj.).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1; III.1; III.4; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Orientimi në natyrë - Fletore pune

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Liston mënyrat e orientimit në natyrë;
- Dallon objektet me anë të të cilave orientohemi;
- Përshkruan mënyrën e orientimit gjatë një udhëtimiti.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

*Pema e mendjes*

Ftohen nxënësit të listojnë mënyrat e orientimit në natyrë. Më pas, me emërtimet e tyre, ndërtohet “Pema e mendjes”.

35 ORIENTIMI NË NATYRË

1. Plotëso fjalitë.

- a) Gjetja e drejtimit se ku doni të shkoni quhet \_\_\_\_\_
- b) Mënyra më e lehtë për t'u orientuar në natyrë është \_\_\_\_\_
- c) Gjatë natës, orientohemi duke përdorur \_\_\_\_\_

2. Plotëso tabelën duke shënuar mënyrat e orientimit në natyrë dhe objektet me anë të të cilave orientohemi.

Mënyrat e orientimit në natyrë	Objektet me anë të të cilave orientohemi

3. Tregoni, nga përvoja juaj, se me çka orientoheni kur bashkë me familjen bëni udhëtime më të largëta.

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

## 35 ORIENTIMI NË NATYRË

1. Plotëso fjalitë.

- a) Gjetja e drejtimit se ku doni të shkoni quhet \_\_\_\_\_  
b) Mënyra më e lehtë për t'u orientuar në natyrë është \_\_\_\_\_  
c) Gjatë natës, orientohemi duke përdorur \_\_\_\_\_

2. Plotëso tabelën duke shënuar mënyrat e orientimit në natyrë dhe objektet me anë të të cilave orientohemi.

Mënyrat e orientimit në natyrë	Objektet me anë të të cilave orientohemi

3. Tregoni, nga përvoja juaj, se me çka orientoheni kur bashkë me familjen bëni udhëtime më të largëta.

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

52



**Ndërtimi i njohurive:**  
**Përpunimi i përmbajtjes**  
*Ditari dypjesësh*

Udhëzohen nxënësit ta hapin fletoren e punës në f. 52. Lexojnë kërkesat e detyrave të dhëna dhe i punojnë ato.

Detyra 1. Plotësohen fjalitë.

Detyra 2. Plotësohet tabela, duke shënuar mënyrat e orientimit dhe objektet me anë të të cilave orientohemi.

Mënyrat e orientimit në natyrë	Objektet me anë të të cilave orientohemi

Detyrat e përfunduara lexohen nga nxënësit të ndryshëm dhe gabimet e bëra korrigjohen.



**Përforcimi:**  
**Konsolidimi i të nxënit**  
*Shkrim i shpejtë*

Nxënësit do të shkruajnë se me çfarë orientohen

kur bashkë me familjen bëjnë udhëtime të largëta. Puna bëhet në mënyrë individuale e më pas diskutohet dhe vlerësohet në dyshe. Vlerësimi bëhet duke shënuar nga një koment.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për listimin e saktë të mënyrave të orientimit, dallimin e objekteve me anë të të cilave orientohen, si dhe përshkrimin e orientimit gjatë udhëtimeve.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Vendi dhe hapësira

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Identifikon dhe shpjegon mënyrat e ndryshme të paraqitjes së Tokës në hartë, glob dhe plan, duke treguar dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis tyre.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1; III.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I.6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Paraqitja e Tokës në hartë, në glob dhe në plan

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përshkruan mënyrat e paraqitjes së Tokës dhe elementeve të saj në hartë dhe glob;
- Tregon se cilat janë gjërat më të thjeshta që duhen mësuar në fillim në një hartë ose glob;
- Përshkruan hartën, globin dhe planin.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, harta, globi, plani, letra e bardhë, projektori.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

*Diskutim për njohuritë paraprake*

Me anë të projektorit paraqiten: globi, harta, plani i një lagjeje. Nxiten nxënësit t'i shikojnë me kujdes, më pas shtrohen pyetjet për diskutim si:

- Çfarë është globi?
- Po harta dhe plani?

Dëgjothen me kujdes përgjigjet e nxënësve, duke u plotësuar me informacione shtesë si: globi është një paraqitje e formës aktuale të Tokës në tërësi, ndërsa harta është një vizatim i sheshtë i një pjese ose i tërë sipërfaqes së Tokës.

37 Paraqitja e Tokës në hartë, në glob dhe në plan



Sipërfaqja e Tokës nuk është e rrafshët, ajo ka forma të ndryshme, si p.sh. male të larta, lugjina, dete, lumenj, liqene, ishuj etj. Paraqitja e këtyre formave (elementeve) të ndryshme të Tokës në një model të zvogëluar mund të bëhet përmes hartës, globit dhe planit.

Harta e një qyteti

**Harta** është një vizatim në të cilin paraqiten elementet (male, lugjina, dete, lumenj, liqene, ishuj etj.) më të rëndësishme gjeografike dhe objekte të ndërtuara nga njeriu (fabrika, hekurudha etj.) në një rajon ose në botë. Këto elemente paraqiten në hartë në formë të ngjyrave, pikave, vijave, simboleve, emrave etj. Varësisht se çfarë sipërfaqe tregon harta, ajo mund të jetë hartë e botës, e një kontinenti, e një shteti, e rajonit apo dhe e një qyteti.



Harta e botës



**Globi** është një model i rumbullakët që tregon formën e Tokës. Ai ndryshon nga një hartë në shumë aspekte:

- Globi është një paraqitje e formës aktuale të Tokës në tërësi, ndërsa harta është një vizatim i sheshtë i një pjese ose tërë sipërfaqes së Tokës.
- Globi ndërtohet nga materiale të forta, nuk mund të paloset dhe është më i vështirë për t'u bartur, ndërsa harta mund të paloset dhe të bartet lehtë me vete.
- Globi nuk ka detaje të mjaftueshme specifike për t'ju ndihmuar kur udhëtoni me automjete ose kur lundroni, ndërsa harta ka.

Globi

Një nga gjërat më të thjeshta që duhet mësuar në fillim në një hartë ose glob është të kuptuarit cili është ndryshimi midis tokës (pamjet kafe dhe gjelbër) dhe ujit (pamja e kaltër).

**Plani** është një kicë (vizatim) në të cilin paraqitet në mënyrë të detajuar një objekt, ndërtesë, fabrikë etj., apo një vend si: lagje, rrugë, qytet etj. Planet mund të përgatiten dhe shtypen në letër dhe të ruhen si të tilla, por ato mund të ruhen edhe në formën e një skedari digjital (komputerik). Qëllimi i planit është të paraqesë me saktësi të gjitha karakteristikat gjeometrike të objektit ose të vendit.



Përgatitja e një plani



Plani i një lagjeje

Së bashku me mësuesin/in, përdorni hartat që keni në dispozicion dhe analizoni secilin element që gjeni në to. Ka harta klimatike, topografike, politike etj. Mund t'ju duhet edhe atlas gjeografik, i cili është një libër që përmban harta me informacione të ndryshme në shumë aspekte.

- ?
1. Në çfarë mënyra paraqitet toka dhe elementet e saj në hartë dhe glob?
  2. Krahaso globin dhe hartën.
  3. Planet mundësojnë përshkrimin e një vendi ose objekti. Cilat janë ato dhe si i përshkruan?
  4. Cilat janë gjërat më të thjeshta që duhen mësuar në fillim në një hartë ose glob?

82



**Ndërtimi i njohurive:**  
**Përpunimi i përmbajtjes**  
*Lexim i drejtuar*

Hapen librat. Lexohet dhe diskutohet gjatë leximit mbi informacionet që jepen te njësia mësimore, për hartën, globin dhe planin. Një nxënës lexon paragrafin e parë, pastaj shtrohen pyetje:

- Çfarë është harta?
- Cilat janë elementet e saj?

Në këtë mënyrë punohet edhe me paragrafët e tjerë.



**Përforcimi:**  
**Konsolidimi i të nxënit**  
*Ditari dypjesësh*

Nxënësit do ta plotësojnë ditarin dypjesësh për të përshkruar hartën, globin dhe planin. Lexohen disa nga punimet e nxënësve.

	Përshkrimi
Harta	
Globi	
Plani	

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për përshkrimin e saktë dhe të qartë të mënyrave të paraqitjes së Tokës dhe elementeve të saj në hartë dhe glob, si dhe për përshkrimin e tyre.

**Detyrë:**

Punohen pyetjet në libër, f. 82.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

**ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE****Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës**Lënda:** Njeriu dhe natyra**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV**Tema:** Vendi dhe hapësira**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Identifikon dhe shpjegon mënyrat e ndryshme të paraqitjes së Tokës në hartë, glob dhe plan, duke treguar dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis tyre.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1; III.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I.6.

**ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Njësia mësimore:** Paraqitja e Tokës në hartë, në glob dhe në plan - Fletore pune

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përshkruan formën e Tokës;
- Dallon hartën, planin dhe globin;
- Krahason globin dhe hartën.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fletore pune, ngjyra, plani, globi, harta.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

**METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS****Parashikimi:****Përgatitja për të nxënë**

*Diskutim për njohuritë paraprake*

Shikojmë videon së bashku me nxënësit dhe më pas diskutojmë për pamjet që shohin në video. Videoja gjendet në vegëzën: <https://youtu.be/d5idsDkovZY>.

**PARAQITJA E TOKËS NË HARTË, NË GLOB DHE NË PLAN****36**

1. Plotëso fjalitë.

a) Harta është paraqitje e shumë elementeve të rëndësishme gjeografike të një \_\_\_\_\_, ose botës me anë të \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_.

b) Një glob është një paraqitje e formës \_\_\_\_\_ të Tokës, ndërsa një hartë është një \_\_\_\_\_ i Tokës.

c) Plani është një mënyrë që mundëson \_\_\_\_\_ e një vendi ose një objekti si ndërtesë, lagje, rrugë, fabrikë, qytet etj., përmes \_\_\_\_\_.

**2. Detyrë**

Vizato planin e dhomës suaj. Kjo do t'ju japë juve një ide se çfarë roli ka një hartë dhe do t'ju nxisë që të bëni dhe planin e shtëpisë, lagjes ose parkut të qytetit.

53



## PARAQITJA E TOKËS NË HARTË, NË GLOB DHE NË PLAN

36

1. Plotëso fjalitë.

- a) Harta është paraqitje e shumë elementeve të rëndësishme gjeografike të një \_\_\_\_\_, ose botës me anë të \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_;
- b) Një glob është një paraqitje e formës \_\_\_\_\_ të Tokës, ndërsa një hartë është një \_\_\_\_\_ i Tokës.
- c) Plani është një mënyrë që mundëson \_\_\_\_\_ e një vendi ose një objekti si ndërtesë, lagje, rrugë, fabrikë, qytet etj., përmes \_\_\_\_\_

### 2. Detyrë

Vizato planin e dhomës suaj. Kjo do t'ju japë juve një ide se çfarë roli ka një hartë dhe do t'ju nxisë që të bëni dhe planin e shtëpisë, lagjes ose parkut të qytetit.

53



**Ndërtimi i njohurive:**  
**Përpunimi i përmbajtjes**  
*Të nxënësit bashkëpunues*

Nxënësve u tregohen globi, harta dhe skica. Nxënësit janë të ndarë në tri grupe. Çdo grup i ka nga dy detyra:

Grupi i parë: 1. Përshkruaje globin.

2. Krahasoje me hartën.

Grupi i dytë: 1. Përshkruaje hartën.

2. Krahasoje me globin.

Grupi i tretë: 1. Përshkruaje planin.


2. Krahasoje me hartën dhe globin.

Pastaj plotësojnë pyetjet në fletore pune.



**Përforcimi:**  
**Konsolidimi i të nxënit**  
*Diagrami i Venit*

Udhëzohen nxënësit të shkruajnë të veçantat dhe të përbashkëtat e hartës dhe globit. Puna bëhet në dyshe.



### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë në përshkrimin e formës së Tokës, në dallimin e hartës, planit dhe globit.

### Detyrë:

Vizatojnë planin e shtëpisë ose të parkut.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---

---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Vendi dhe hapësira

**Rezultatet e të nxënësve të temës:**

Shpjegon përbërjen, ndërtimin e atmosferës dhe rëndësinë e saj për proceset në natyrë dhe jetën në Tokë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** II.8; III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I.6; 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ndikimet e Diellit në dukuritë natyrore të planetit Tokë

**Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:**

- Dallon ndikimin e Diellit në dukuritë natyrore;
- Interpreton proceset që ndodhin nga ndikimi i Diellit;
- Përshkruan baticën dhe zbaticën.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, fletore, ngjyra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhë shqipe, Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënësit**

*Imagjinata e drejtuar*

Në tabelë shkruhen fjalët Dielli, uji, batica, zbatica, stina, bota bimore dhe shtazore. Duke përdorur këto fjalë, nxënësit do të shkruajnë një ngjarje apo një informacion që ata e kanë lexuar apo e kanë dëgjuar. Pas 5 minutash, disa nga nxënësit lexojnë se çfarë kanë shkruar. Në tabelë shkruhen të dhënat e sakta që nxënësit i kanë shkruar.

38 Ndikimet e Diellit në dukuritë natyrore të planetit Tokë

Dielli është burimi i energjisë në Tokë. Ai ka ndikim të rëndësishëm në të gjitha dukuritë natyrore që ndodhin në planetin tonë: në qarkullimin e ujit në natyrë, ajrit, zhvillimin e botës bimore e shtazore, baticat e zbaticat, stinët, klimën etj.

Qarkullimi i ujit në natyrë


Uji është element i domosdoshëm për jetë (pa ujë, nuk ka jetë!), njëkohësisht ai paraqet edhe mjedisin në të cilin jetojnë shumë organizma të gjallë. Uji vazhdimisht qarkullon dhe gjatë këtij procesi ai ndryshon gjendjen e tij, nga e ngurta (akull) në të lëngët, nga e lëngët në të gaztë (avull) dhe anasjelltas. Ky qarkullim është i përhershëm dhe mundësohet nga energjia e diellit. Kur rrezet e diellit ngrohin borën lart në male, ajo shkrirhet dhe shndërrohet në ujë, i cili lëviz dhe shkon në përrunj dhe lumenj ose mbledhet në liqene, ujëra nëntokësore. Edhe ujërat që bien në formë shiu përfundojnë në përrunj e lumenj dhe përmes tyre uji shkon në dete dhe oqeanë. Uji në oqeanë dhe dete, si dhe nga sipërfaqja e tokës, por edhe nga bimët, vazhdimisht avullohet dhe krijon re të. Ato, në kontakt me masën e ftohtë të ajrit, kondensohen dhe mundësojnë reshjet në formë të shiut apo borës. Në këtë formë, uji vazhdimisht qarkullon në natyrë.



Qarkullimi i ujit në natyrë

### Ndikimi i Diellit në ajër

Ajri që na rrethon përbëhet nga gaze të ndryshme, por dhe grimca (p.sh. pluhuri). Rrezet e diellit, edhe pse kalojnë përmes ajrit, nuk e ngrohin atë. Energjia e rrezeve të diellit së pari ngroh ujin dhe sipërfaqen e tokës, pastaj nxehësia prej tyre kalon në ajër. Ajri nuk ngrohet në mënyrë të barabartë në të gjithë sipërfaqen e tokës dhe, për shkak të këtyre ndryshimeve, në temperaturën e ajrit krijohen ndryshime të motit në sipërfaqen e tokës.



Ngrohja e Tokës nga rrezet e diellit bën që ajri të ngrohet nga trupat e lëngët (1) dhe nga trupat e ngurtë (2).

### Batica dhe zbatia

Batica dhe zbatia nënkuptojnë ngritjen dhe uljen e rregullt të niveleve të deteve dhe oqeanëve dy herë në ditë. Kjo shkaktohet nga forca tërheqëse e gravitetit të Hënës dhe të Diellit. Edhe pse forca tërheqëse e Diellit është shumë herë më e madhe se e Hënës, efekti i Hënës në ngritjen dhe rënien e nivelit të ujit të detit është dy herë

84



**Ndërtimi i njohurive:**  
**Përpunimi i përmbajtjes**  
*Marrëdhëniet pyetje-përgjigje*

Hapin librin faqe 84, lexohet njësia mësimore.  
Pastaj parashtrohet pyetjet:

- Si ndikon Dielli në dukuritë natyrore që ndodhin në planetin tonë?
- Kush e mundëson qarkullimin e ujit në natyrë?
- Kë ngroh energjia e rrezeve të diellit?
- Sa herë brenda ditës ndodhin batica dhe zbatia?

Diskutohet bashkë me nxënësit, si dhe analizohen fotografitë në libër.



**Përforcimi:**  
**Konsolidimi i të nxënit**  
*Pesëvargëshi*

Shkruan në tabelë një pesëvargësh dhe e plotëson me mendimet e nxënësve.

Dielli

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë që tregojnë për ndikimin e Diellit në natyrë, interpreton se si Dielli ndikon në qarkullimin e ujit në natyrë, përshkruan rëndësinë e baticës dhe zbaties.

### Detyrë:

U përgjigjen pyetjeve 1-4, në faqen 85.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Vendi dhe hapësira

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Shpjegon përbërjen, ndërtimin e atmosferës dhe rëndësinë e saj për proceset në natyrë dhe jetën në Tokë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.8; III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I.6; 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ndikimet e Diellit në dukuritë natyrore të planetit Tokë - Fletore pune

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Dallon ndikimin e Diellit në dukuritë natyrore;
- Interpreton proceset që ndodhin nga ndikimi i Diellit;
- Përshkruan baticën dhe zbticën.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, ngjyra, fletore pune, fotografi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

*Gushëkuqi rrethor*


Nxënësit në grup japin mendimet e tyre për Diellin. Çdo nxënës duhet të thotë nga një fjali, duke ia dhënë fjalën shokut, i cili nuk e përsërit mendimin e të tjetrit. Kjo kërkon vëmendje nga i gjithë grupi. Idetë kryesore shkruhen në tabelë.

37

NDIKIMET E DIELLIT NË DUKURITË NATYRËRE TË PLANETIT TOKË

1. A e dini ju si ndikon Dielli në qarkullimin e ujit?

Plotëso vendet boshe në figurë që tregojnë qarkullimin e ujit.



2. A ngrohet ajri drejtpërdrejt nga Dielli apo në ndonjë mënyrë tjetër? Nga njohuritë e fituara deri tani, shkruaj si ndodh ky proces.

---



---

3. Pse është e rëndësishme njohja e baticave dhe e zbticave për marinarët, peshkatarët dhe pushuesit?


---



---

1. A e dini ju si ndikon Dielli në qarkullimin e ujit?

Plotëso vendet boshe në figurë që tregojnë qarkullimin e ujit.



2. A ngrohet ajri drejtpërdrejt nga Dielli apo në ndonjë mënyrë tjetër? Nga njohuritë e fituara deri tani, shkruaj si ndodh ky proces.

---



---

3. Pse është e rëndësishme njohja e baticave dhe e zbatave për marinarët, peshkatarët dhe pushuesit?

---



---



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes Vëzhgo - analizo

Lexohen pyetjet në libër.

- A e dini ju si ndikon Dielli në qarkullimin e ujit?
- A ngrohet ajri drejtpërdrejt nga Dielli apo në ndonjë mënyrë tjetër?
- Nga njohuritë e ftuara deri tani, shkruaj si ndodh ky proces.
- Pse është e rëndësishme njohja e baticave dhe e zbatave për marinarët, peshkatarët dhe pushuesit?

Së bashku me nxënësit, iu japim përgjigje pyetjeve.

Vëzhgohet me kujdes figura në libër dhe plotësohet.



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit Turi i galerisë

Nxënësit punojnë në dyshe qarkullimin e ujit në natyrë. Do të përdorin dhe foto që kanë sjellë. Në qendër do ta vendosin Diellin, pastaj qarkull-

imin e ujit në natyrë. Nëse nuk kanë fotografitë e duhura, nxënësit do t'i vizatojnë. Pasi mbarojnë nxënësit, punimet e tyre vendosen në mur ose në tabelë.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë që tregojnë për ndikimin e Diellit në natyrë, interpretimin se si Dielli ndikon në qarkullimin e ujit në natyrë, përshkruan rëndësinë e baticës dhe zbatës.

### Detyrë:

Vizatojnë qarkullimin e ujit në natyrë.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Vendi dhe hapësira

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Shpjegon rëndësinë e Diellit për dukuritë gjeografike, si: qarkullimi i përhershëm i ujit dhe i ajrit, zhvillimi i botës bimore e shtazore, baticat e zbatimit.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1; II.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I.6; 2.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Rëndësia e Diellit në zhvillimin e botës bimore dhe shtazore

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përshkruan rëndësinë e Diellit në zhvillimin e bimëve dhe kafshëve;
- Diskuton për proceset që ndodhin me praninë e Diellit te bimët dhe kafshët;
- Shpjegon çfarë marrin njerëzit dhe kafshët drejtpërdrejt nga Dielli.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, fletore, ngjyra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënësit**

*Përvijim i të menduarit*

Pyeten nxënësit:

- Çfarë u jep Dielli bimëve dhe kafshëve?
- A ka rëndësi Dielli në rritjen dhe zhvillimin e bimëve dhe kafshëve?
- Cilat janë kushtet themelore për jetesën e bimëve dhe kafshëve?
- Çfarë e mundëson rritjen e tyre?

Idetë e nxënësve shkruhen në tabelë dhe komentohen së bashku.

39 Rëndësia e Diellit për zhvillimin e botës bimore dhe shtazore


Edhe për bimët dhe kafshët energjia e Diellit është e domosdoshme (pa të s'ka jetë), sepse Dielli është burim i dritës dhe i nxehtësisë dhe, kështu, mundëson ekzistencën e jetës në Tokë.



*Drita dhe nxehtësia e Diellit mundësojnë jetën në Tokë.*

Roli i Diellit në jetën e bimëve

Bimët pa energjinë e Diellit (dritë dhe nxehtësi) nuk mund të jetojnë. Ato, përmes energjisë së Diellit, në gjethe, nga dyoksidi i karbonit, uji dhe materiet minerale, prodhojnë ushqim (sheqer) dhe oksigjen. Pra, bimët me ndihmën e energjisë së Diellit prodhojnë ushqim për vete, për shtazët dhe organizmat e tjerë në tokë, si dhe prodhojnë oksigjen, i cili është i domosdoshëm për jetë normale të të gjithë organizmave. Shih figurën.




*Bimët prodhojnë ushqim (sheqer) dhe oksigjen.*



### Roli i Diellit në jetën e kafshëve

Kafshët kanë nevojë për ushqimin dhe oksigjenin që prodhojnë bimët. Të gjithë organizmat e gjallë në Tokë drejtpërdrejt ose jo varen nga njëri-tjetri për ushqim. Kafshët përfitojnë tërthorazi nga energjia e Diellit, kështu energjia e Diellit në bimë shndërrohet në ushqim, i cili nga bimët kalon (përmes ushqimit) te kafshët dhe njerëzit. Kafshët dhe njerëzit gjithashtu përfitojnë edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Dielli, sepse ata ngrohën nga nxehtësia e tij dhe marrin vitaminën D.



Zinxhiri ushqimor - prodhues i parë i ushqimit është bima.

1. Sqaro rëndësinë e Diellit për ekzistencën e jetës në Tokë.
2. Pse rrezet e Diellit janë të rëndësishme për bimët?
3. Cila është rëndësia e bimëve për jetën e kafshëve dhe të njerëzve?



87



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes INSERT

Tekstin e lexojnë në heshtje dhe për çdo informacion do të vendosen shenjat përkatëse në libër. Më pas, materiali i shkurtuar do të hidhet tek tabela nga çdo nxënës. √ - këtë e dija, + këtë nuk e dija, - - këtë e dija ndryshe, ? - këtë nuk e kuptoj.

Kontrollon përvetësimin e njohurive të nxënësve, duke pyetur rreth këtyre pikave:

1. Rëndësia e Diellit në ekzistencën e jetës në Tokë;
2. Rëndësia e Diellit te bimët;
3. Rëndësia e bimëve për jetën e njerëzve dhe kafshëve.



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënësve Shkrim i lirë

Nxënësit udhëzohen të shkruajnë dy fjali. Në fjalinë e parë shkruhet se çfarë ndikimi ka Dielli te kafshët dhe te fjalja e dytë se çfarë ndikimi ka

Dielli në zhvillimin dhe rritjen e bimëve.  
Lexohen punimet e disa nxënësve.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë që tregojnë për rëndësinë e Diellit te bimët dhe kafshët, si ndikon Dielli në rritjen dhe zhvillimin e tyre dhe çfarë marrin drejtpërdrejt nga Dielli kafshët dhe njerëzit.

### Detyrë:

Vizatojnë lidhjen në mes të Diellit, bimëve dhe kafshëve.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Vendi dhe hapësira

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Shpjegon rëndësinë e Diellit për dukuritë gjeografike, si: qarkullimi i përhershëm i ujit dhe i ajrit, zhvillimi i botës bimore e shtazore, baticat e zbatat.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1; II.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I.6; 2.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Rëndësia e rrezeve të Diellit në zhvillimin e botës bimore dhe shtazore - Fletore pune

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Tregon rëndësinë e rrezeve të Diellit;
- Përshkruan si e merr bima ushqimin;
- Tregon çfarë marrin drejtpërdrejt njerëzit dhe kafshët nga Dielli.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, fletore, ngjyra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhë amtare, Shkathhtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë:**

*Shkrim i shpejtë*

Shkruhet në tabelë *Dritë dielli*. Nxënësit japin mendimet e tyre rreth saj. Nxënësit bëjnë një shkrim të shkurtër me këtë fjalë. Ata duhet të shkruajnë sa më shumë mendime rreth kësaj teme. Lexohen disa nga punimet e nxënësve.

RËNDËSIA E RREZEVE TË DIELLIT NË ZHVILLIMIN E BOTËS BIMORE DHE TË ASAJ SHTAZORE

1. Plotëso fjalitë.


a) Rrezet e diellit japin dritë dhe nxehtësi; kjo bën të mundur \_\_\_\_\_

b) Bimët, përmes gjetheve, marrin dyoksidin e karbonit nga ajri dhe energjinë nga rrezet e diellit. Këto dhe uji që e marrin përmes rrënjëve u mundësojnë të prodhojnë \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_.

c) Energjia nga Dielli transferohet te bimët, nga bimët te \_\_\_\_\_ dhe te \_\_\_\_\_. Kështu krijohet një zinxhir ushqimor.

d) Kafshët dhe njerëzit përfitojnë nga efekti i Diellit në trupat e tyre, sepse rrezet e tij në lëkurë prodhojnë \_\_\_\_\_


2. Plotëso vendet boshe në figurë, duke zgjedhur fjalët: *energji diellore, dyoksid karboni, sheqeri, oksigjeni, uji, mineralet.*



1. Plotëso fjalitë.

- a) Rrezet e diellit japin dritë dhe nxehtësi; kjo bën të mundur \_\_\_\_\_
- b) Bimët, përmes gjetheve, marrin dyoksidin e karbonit nga ajri dhe energjinë nga rrezet e diellit. Këto dhe uji që e marrin përmes rrënjëve u mundësojnë të prodhojnë \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_.
- c) Energjia nga Dielli transferohet te bimët, nga bimët te \_\_\_\_\_ dhe te \_\_\_\_\_. Kështu krijohet një zinxhir ushqimor.
- d) Kafshët dhe njerëzit përfitojnë nga efekti i Diellit në trupat e tyre, sepse rrezet e tij në lëkurë prodhojnë \_\_\_\_\_

2. Plotëso vendet boshe në figurë, duke zgjedhur fjalët: *energji diellor, dyoksid karboni, sheqeri, oksigjeni, uji, mineralet.*



55

në fund bën edhe ai komentin e tij. Kështu vazhdojnë të gjitha grupet.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen për saktësinë në tregimin e rëndësisë së Diellit te bimët dhe kafshët, ndikimin e Diellit në rritjen dhe zhvillimin e tyre, si dhe çfarë marrin kafshët drejtpërdrejt nga Dielli.

**Detyrë:**

Vizatojnë dhe shkruajnë si e merr bima ujin.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---




---



**Ndërtimi i njohurive:  
Përpunimi i përmbajtjes**

*Mbajtja e strukturuar e shënimeve*

Së bashku me nxënësit, kujtojnë njësinë e kaluar mësimore. Udhëzohen nxënësit të punojnë në grupe, në fletore pune. Jepet në tabelë skema e strukturuar e mësimin.



Duke marrë mendimet e nxënësve, plotësohet se sa janë të rëndësishme rrezet e diellit për bimët dhe kafshët.



**Përforcimi:  
Konsolidimi i të nxënësve**

*Ruaje fjalën e fundit për mua*

Një nxënës brenda grupit zgjedh një pjesë që e ka pëlqyer më shumë dhe u kërkon nxënësve ta komentojnë atë pjesë. Pasi dëgjon mendimet e tyre,

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Sistemet fizike

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Shpjegon përbërjen, ndërtimin e atmosferës dhe rëndësinë e saj për proceset në natyrë dhe jetën në Tokë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I.6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njëësia mësimore:** Ndërtimi i atmosferës dhe rëndësia e saj për jetë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Shpjegon ndërtimin e atmosferës;
- Dallon shtresat e ajrit;
- Tregon për rëndësinë e atmosferës në përhapjen e zërit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, fletore, fotografi, ngjyra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënët**

*Imagjinata e drejtuar*

Duke parë foton e tekstit të zmadhuar dhe duke u njohur me titullin e pjesës, nxënësit pyeten:

- Çfarë po shohim në fotografi?
  - Çfarë mendoni se do të mësojmë sot për ajrin?
  - Duke u bazuar në fotografi, prej sa shtresave përbëhet ajri?
- Nxënësit shkruajnë në fletore. Lexohen disa nga punimet e tyre.

40 SISTEDET FIZIKE  
Ndërtimi i atmosferës dhe rëndësia e saj për jetën

Atmosfera është shtresa e gaztë (ajri) që rrethon Tokën. Atë e ndërtojnë pesë shtresa të ndryshme, siç tregohet në figurë.



Ndërtimi i atmosferës

Atmosfera është një element shumë i rëndësishëm i planetit tonë, sepse përbërja e saj kimike mundëson jetën e organizmave të gjallë në planet, d.m.th. ka sasi të mjaftueshme të dyoksidit të karbonit, që bimët të krijojnë ushqim dhe sasi të mjaftueshme të oksigjenit që organizmat të kryejnë procesin e frymëmarrjes. Në shtresat e sipërme të atmosferës gjendet një shtresë e një gazi tjetër që quhet **ozoni**. **Ozoni**, po ashtu, është shumë i rëndësishëm sepse mbrohet organizmat e gjallë, meqë pengon depërtimin e rrezeve ultravijollcë, të cilat janë vdekjeprurëse për bimët dhe kafshët. Atmosfera pranon dhe liron nxehtësinë që vjen nga Dielli. Ajri nxehtë në formë jo të barabartë, gjë që shkakton lëvizjen e ajrit (rymave të lëvizjes së ajrit) e me këtë mundëson edhe qarkullimin e ujit në natyrë dhe krijimin e motit, për të cilin kemi folur më herët. Gazet në ajër na lejojnë të dëgjojmë shumicën e tingujve në botën tonë. Pa atmosferën, bota do të ishte një vend i heshtur.



1. Çfarë është atmosfera dhe si është e ndërtuar?
2. Pse pa atmosferën nuk mund të ekzistojë jeta në Tokë?
3. Shpjego rëndësinë e atmosferës në dëgjimin e zërit.

## 40 SISTEMET FIZIKE

### Ndërtimi i atmosferës dhe rëndësia e saj për jetën

Atmosfera është shtresa e gaztë (ajri) që rrethon Tokën. Atë e ndërtojnë pesë shtresa të ndryshme, siç tregohet në figurë.



Atmosfera është një element shumë i rëndësishëm i planetit tonë, sepse përbërja e saj kimike mundëson jetën e organizmave të gjallë në planet, d.m.th. ka sasi të mjaftueshme të dyoksidit të karbonit, që bëmë të krijojnë ushqim dhe sasi të mjaftueshme të oksigjenit që organizmat të kryejnë procesin e frymëmarrjes. Në shtresat e sipërme të atmosferës gjendet një shtresë e një gazi tjetër që quhet **ozoni**. **Ozoni**, po ashtu, është shumë i rëndësishëm sepse mbron organizmat e gjallë, meqë pengon depërtimin e rrezeve ultravjollcë, të cilat janë vdekjeprurëse për bimët dhe kafshët. Atmosfera pranon dhe liron nxehtësinë që vjen nga Dielli. Ajri nxehtë në formë jo të barabartë, gjë që shkakton lëvizjen e ajrit (rrymave të lëvizjes së ajrit) e me këtë mundëson edhe qarkullimin e ujit në natyrë dhe krijimin e motit, për të cilin kemi folur më herët. Gazet në ajër na lejojnë të dëgjojmë shumicën e tingujve në botën tonë. Pa atmosferën, bota do të ishte një vend i heshtur.

?

1. Çfarë është atmosfera dhe si është e ndërtuar?
2. Pse pa atmosferën nuk mund të ekzistojë jeta në Tokë?
3. Shpjego rëndësinë e atmosferës në dëgjimin e zërit.

88



### Ndërtimi i njohurive:

#### Përpunimi i përmbajtjes

*Mbajtja e strukturuar e shënimeve*

Lexohet mësimi dhe nxënësit do ta dëgjojnë dhe do të mundohen ta kuptojmë mësimin. Gjatë leximit, nxënësit duhet të mbajnë shënime. Do të shënojnë me vijë poshtë fjalët që nuk i kuptojnë. Pasi mbarohet leximi, shpjegohet kuptimi i tyre.

Së bashku me nxënësit, tregojmë si është ndërtuar atmosfera.



### Përforcimi:

#### Konsolidimi i të nxënët

*Rishikim në dyshe*

Nxënësit do t'u përgjigjen pyetjeve në libër.

Udhëzohen për punën që do të bëjnë. Në fillim, do të punojnë vetë e pastaj do t'ia japin shokut për korrigjim. Nxënësit mbarojnë punën dhe disa prej tyre lexojnë përgjigjet e pyetjeve me zë.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë gjatë shpjegimit të ndërtimit të atmosferës, dallimin e shtresave të ajrit, në tregimin e rëndësisë së ajrit dhe përhapjen e zërit.

### Detyrë:

Vizatojnë dhe përshkruajnë me fjalë ndërtimin e atmosferës.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës  
**Lënda:** Njeriu dhe natyra  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV  
**Tema:** Sistemet fizike

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Përshkruan strukturën (ndërtimin e brendshëm) e Tokës: dallon bërthamën, mantelin dhe koren e Tokës, si dhe tregon se korja e Tokës përbëhet nga shkëmbinjtë ndryshëm.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** II.8; II.6.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ndërtimi i brendshëm i Tokës

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan ndërtimin e kores së Tokës;
  - Përcakton shtresat e Tokës;
  - Shpjegon ndërtimin e mantelit dhe bërthamës së Tokës.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, fletore, burime nga interneti, fruta, projektor.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**  
*Stuhi mendimesh*

Në klasë marrim një frutë kumbulle ose një frutë pjeshke. Ndajmë frutën në gjysmë, së bashku me nxënësit i numërojmë shtresat prej të cilave përbëhet fruta:

1. Një mbështjellës lëkure shumë i hollë;
2. Pjesa tuloze që përbën shtresën më të madhe të masës së frutës;
3. Një farë me madhësi të konsiderueshme, të vendosur në qendër.

Pastaj, nxënësve u tregojmë se edhe Toka përbëhet prej disa pjesëve.

41 Ndërtimi i brendshëm i Tokës

Një krahasim i mirë për të kuptuar brendësinë e Tokës është një frutë siç është pjeshka ose kumbulla. Ju i njihni këto fruta dhe i keni parë ato të ndara në gjysmë. Raporti në trashësinë e pjesëve është shumë i ngjashëm mes këtyre frutave dhe Tokës.




Fruta e pjeshkës Fruta e kumbullës

Nëse presim një frutë në gjysmë, do të shohim se ajo përbëhet nga tri pjesë (shtresa):

1. Një mbështjellës lëkure shumë i hollë;
2. Pjesa tuloze që përbën shtresën më të madhe të masës së frutës;
3. Një farë me madhësi të konsiderueshme, të vendosur në qendër.

Duke prezantuar Tokën të prerë, do të shohim:

1. Një kore shumë të hollë nga jashtë;
2. Pjesën e mantelit që përbën pjesën më të madhe të masës së Tokës dhe
3. Një bërthamë me madhësi të konsiderueshme në qendër.




Ndërtimi i Tokës



### Korja e Tokës

Ekzistojnë dy lloje të ndryshme të kores: korja e hollë oqeanike, mbi të cilën gjenden oqeanet dhe korja e trashë kontinentale që qëndron në pjesën e sipërme të kontinenteve. Këto dy lloje të ndryshme të kores përbëhen nga lloje të ndryshme të shkëmbinjve. Korja e hollë oqeanike përbëhet kryesisht nga shkëmbinjtë e bazaltit, ndërsa korja kontinentale më e trashë është e përbërë kryesisht nga shkëmbinjtë e granitit. Përbërja është e rëndësishme, kështu korja kontinentale është më pak e dendur se korja oqeanike.



Korja oqeanike dhe kontinentale

### Manteli i Tokës

Gjendet nën koren e Tokës dhe sipër bërthamës së saj. Për nga trashësia, është shumë më i trashë se korja e Tokës. Ndërtohet kryesisht nga shkëmbinj të pasur me magnez, hekur dhe shkëmbinj silikatë. Menjëherë nën koren e Tokës, temperatura e mantelit është më e ulët, por shkon duke u rritur më në thellësi. Shkëmbinjtë në shtresën e sipërme të mantelit janë të freskët dhe të brishtë, ndërsa ata në shtresën e poshtme të mantelit janë të nxehtë dhe të butë (por jo të shkrirë - gjysmë të lëngshëm).

### Bërthama e Tokës

Gjendet në qendër të Tokës dhe përbëhet kryesisht nga përzjerja e hekurit dhe e nikelit. Bërthama është jashtëzakonisht e nxehtë (nga 3500 °C deri në 6000 °C). Bërthama është e ndarë në dy shtresa të tjera: **shtresa e jashtme e bërthamës**, e cila është e lëngët sepse ka temperaturë të lartë dhe materialet që e ndërtojnë (hekur-nikel) janë të shkrirë (të lëngshme), si dhe **shtresa e brendshme e bërthamës**, po ashtu e ndërtuar nga hekurit dhe nikeli, e cila është e fortë, edhe pse temperatura e saj është më e lartë se ajo në shtresën e jashtme. Meqë gjendet në pjesën më të thellë të Tokës, ajo është nën shtypje të lartë, e cila nuk e lejon të shkrirët, edhe pse temperaturat janë më të larta se në shtresën e jashtme të bërthamës.



1. Cilat janë pjesët e Tokës?
2. Sqaro ndërtimin e kores oqeanike dhe kontinentale të Tokës.
3. Përkrahuj ndërtimin e mantelit të Tokës.
4. Në sa zona ndahet bërthama e Tokës? Krahasoji ato.

90



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes DRTA

Nxënësit udhëzohen t'i hapin librat dhe ta lexojnë njësinë e re mësimore me ndalesa. Pas leximit, nxitet diskutim, duke parashtruar pyetje për ndalesën e parë:

- Sa kore të Tokës janë?
- Prej cilëve shkëmbinj janë të përbëra koret e Tokës?

Lexojmë pjesën e dytë dhe shtrohen pyetje:

- Ku gjendet manteli i Tokës?
- Çfarë temperaturash kanë shkëmbinjtë e mantelit?

Lexojmë pjesën e tretë dhe shtrohen pyetje:

- Ku gjendet bërthama e Tokës?
- Çfarë përbërje ka bërthama e Tokës?
- Prej sa shtresave është e përbërë bërthama e Tokës?



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit Shkrim i shpejtë

Me anë të projektorit shfaqet një video, e cila gjendet në vegëzën:

<https://www.youtube.com/watch?v=WjXSCumeqxo>

Bashkërisht me nxënësit, diskutohen pamjet në video. Nxënësit udhëzohen të përshkruajnë ndërtimin e Tokës. Vizatojnë dhe emërtojnë shtresat e Tokës.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë në përshkrimin e kores së Tokës, për përcaktimin e shtresave të Tokës, për shpjegimin e mantelit dhe bërthamës.

### Detyrë:

U përgjigjen pyetjeve 1-4, në faqen 90.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

**ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Sistemet fizike

**Rezultatet e të nxënësve të temës:**

Përshkruan strukturën (ndërtimin e brendshëm) e Tokës: dallon bërthamën, mantelin dhe koren e Tokës, si dhe tregon se korja e Tokës përbëhet nga shkëmbinj të ndryshëm.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** II.8; II.6.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.6.

**ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Njësia mësimore:** Ndërtimi i brendshëm i Tokës  
- Fletore pune

**Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:**

- Flet për ndërtimin e brendshëm të Tokës;
- Përcakton shtresat e kores së Tokës;
- Dallon shtresat e Tokës.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, ngjyra, fletë me ngjyra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**  
Gjuhë shqipe, Shkathësi për jetë, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

**METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS**

**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënësit**

*Stuhi mendimesh*


Shkruhet në tabelë fjalia e urtë “Kush kujdeset për tokën, toka e ushqen atë”. Nxënësit japin mendime rreth fjalisë së urtë.

Disa prej mendimeve shënohen në tabelë.

**NDËRTIMI I BRENDSHËM I TOKËS****40**

1. Pse kur flasim për ndërtimin e brendshëm të Tokës e krahasojmë atë me një frutë, siç është pjeshka ose kumbulla?

2. Shkruaj shtresat e Tokës në figurë.



57

## NDËRTIMI I BRENDSHËM I TOKËS


40

1. Pse kur flasim për ndërtimin e brendshëm të Tokës e krahasojmë atë me një frutë, siç është pjeshka ose kumbulla?

---

---

2. Shkruaj shtresat e Tokës në figurë.



57



**Ndërtimi i njohurive:**  
**Përpunimi i përmbajtjes**  
*Lapsat në mes*

Hapet teksti. Analizohen figurat. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve në libër. Pas përfundimit, nxënësit lexojnë pyetjet dhe vendosin lapsin në mes. Nuk mund të flasë i njëjti pa mbaruar të gjithë.

Pas përfundimit, në çdo grup merret një laps në dorë, kërkohet të lexojë i zoti i lapsit përgjigjen.



**Përforcimi:**  
**Konsolidimi i të nxënit**  
*Stuhi mendimesh në dyshe*

Në tabelë shënohet fjalia: *Ndërtimi i brendshëm i Tokës*. Punohet në dyshe, duke plotësuar rrethin me informacionet që dinë rreth pyetjes së shtruar, në fletore. Pas përfundimit, dyshet lexojnë informacionet e paraqitura, të cilat mund të shënohen edhe në tabelë.



### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë që tregojnë si ndërtohet Toka, për përcaktimin e shtresave të Tokës, për dallimin e shtresave të Tokës.

### Detyrë:

Vizatojnë dhe modelojnë me fletë me ngjyra ndërtimin e Tokës.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---

---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Sistemet fizike

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Përshkruan qarkullimin e ujit në natyrë (paraqesin në mënyrë skematike qarkullimin e ujit në natyrë) dhe tregon që pjesa më e madhe e sipërfaqes së Tokës është e mbuluar me ujë (oqeanet, detet, lumenjtë), pjesa më e vogël është tokë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** III.3; III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.6

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Sa ka ujë në planetin Tokë?

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përshkruan planetin Tokë;
- Përshkruan ciklin e ujit në natyrë;
- Dallon sa sipërfaqe të ujit ka në Tokë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, fletore, ngjyra, burime nga interneti.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**


*Organizues grafik*

Shkruhet fjala *uji*. Secilit grup i shpërndahet nga një fletë A4, në të cilën janë të parashtruara pyetjet:

- Pse Toka njihet ndryshe si “planeti i kaltër”?
- Ku gjendet uji?
- Pse është i rëndësishëm uji për jetën në Tokë?
- A e dini sa për qind ka ujë në Tokë?

Bazuar në këto pyetje, nxënësit shkruajnë për ujin.

42 Sa ka ujë në planetin Tokë?



Përqindja e sipërfaqes ujore dhe tokësore në planetin Tokë

Rreth 70% e sipërfaqes së planetit Tokë është e mbuluar me ujë, ndërsa rreth 30% është pjesë tokësore.

Pjesa më e madhe e ujit në sipërfaqen e planetit Tokë, rreth 97,5%, është ujë i kripur në oqeanet. Uji i ëmbël, që vjen nga burimet dhe qarkullon në përrunj, lumenj, liqene dhe ujëra nëntokësore, është ai që u nevojitet njerëzve çdo ditë për të jetuar.



Planeti Tokë

Ne e dimë që uji i pranishëm në oqeanë, dete, liqene, lumenj, bimë etj. avullon pothuajse çdo ditë dhe bëhet pjesë përbërëse në ajër. Avulli bën pjesë në përqindje të vogël në suaza të atmosferës (2-3 %). Për qarkullimin e ujit kenë mësuar në njësinë mësimore “Ndikimi i Diellit në dukuritë natyrore të planetit Tokë”.



Avullimi i ujit nga oqeanet

Bisedoni me mësuesen dhe shokët/shoqet e klasës arsyen e tharjes së rrobave në ajër. Sqaroni pse kur varen për tharje duhet të jenë shpërndara.

?

1. Sa përqind të sipërfaqes së planetit tonë mbulohet nga uji?
2. Cili ujë gjendet në përqindjen më të madhe në planet?
3. Nga vjen uji i ëmbël?
4. Në çfarë përqindje gjendet avulli në suaza të atmosferës?

92



**Ndërtimi i njohurive:**  
**Përpunimi i përmbajtjes**  
*INSERT*

Udhëzon nxënësit t'i hapin librat. Leximi i njësisë do të bëhet në mënyrë individuale. Gjatë leximit, secili nxënës duhet të shënojë me “√”  
- informacionet që i ka ditur më parë, me “+”  
- informacionet e reja që tashmë i ka marrë dhe “?” - gjërat që i ka të paqarta.

Pas leximit, disa nga nxënësit lexojnë informacionet që i kanë ditur, disa të tjerë informacionet që i kanë marrë dhe informacionet që nuk i dinë. Shënohen në tabelë dhe analizohen së bashku.



**Përforcimi:**  
**Konsolidimi i të nxënit**  
*Stuhi mendimesh në dyshe*

Përmes TV-së, paraqitet procesi i formimit të shiut në natyrë. Videoja gjendet në vegëzën: <https://www.youtube.com/watch?v=V-cDJ-frmQ2c>

Pas përfundimit, diskutohet videoja.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë në përshkrimin e planetit Tokë, tregimin për ciklin e formimit të ujit në natyrë, dallimin se sa ka ujë dhe sa për qind ka tokë në planetin Tokë.

### Detyrë:

U përgjigjen pyetjeve në fq. 92.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---

---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Sistemet fizike

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Përshkruan qarkullimin e ujit në natyrë (paraqesin në mënyrë skematike qarkullimin e ujit në natyrë) dhe tregon që pjesa më e madhe e sipërfaqes së Tokës është e mbuluar me ujë (oqeanet, detet, lumenjtë), pjesa më e vogël është tokë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** III.; III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Sa ka ujë në planetin Tokë? - Fletore pune

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Tregon se sa ka ujë në sipërfaqe të Tokës;
- Përshkruan shndërrimin e ujit në avull dhe anasjellas;
- Shpjegon rëndësinë e ujit për qeniet e gjalla.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, fletore, vëlues uji, enë me kapak.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë shqipe, Shkathësi për jetë, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

*Parashikim me terma paraprakë*


Në tabelë shkruhen 4 fjalët: *ujë, tokë, jetë, ruajmë.*

Kërkohet nga nxënësit të krijohet një përmbajtje e shkurtër me këto fjali. Kjo bëhet në mënyrë individuale nga secili nxënës, pastaj diskutohet në dyshe dhe në fund kërkohet të zhvillohet diskutim në grup.

41 SA KA UJË NË PLANETIN TOKË?

1. A e dini sa ka ujë në sipërfaqe të planetit Tokë?

a) Plotëso vendet boshe në figurë për përqindjen e sipërfaqes ujore dhe të asaj tokësore në planetin Tokë.



2. Nga cilat burime krijohet avulli dhe bëhet pjesë përbërëse e ajrit?

---



---

3. Sa është përqindja e avullit në atmosferë?

---



---




**Eksperiment:** avullimi i ujit.

Mjetet dhe materiali i duhur: një pjatë e cekët, ujë dhe flamaster.



**Ecuria e eksperimentit:** në pjatë, vendos një sasi uji dhe, aty ku është niveli i ujit në enë, shenjoje me flamaster. Pjatën vendose në një vend të ngrohtë dhe lëre të qëndrojë për tri ditë. Shenjoje çdo ditë nivelin e ujit dhe vizatoje poshtë pjatën, me vijat shenjuese që i ke bërë në të. Prezantoje eksperimentin në klasë dhe komentoje me shokët e shoqet e klasës.



59



**Ndërtimi i njohurive:**

**Përpunimi i përmbajtjes**

*Të nxënësit në bashkëpunim*

Nxënësit ndahen duke krijuar grupet e ekspertëve A, B dhe C. Grupin A e përbëjnë nxënësit me numri 1, grupin B ata me numrin 2 dhe grupin C me numrin 3.

Secili nxënës i përgjigjet pyetjes në fletore pune. Më pas, ekspertët shkëmbejnë mendimet për përgjigjet që i kanë dhënë.

Nxënësit kthehen në grupe. Lexohen përgjigjet e pyetjeve. Nxënësit bëjnë pyetje për t'u sqaruar më mirë përmbajtja e mësimin.



**Përforcimi:**

**Konsolidimi i të nxënësit**

*Demonstrim përmes eksperimentit*

Para nxënësve demonstron shndërrimi i avullit në pika uji.

- Marrim një vëlues uji.
- Uji nxehet derisa të vlon.
- Pas vlimit, e vendosim në një enë me kapak.
- Pas disa minutash, e heqim kapakun.
- Shikohet se si uji pikon nga kapaku, që do të thotë se avulli shndërrohet në pika uji.

Kërkohet nga nxënësit të shkruajnë në fletore hapat e procesit të avullimit.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë që tregojnë se sa ka ujë në sipërfaqen e Tokës, përshkrimin e shndërrimit të ujit në avull, si dhe shpjegimin e rëndësisë së ujit për qeniet e gjalla.

### Detyrë:

Të plotësojnë në fletore pune, faqe 60, kurse eksperimenti të bëhet në shtëpi.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---

---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Sistemet fizike

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Identifikon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e botës bimore dhe shtazore.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.6; III.1.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1; 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Faktorët që ndikojnë në përhapjen e botës bimore dhe shtazore

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përshkruan faktorët që ndikojnë në përhapjen e botës bimore e shtazore;
- Dallon zonat e ndryshme natyrore;
- Identifikon temperaturat në bazë të zonave.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, fletore, fotografi, burime interneti.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë:**

*Imagjinata e drejtuar*

Në tabelë shkruhen 4 fjalët: *ujë, tokë, jetë, ruajmë.*

Përmes projektorit, prezantohen disa fotografi të zonave natyrore.


Nxënësit, duke i shikuar fotografitë, tregojnë se cilës zonë i përkasin. Së bashku me nxënësit, komento-  
hen zonat natyrore. Pastaj shtrohen pyetje:

1. Cilat bimë dhe kafshë rriten në ato zona?
2. Çfarë temperatura mbizotërojnë në zonat e caktuara?
3. Në cilat zona rriten më shumë bimët, e në cilat zona rriten më shumë kafshët?
4. Cilët faktorë ndikojnë në rritjen e tyre?

43 Faktorët që ndikojnë në përhapjen e botës bimore dhe shtazore

Organizmat bimorë dhe shtazorë nuk janë të shpërndarë në formë të njëtrajtshme në Tokë, por në varësi të faktorëve të mjedisit të jashtëm në disa vende ata janë më të pranishëm, ndërsa në të tjerat më pak. Ekzistojnë faktorë të ndryshëm që ndikojnë në përhapjen e botës bimore e shtazore në Tokë. Më të rëndësishmit janë faktorët klimatikë, si: drita, temperatura, lagështia, pastaj nga përbërja e tokës: relievi etj.


Faktorët e mjedisit të jashtëm, si p.sh. drita, temperatura dhe reshjet e shiut ndryshojnë në planetin tonë si në aspektin horizontal (nga ekuatori në drejtim të poleve) ashtu edhe në atë vertikal (nga bregdeti në drejtim të maleve të larta). Ndryshimi i këtyre faktorëve ndikon dhe në përhapjen e botës bimore dhe shtazore. Për shembull, nëse do të fillonit një udhëtim në ekuator dhe të ecnit deri në veri, do të vërenit ndryshime graduale në botën bimore e shtazore. Në fillim të udhëtimit tuaj nga ekuatori, ju do të shihnit pyjet tropikale të shiut me drurë të mëdhenj që kanë gjethe të gjera dhe përherë të gjelbra. Po ashtu, do të shihnit lloje shtazore karakteristike. Këto lloje janë rezultat i temperaturës dhe reshjeve të vazhdueshme e të larta të shiut.



Zona me pyje tropikale të shiut

Edhe më në veri, pyjet gjetherënëse zëvendësohen me pyjet përherë të gjelbra. Bimët e këtyre pyjeve nuk i hedhin gjethet gjatë dimrit. Gjethet e tyre janë në formë gjilpëre (hale), prandaj quhen pyje halore. Temperatura në këto zona është më e ulët, por edhe reshjet janë më të pakta.

Zona me pyje halore



Më tutje, ju do të arrinit në tundrën arktike, e cila gjendet në pjesën më veriore, ku temperatura dhe reshjet janë të ulëta. Do të hasnit një numër të vogël të bimëve dhe shtazëve, të cilat u janë përshtatur këtyre kushteve të mjedisit.

Zona e tundrës

Krejt në fund do të arrinit në Polin e Veriut, ku temperaturat janë shumë të ulëta dhe uji gjendet në formë të akullit. Këtu numri i organizmave të gjallë është jashtëzakonisht i ulët për shkak të kushteve ekstreme të mjedisit. Meqë ka pak organizma të gjallë, ndryshe quhen edhe *shkretëtira të ftohta*.

Zona akullnajore



Ky "udhëtim" në veri ju mundëson të vëreni ndryshimet graduale të klimës dhe të botës së gjallë, e cila është përshtatur me faktorët mjedisorë në zonat e caktuara gjeografike. Një ndryshim të tillë do ta vëreni nëse ngjiteni nga baza e një mali në drejtim të majës së tij. Psh., nëse ngjiteni në një mal që është i lokalizuar në zonën tropikale, në pjesën

95



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes Copëza të përziera

Paraqitjet njësisë mësimore para nxënësve. Nxënësit punojnë në mënyrë grupore. Përgatiten copëza letre, ku në disa është vendosur fotografia e zonës, kurse të tjetrat është paraqitur me shkrim zona.

Nxënësit do t'i shohin fotografitë dhe do t'i bashkëngjeshin përshkrimin se cila zonë është.

Pasi të përfundohet, nxënësit hapin librat. Lexohet teksti në libër. Analizohen se si i kanë bashkëngjitur copëzat dhe a i kanë vendosur saktë.



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit Stuhi mendimesh

Me anë të projektorit, shfaqet një video për pyjet tropikale. Videoja gjendet në vegëzën:

<https://www.youtube.com/watch?v=AcqBuNxcOCo>

Po ashtu, shfaqet një pjesë nga Poli i Veriut.

Videoja gjendet në vegëzën:

<youtube.com/watch?v=s59HdEjD8eY>

Diskutohen bashkë me nxënësit, duke bërë dallimin e atyre që i shikuan më parë.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë në përshkrimin e faktorëve që ndikojnë në përhapjen e botës bimore dhe shtazore, në dallimin e zonave, si dhe në identifikimin e temperaturave në bazë të zonave.

### Detyrë:

Vizatojnë zonën që dëshirojnë ta vizatojnë.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---

---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Sistemet fizike

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Identifikon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e botës bimore dhe shtazore.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.6; III.1.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Faktorët që ndikojnë në përhapjen e botës bimore dhe shtazore - Fletore pune

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përshkruan faktorët që ndikojnë në përhapjen e botës bimore e shtazore;
- Dallon zonat e ndryshme natyrore;
- Identifikon temperaturat në bazë të zonave.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, fletë A4, kub.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë shqipe, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënët**

*Organizuesi veprues (minileksion)*

Përmes një shpjegimi të shkurtër, bëjnë një paraqitje të përgjithshme të temës. Së bashku me nxënësit, komentojmë njësinë e kaluar mësimore.

42

FAKTORËT QË NDIKOJNË NË PËRHAPJEN E BOTËS BIMORE DHE TË ASAJ SHTAZORE

1. A dini cilët janë faktorët që ndikojnë në përhapjen e botës bimore dhe të asaj shtazore në planetin Tokë?

Plotëso fjalitë:

a) Faktorët që ndikojnë në përhapjen e botës bimore e të asaj shtazore në Tokë janë faktorët \_\_\_\_\_ si \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_ dhe faktorët \_\_\_\_\_.

b) Faktorët si temperatura dhe reshjet e shiut ndryshojnë në planetin tonë si në aspektin \_\_\_\_\_, ashtu dhe në atë \_\_\_\_\_.

c) Pse asnjë lloj bimor ose shtazor nuk mund të jetojë kudo në planet?

---



---


d) Pse në Australi rreth 3/4 e botës bimore rriten vetëm aty e askund tjetër në botë?

---



---

2. Shkruaj nën çdo figurë emrin e zonës me përhapje të botës bimore e shtazore përkatëse.




---



---

1. A dini cilët janë faktorët që ndikojnë në përhapjen e botës bimore dhe të asaj shtazore në planetin Tokë?

Plotëso fjalitë:

a) Faktorët që ndikojnë në përhapjen e botës bimore e të asaj shtazore në Tokë janë faktorët \_\_\_\_\_ si \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_ dhe faktorët \_\_\_\_\_.

b) Faktorët si temperatura dhe reshjet e shiut ndryshojnë në planetin tonë si në aspektin \_\_\_\_\_, ashtu dhe në atë \_\_\_\_\_.

c) Pse asnjë lloj bimor ose shtazor nuk mund të jetojë kudo në planet?

\_\_\_\_\_


\_\_\_\_\_

d) Pse në Australi rreth 3/4 e botës bimore rriten vetëm aty e askund tjetër në botë?

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

2. Shkruaj nën çdo figurë emrin e zonës me përhapje të botës bimore e shtazore përkatëse.



\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes Kubimi

Nxënësit janë të ndarë në grupe (4-6) nxënës. Secilit grup i japim nga një kub të punuar me letër. Në secilën faqe të kubit janë të shënuar numrat prej 1 deri në 6. Për secilin numër të kubit janë përgatitur pyetjet si në vijim:

1. Cilët janë faktorët që ndikojnë në përhapjen bimëve dhe shtazëve?

2. A ndryshojnë temperaturat në planetin Tokë?

3. Pse asnjë lloj bimor dhe shtazor nuk mund të jetojnë kudo në planet?

4. Pse në Australi rritet 3/4 e botës bimore dhe rriten vetëm aty dhe askund tjetër në botë?

5. Në cilat vende në botë janë tempertaurat më të larta?

6. Në cilat vende në botë janë tempertaurat më të ulëta?

Pyetjet i shkruajnë në faqet e caktuara të kubit.



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit Shkrim i shpejtë

Nxënësit udhëzohen që në fletore pune t'i shkruajnë përgjigjet e pyetjeve në libër. Lexohen me zë të lartë nga disa nxënës.

#### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë në dallimin e zonave të ndryshme, në identifikimin e temperaturave, si dhe në përshkrimin e zonave të ndryshme.

#### Detyrë:

Nxënësit hulumtojnë dhe gjejnë në cilin vend të botës janë temperaturat më të ulëta dhe më të larta.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_



ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Bashkëveprimi njeri-natyrë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Dallon disa nga llojet e ndotjes së mjedisit dhe identifikon disa nga faktorët që ndikojnë në ndotjen e tokës apo keqmenaxhimin e saj: p.sh., shfrytëzimi i tokave - ndërtime në tokat bujqësore, përdorimi i pesticideve, shpyllëzimet, erozioni etj.).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.6; II.8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1; 2.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ndotja e mjedisit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Dallon ndotësit e natyrës;
- Identifikon veprimet e njeriut në ndotjen e ujit;
- Përshkruan se si duhet të mbrohet natyra.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, fletore, burime nga interneti.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhë shqipe, Shkathhtësi për jetë, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

*Stuhi mendimesh*

Para nxënësve, paraqesim një video me projektor. Videoja gjendet në vegëzën:

<https://www.youtube.com/watch?v=e6rglsLy1Ys>

Analizohet videoja, duke identifikuar ndotësit e tokës. Po ashtu, ndalemi te ndotësit e ujit se kush dhe si i ndot ujërat.

44 BASHKËVEPRIMI NJERI-NATYRË  
Ndotja e mjedisit

Prej se ekziston njeriu, ai ka bashkëvepruar me natyrën. Dikur natyra ishte rrezik për njeriun, ndërsa sot njeriu është rrezik për natyrën dhe mjedisin. Sot nga ndotja janë të prekur të gjithë përbërësit e mjedisit: ajri, uji, toka dhe biodiversiteti (bota e gjallë). Për ndotjen e ajrit është folur më herët, ndërsa këtu do të njiheni me ndotjen e ujit, tokës dhe ndikimin e njeriut në biodiversitet.

**Ndotja e ujit** shkaktohet nga shkarkimi i ujërave të zeza nga amvisëritë, prej ujërave nga fabrikat e ushqimit, termocentralet, minierat, nga kimikatet e hedhura në tokat bujqësore etj. Kimikatet që lirohen në ujë ndotin ujërat rrjedhëse, ujërat nëntokësore, si dhe ujërat e deteve dhe oqeanëve. Që të parandalojmë ndotjen e ujit, duhet të kemi kujdes që të mos hedhim mbeturinat dhe helmet e ndryshme në ujë. Ndotja nga kanalizimet e qyteteve dhe fabrikave mund të parandalohet ose zvogëlohet duke i trajtuar (pastruar) ujërat e ndotura në impiante (fabrika për pastrimin e ujit) dhe, vetëm pasi të pastrohen, të derdhen në lumenj.



Ndotja e ujërave nga fabrikat me pasoja të mëdha për botën e gjallë



Impiantet janë të domosdoshme për parandalimin e ndotjeve.



**Shpyllëzimet** përpos që ndikojnë në dëmtimin e biodiversitetit, ato ndikojnë edhe në paraqitjen e gërryerjeve (erozioneve), humbjen e burimeve të ujit, rritjen e fuqisë së erës, rritjen e thatësisë etj.



Shfrytëzimi pa kriter i pyjeve sjell pasojë të mëdha për jetën në planet, sepse humbet prodhuesi më i madh i oksigjenit dhe shtëpia më e madhe e gjallesave.



Për pyjet, mund të thuhet se janë "mushkëritë e planetit Tokë", të cilat po dëmtohen dita-ditës.

**Kimikatet bujqësore** - përdorimi i plehrave kimike dhe i pesticideve ndikon në ndotjen e tokës dhe ujërave nëntokësore. Kur ndoten toka dhe ujërat nëntokësore, atëherë rrezikohet edhe ushqimi që ne hamë dhe uji që pimë e kjo ka pasojë të rënda për shëndetin tonë.



Përdorimi i kimikateve bujqësore ka pasojë të mëdha për insektet.

Përveç vrasjes së insekteve dhe barërave që dëmtojnë kulturat bujqësore (ku është dhe qëllimi i përdorimit), pesticidet mund të jenë helmuese edhe për zogjtë, peshqit, insektet e dobishme dhe bimët e dobishme, prandaj themi se dëmtojnë edhe biodiversitetin.

98



## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes DLTA

Paraqitet njësia e re mësimore. Lexohet teksti, nxënësit dëgjojnë me vëmendje. Teksti lexohet me ndalesa, pas çdo ndalesë shtrohen pyetje.

Lexohet paragrafi *Ndotja e ujit*. Shtrohen pyetje:

- Nga cilat veprime që i bën njeriu bëhet ndotja e ujit?

- Si mund ta parandalojmë ndotjen e ujit?

Lexohet paragrafi *Shpyllëzimet*. Shtrohet pyetja:

- Si ndikojnë shpyllëzimet në humbjen e ujit?

Lexohet paragrafi *Kemikatet bujqësore* dhe djegia e mbeturinave. Shtrohet pyetja:

- Si i ndotin kimikatet ujërat nëntokësore dhe pse djegia e mbeturinave është e dëmshme për tokën, ujin e gjallesat?

Lexohet paragrafi *Ndërtimet*. Shtrohet pyetja:

- Pse janë të dëmshme ndërtimet në tokat bujqësore?



## Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit Shkrim i lirë

Nxënësit në dyshe shkruajnë disa këshilla se si duhet t'i mbrojmë tokën dhe ujin nga ndotja.

- Cila është detyra jonë si qytetarë të së ardhmes?

Pas përfundimit, lexohen disa nga shkrimet e nxënësve.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë në dallimin e ndotësve të natyrës, identifikimin e veprimeve të dëmshme që i bën njeriu, përshkrimin se si duhet të mbrohet natyra.

### Detyrë:

Të shkruajnë 5 këshilla se si duhet të mbrohet uji nga ndotja.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Bashkëveprimi njeri-natyrë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Dallon disa nga llojet e ndotjes së mjedisit dhe identifikon disa nga faktorët që ndikojnë në ndotjen e tokës apo keqmenaxhimin e saj: p.sh., shfrytëzimi i tokave - ndërtime në tokat bujqësore, përdorimi i pesticideve, shpyllëzimet, erozioni etj.).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.6; II.8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1; 2.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ndotja e mjedisit - Fletore pune

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Identifikon ndotësit e tokës, ujit, ajrit;
- Përshkruan veprimet e njeriut në ndotjen e ujit;
- Argumenton veprimet për pakësimin e ndotjes së mjedisit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, fletore.


**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
Përgatitja për të nxënësit  
Organizues grafik

Plotësohet së bashku me nxënësit.



1. Dikur, njeriu shfrytëzonte natyrën në mënyrë të barabartë me kafshët e tjera, ndërsa sot, për shkak të dominimit të njeriut, ai përbën rrezik për natyrën. Diskutoni rreth kësaj.

2. Plotëso fjalitë.

a) Sot, në botë, nga veprimtaria e njeriut janë të prekur të gjithë përbërësit e mjedisit: \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_.

b) Ndotja e ujit shkaktohet nga shkarkimi i ujërave \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_, ujërave nga \_\_\_\_\_ e ushqimit, \_\_\_\_\_ e hedhura në tokat bujqësore.

c) Shpyllëzimet ndikojnë në paraqitjen e \_\_\_\_\_ tokës, \_\_\_\_\_ të ujit, rritjen e fuqisë së \_\_\_\_\_, rritjen e thatësisë etj.

d) Përdorimi i plehrave kimike dhe i pesticideve ndikon në \_\_\_\_\_ dhe ujërave \_\_\_\_\_.

e) Ndërtimet në tokat bujqësore janë jashtëzakonisht të dëmshme, sepse humbet \_\_\_\_\_ nga e cila ushqehemi ne.

f) Mbrojtja e burimeve natyrore është \_\_\_\_\_.

g) Burimet natyrore janë \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_.

3. Pse bletët sot janë shumë të rrezikuara?

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

1. Dikur, njeriu shfrytëzonte natyrën në mënyrë të barabartë me kafshët e tjera, ndërsa sot, për shkak të dominimit të njeriut, ai përbën rrezik për natyrën. Diskutoni rreth kësaj.

2. Plotëso fjalitë.

a) Sot, në botë, nga veprimtaria e njeriut janë të prekur të gjithë përbërësit e mjedisit: \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_.

b) Ndotja e ujit shkaktohet nga shkarkimi i ujërave \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_, ujërave nga \_\_\_\_\_ e ushqimit, \_\_\_\_\_ e hedhura në tokat bujqësore.

c) Shpyllëzimet ndikojnë në paraqitjen e \_\_\_\_\_ tokës, \_\_\_\_\_ të ujit, rritjen e fuqisë së \_\_\_\_\_, rritjen e thatësisë etj.

d) Përdorimi i plehrave kimike dhe i pesticideve ndikon në \_\_\_\_\_ dhe ujërave \_\_\_\_\_.

e) Ndërtimet në tokat bujqësore janë jashtëzakonisht të dëmshme, sepse humbet \_\_\_\_\_ nga e cila ushqehemi ne.

f) Mbrojtja e burimeve natyrore është \_\_\_\_\_.

g) Burimet natyrore janë \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_.

3. Pse bletët sot janë shumë të rrezikuara?

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_



### Ndërtimi i njohurive:

#### Përpunimi i përmbajtjes

*Mbajtja e strukturuar e shënimeve*

Hapet libri. Nxënësit do t'u përgjigjen pyetjeve në libër. Diskutohet dhe plotësohet bashkë me nxënësit.

Ndotësit e tokës	Ndotësit e ujit	Ndotësit e ajrit
Vajrat e makinave	Shkarkesa industriale, ujërat e zeza plehëruasit etj.	Automjetet në tokë, tymi industrial.



### Përforcimi:

#### Konsolidimi i të nxënit

*Rrjeti i diskutimit*

Parashtrajnë pyetjen: “A janë të rrezikuara bletët? Pse janë të rrezikuara?”

A janë të rrezikuara bletët? Pse janë të rrezikuara?

Po

Jo

Argumentohen përgjigjet e tyre.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë në identifikimin e ndotësve të tokës, ujit, ajrit, në përshkrimin e veprimeve të njeriut në ruajtjen e mjedisit, si dhe në argumentimin e veprimeve në pakësimin e ndotjes së mjedisit.

### Detyrë:

Shkruajnë ndotësit e ujit, tokës, ajrit.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.*

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës

**Lënda:** Njeriu dhe natyra

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** IV

**Tema:** Bashkëveprimi njeri-natyrë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Dallon disa nga llojet e ndotjes së mjedisit dhe identifikon disa nga faktorët që ndikojnë në ndotjen e tokës apo keqmenaxhimin e saj: p.sh., shfrytëzimi i tokave - ndërtime në tokat bujqësore, përdorimi i pesticideve, shpyllëzimet, erozioni etj.).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; V.8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1; 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ruajtja e trashëgimisë natyrore

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Identifikon burimet natyrore;
- Emërton disa objekte të trashëgimisë natyrore në Kosovë;
- Përshkruan rëndësinë e tyre.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, fletorja, burime nga interneti.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë shqipe, Shkathësi për jetë, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënët**  
Stuhi mendimesh

Para nxënësve shfaqet një video, e cila gjendet në vegëzën: [youtube.com/watch?v=PaQcFwRHLT8](https://www.youtube.com/watch?v=PaQcFwRHLT8)

Më pas shtrohen pyetjet, si:


- Cilat bukuri natyrore i shikuat në këtë video?
- A mendoni se duhet të kujdesemi për to?
- Për çfarë na shërbejnë ato?
- A rrezikojnë zhdukjen këto bukuri natyrore?

45 Ruajtja e trashëgimisë natyrore

Burimet natyrore janë: ajri, uji, biodiversiteti, toka, mineralet. Këto duhen shfrytëzuar kujdesshëm në mënyrë që të ruhen edhe për brezat e ardhshëm dhe të mos shkatërrohet mjedisi. Mirëpo, po ashtu, duhet kushtuar kujdes edhe mbrojtjes së objekteve të trashëgimisë natyrore, siç janë shpellat (p.sh. Shpella e Gadimes, e Radavit etj.), liqenet akullnajore në Parkun Kombëtar "Mali Sharr" dhe në "Bjeshkët e Nemuna" dhe bota bimore e shtazore në këto parqe.



Liqeni glacial (akullnajor) në Gjeravicë - Bjeshkët e Nemuna



Shpella e Gadimes

100

Në Parkun Kombëtar "Sharri" dhe atë "Bjeshkët e Nemuna" kemi disa lloje të rralla bimore e shtazore me përhapje shumë të kufizuar. Si shtazë e rrallë dhe karakteristike është p.sh. rrëqebulli i Ballkanit, i cili gjendet vetëm në Ballkan (Kosovë, Shqipëri, Maqedoni Veriore). Po ashtu edhe lloji bimor "Barëpezmi i Mbretit Aleksandër", që gjendet vetëm në një hapësirë shumë të vogël në Parkun Kombëtar "Sharri".



Rrëqebulli i Ballkanit



Barëpezmi i Mbretit Aleksandër

Diskutoni për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, duke e ndërlidhur atë me jetën e brezave të ardhshëm.

1. Cilat janë burimet natyrore? Sqaro pse duhen shfrytëzuar kujdesshëm.
2. Emërto disa nga objektet e trashëgimisë natyrore në Kosovë.
3. Në cilat vende gjendet rrëqebulli i Ballkanit?

101



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes Pyetja sjell pyetjen

Tregohen tri karakteritika të ruajtjes së trashëgimisë natyrore: burimet natyrore, objektet e trashëgimisë natyrore, rrëqebulli i Ballkanit; me pak fjalë, shpjegohet kuptimi i tyre.

U drejtohet nxënësve tri pyetje.

1. Pse janë të rëndësishme burimet natyrore?
2. Pse duhet të ruhen objektet e trashëgimis natyrore?
3. Çfarë duhet të bëjmë që të mos zhduken rrëqebulli i Ballkanit dhe bimët e tjera që janë karakteristike për Kosovën?

Nxënësit e lexojnë tekstin dhe gjejnë përgjigjet e pyetjeve gjatë leximit. Nxënësit duhet t'i bëjnë pyetje njëri-tjetrit dhe t'u përgjigjen.



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit Rrjeti i diskutimit

Nxënësit marrin qëndrim pro dhe kundër dhe do ta mbrojnë atë. Diskutimi mund të shoqërohet duke i grupuar nxënësit sipas qëndrimit që marrin.

A mendoni se është e rëndësishme ruajtja e trashëgimisë natyrore?

Po.

Jo.

Janë pasuri e vendit.

Nuk janë shumë të rëndësishme.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë në identifikimin e burimeve natyrore, në emërtimin e objekteve të trashëgimisë natyrore në Kosovë, si dhe në përshkrimin e rëndësisë së tyre.

### Detyrë:

Nxënësit shkruajnë si duhet të mbrohen rrëqebulli dhe barpezmi i Mbretit Aleksandër nga zhdukja.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.*







